



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-063

PËR HEKURUDHAT KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR HEKURUDHAT KOSOVËS

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit hekurudhor, përmirësimin e sistemit të sigurisë, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese të operatorëve dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sektorit hekurudhor.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj rregullon:

1.1. funksionet dhe kompetencat e shtetit dhe të entiteteve hekurudhore që janë të ngarkuar me zhvillimin e sektorit hekurudhor;

- 1.2. rrjetin dhe infrastrukturën hekurudhore;
- 1.3. operimet dhe shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore;
- 1.4. shfrytëzuesit e infrastrukturës hekurudhore;
- 1.5. sigurinë e sistemit hekurudhor;
- 1.6. kërkesat e sigurisë për sistemin hekurudhor;
- 1.7. interoperabilitetn e sistemit hekurudhor në Kosovë;
- 1.8. modernizimin dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore;
- 1.9. dispozitat mbi shërbimet e transportit hekurudhor dhe
- 1.10. shërbimet në interes të publikut të ofruara nga sistemi hekurudhor.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ndërmarrja hekurudhore** – cila do ndërmarrje publike apo private, biznesi kryesor i së cilës është ofrimi i shërbimeve të transportit hekurudhor për mallrat dhe/ose udhëtarët me kërkesën që ndërmarrja duhet të siguroj tërheqjen; kjo gjithashtu përfshinë edhe ndërmarrjet të cilat ofrojnë vetëm shërbimet e tërheqjes;
- 1.2. **Infrastruktura hekurudhore** – përkufizimi dhe rregullimi siç parashikohet në Kreun IV të këtij ligji.
- 1.3. **Infrastruktura hekurudhore e shfrytëzimit të përbashkët** - infrastruktura hekurudhore e cila është apo duhet të bëhet e qasshme për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore që i plotësojnë kushtet e qasjes;
- 1.4. **Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore** – njësi organizative që është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duke përfshirë dhënien e trasesë së trenit dhe kërkimin e pagesës për atë shfrytëzim e gjithashtu edhe rregullimin e trafikut, funksionet e përmendura të menaxhimit të infrastrukturës i atribuohen më shumë se sa vetëm një njësi organizative;
- 1.5. **Konkurrenca intramodale** - konkurrenca ndërmjet dy apo më shumë ndërmarrjeve hekurudhore në të njëjtën infrastrukturë hekurudhore;

1.6. **Licenca hekurudhore** - dokumenti i cili zyrtarisht njeh aftësinë e ndërmarrjes për të kryer shërbimet e transportit me hekurudhë të përmendura në këtë dokument;

1.7. **Certifikata e sigurisë** - dokumenti me anë të së cilit ndërmarrja hekurudhore dëshmon se i përmbush kushtet për trafik të sigurt në linja specifike hekurudhore apo në tërë rrjetet hekurudhore;

1.8. **Autorizimi i Sigurisë** - dokumenti me të cilin menaxheri i infrastrukturës dëshmon se plotëson kushtet për ofrimin e shërbimeve infrastrukturore të sigurta;

1.9. **Dokumenti i sigurisë për binarët industrial** - dokumenti me të cilin operatori privat i binarit industrial dëshmon se plotëson kushtet për operim të sigurt me binarit e tij industrial;

1.10. **Traseja e trenit** - kapaciteti i shfrytëzimit të pjesës së caktuar të infrastrukturës hekurudhore brenda një kohe të caktuar;

1.11. **Orari i trenave** - udhëzimi i vendosur nga menaxheri i infrastrukturës i cili përcakton kohën e nisjes dhe arritjes së trenave në stacione dhe vendndalimet tjera të planifikuara e gjithashtu edhe kohën e pritjes dhe informacionin tjetër që është i rëndësishëm për sigurinë e trafikut hekurudhor;

1.12. **Ekspozeu i rrjetit** –ekspozeu i cili paraqet në detaje rregullat e përgjithshme, afatet, procedurat dhe kriteret e skemave të pagesave dhe alokimit të kapaciteteve duke përfshirë informatën e kërkuar e cila mundëson aplikimin për kapacitetet e infrastrukturës. Kjo po ashtu nënkupton katalogun e shërbimeve të ofruara nga menaxheri i infrastrukturës dhe kushtet që duhet plotësuar për të siguruar qasjen në infrastrukturën hekurudhore; Përbajtja e detyrueshme e ekspozitës të rrjetit është dhënë në Kreun e V të këtij Ligji;

1.13. **Shërbimet hekurudhore në interes të publikut (shërbimet e publikut)** - aktivitetet e ndërmarrjeve hekurudhore që konsiderohen të domosdoshme për promovimin e mirëqenies së vendit si tërësi dhe që nuk mund të kryhen pa mandat të autoriteteve publike;

1.14. **Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore** - ndërtimi dhe modernizimi i saj;

1.15. **Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK)** – kriteret ndërkombëtare për kompaninë e kontabilitetit, duke përfshirë këtu bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe të humbjes si dhe prezantimin e tyre me të cilin i jepet aksionarëve dhe publikut informacion i drejtë dhe i plotë në lidhje me rezultatet e aktivitetit ekonomik;

1.16. **Nënsistemet** - rezultati i ndarjes së sistemit hekurudhor ashtu si është treguar në Aneksin 2 të Direktivës 2008/57/EC. Ato mund të jenë strukturore apo funksionale;

1.17. **Pajisjet hekurudhore** - ndonjë komponentë teknike të sistemit hekurudhor;

1.18. **Rregullat nacionale të sigurisë** - të gjitha rregullat që përmbajnë kërkesat e sigurisë hekurudhore të lëshuara nga organi kompetent për sigurinë e hekurudhave e quajtur organi nacional i sigurisë (ONS) dhe të aplikueshme nga menaxherët e infrastrukturës dhe operatorët hekurudhor të binarëve industrial;

1.19. **Sistemi i menaxhimit të sigurisë** - organizimi dhe aranzhimet e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës dhe nga ndërmarrja hekurudhore për të siguruar menaxhimin e sigurt për operimet e tyre;

1.20. **Treni** - kompozicioni i mjeteve lëvizëse hekurudhore duke përfshirë këtu edhe tërheqjen;

1.21. **Vendkalimi** - kryqëzimi i vijës hekurudhore me infrastrukturën rrugore në të njëjtin nivel;

1.22. **Sistemi hekurudhor** - lidhja e të gjithë përbërjes të infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore që operojnë në të;

1.23. **Transporti hekurudhor** - aktiviteti i lëvizjes apo formimit të trenave të udhëtarëve dhe/ ose mallrave në infrastrukturën hekurudhore;

1.24. **Transporti ndërkombëtar** - transporti i udhëtarëve apo mallrave ndërmjet territorit të Republikës së Kosovës dhe territoreve jashtë saj;

1.25. **Transporti transit** - transporti ndërkombëtar të udhëtarëve apo mallrave që kalojnë nëpërmes territorit të Republikës së Kosovës;

1.26. **Transporti publik** - shërbimi i transportit të ofruar nën të njëjtat kushte për të gjithë udhëtarët;

1.27. **Interoperabilitet** - aftësia e infrastrukturës hekurudhore të Kosovës për të lejuar operim të sigurt dhe të pandërprerë të trenave konvencional brenda dhe jashtë Kosovës duke i plotësuar nivelet e kërkuara të performancës për linjat. Kjo aftësi varet nga të gjitha konditat rregullatore, teknike dhe operationale të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kënaqen kërkesat esenciale;

1.28. **Aksidenti** - ngjarja e padëshirueshme dhe paqëllimtë apo zinxhirin specifik të ngjarjeve të tilla të cilat kanë pasoja dëmtuese;

1.29. **Aksidenti serioz** - ndonjë ndeshje apo rrëshqitje të trenave që rezultojnë në vdekjen e të paktën një personi apo lëndimet serioze të së paku pesë apo më shumë personave apo dëmtim të gjerë të mjeteve lëvizëse hekurudhore, infrastrukturës dhe mjedisit apo ndonjë aksident tjetër i ngjashme me ndikim të dukshëm në rregulloren e sigurisë hekurudhore apo në menaxhimin e sigurisë;

1.30. **Dëmtimi gjithëpërfshirës** - dëmtimi i cili mund të vlerësohet menjëherë nga njësia e hetimit dhe kapë koston e cila është të paktën 2 milion euro në total;

1.31. **Incidenti** - ndonjë ndodhi tjetër nga aksidenti apo aksidenti serioz që shoqërohet me operimin e trenave dhe që ka efekt në sigurinë e operimit;

1.32. **Makinisti** - personi e aftë dhe të autorizuar për të drejtuar trenat duke përfshirë lokomotivat, lokomotivat manovruese, trenat punues, mjetet lëvizëse të mirëmbajtjes, apo trenat për bartjen e udhëtarëve dhe mallrave në hekurudhë në mënyrë autonome, të përgjegjshme dhe të sigurt;

1.33. **Objektivat e përbashkëta të sigurisë** - nivelet e sigurisë që të paktën duhet të arrihen nga pjesët e ndryshme të sistemit hekurudhor dhe nga sistemi si tërësi, të pasqyruara në kriteret e vlerësimit të rrezikut;

1.34. **Përbërësit e interoperabilitetit** - ndonjë komponentë elementare, grup komponentësh, nëngrupin apo tërë grupin e pajisjeve të inkorporuara apo që tentojnë të inkorporohen në nënsistem nga të cilat varet drejtpërdrejt apo tërthorazi interoperabilitet i sistemit hekurudhor trans – Evropian;

1.35. **Alokimi i traseve të trenit** – alkimi i kapacitetit të infrastrukturës të shërbimit të përbashkët nga ana e organit për alokimin e traseve i cili mund të jetë menaxheri i infrastrukturës së rrjetit të përdorimit të përbashkët;

1.36. **Pagesat për shfrytëzimin e kapacitetit hekurudhor** – pagesat për shfrytëzimin e traseve të alokuara për kompaninë e cila operon me trena apo ndonjë aplikant tjetër, nga organi për alokimin e traseve. Organi i cili bënë pagesat, mund të jetë organi i alokimit të traseve dhe menaxheri i infrastrukturës për shfrytëzim të përbashkët.

1.37. **Aplikuesi** – ndërmarrja hekurudhore, ndonjë person tjetër apo entitetet legale siç janë autoritetet kompetente për shërbimet publike, transportuesit e mallrave, shpeditëret dhe operatorët e transporteve të kombinuara me shërbimet publike apo të interesit komercial në prokurimin e kapacitetit të infrastrukturës apo trasesë së trenit;

1.38. **Kapaciteti i infrastrukturës** – potenciali për planifikimin e traseve të trenit të kërkuar për ndonjë element të infrastrukturës për periudhë të caktuar;

1.39. **Kërkesat esenciale** – konditat e përcaktuara me direktivën e BE-së mbi interoperabilitetn 2008-57 të cilën duhet ta plotësoj sistemi hekurudhor, nënsistemet dhe përbërësit e interoperabilitett duke përfshirë këtu interfejsat;

1.40. **Specifikimet teknike të interoperabilitett (STI)** –specifikimet e adoptuara në bazë të Direktivës së BE-së 2008-57, sipas së cilës secili nënsistem apo pjesë e tij duhet t'i plotësoj kërkesat esenciale dhe të siguroj interoperabilitetn e sistemit;

1.41. **Metodat e përbashkëta të sigurisë (MPS)** – metodat të cilat duhet të zhvillohen dhe të përshkruajnë se sa janë vlerësuar shkallët dhe të arriturat e caqeve të sigurisë dhe përputhshmëria e tyre me kërkesat tjera të sigurisë;

1.42. **Autoriteti Rregullativ i hekurudhave të Kosovës** – institucioni i pavarur i cili është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrje, organizimin e sektorit hekurudhor në Kosovë dhe i cili vepron si organ licencues, organ përgjegjës për çështjet e interoperabilitetit dhe entiteteve të njoftimit, organ për rregullimin e tregut hekurudhor dhe organin për sigurinë hekurudhore dhe kompetencave të tjera të cilat i jepen në bazë të këtij ligji.

1.43. **Organi mbi hetimin e aksidenteve** – organi i cili është i ngarkuar për hetimin e aksidenteve hekurudhore;

1.44. **Ministria** - Ministria përkatëse për çështjet e hekurudhave;

1.45. **SETTO** - organizata regjionale e transportit e themeluar me Memorandum të Mirëkuptimit për zhvillimin e Rrjetit Kryesor Regjional të Transportit (MiM) të nënshkruar më 11 qershor 2004 nga Qeveritë e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë si dhe Komisionit Evropian.

1.46. **TPS** – Treguesit e përbashkët të sigurisë sipas Direktivës së sigurisë 2004/49 KE;

1.47. **TENT** - Rrjeti i Transportit Trans Evropian nënkupton planifikimin për transport rrugor, hekurudhor, ajror, ujor për të shërbyer në gjithë Evropën.

1.48. **QPS** - Qëllimet e përbashkëta të sigurisë sipas Direktivën e Sigurisë 2004/49 KE që duhet të paktën të arrihet nga pjesë të ndryshme të sistemit hekurudhor në lidhje me grupe të ndryshme të individëve që janë duke përdorur hekurudhat apo duke u ekspozuar ndaj rreziqeve që vijnë nga trafiku hekurudhor në mënyrë indirekte.

1.49. **UIC**- Unioni Internacional i Hekurudhave;

1.50. **NSO** – Zyra e standardizimeve kombëtare;

1.51. **CIRSRT** – Informimi i Kompjuterizuar dhe Sistemi i Rezervimit për Transportin Hekurudhor;

1.52. **COTIF** – Konventa për Barten/Transportin Ndërkombëtar nëpërmjet Hekurudhës.

Neni 4
Përjashtimet e zbatimit të këtij ligji

Për sistemet e hekurudhave të lehta, sistemet e tramvajit, ndërmarrjet hekurudhore që operojnë me shërbime hekurudhore të mallrave në infrastrukturën hekurudhore, në pronësi private që shfrytëzohet nga pronari i infrastrukturës për operimin e mallrave të tij nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji.

KREU II
RISTRUKTURIMI I SEKTORIT HEKURUDHOR DHE HAPJA E TREGUT TË
TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Neni 5
Ristrukturimi i sektorit hekurudhor

Sistemi hekurudhor pas ndarjes institucionale të Hekurudhave të Kosovës funksionon në dy kompani publike: menaxhim të infrastrukturës hekurudhore (INFRAKOS) dhe operimet e transportit hekurudhor (TRAINKOS), njëkohsisht duhet të futet konkurrenca intramodale në infrastrukturën hekurudhore për shfrytëzim të përbashkët në Kosovë ashtu siç është paraqitur në këtë ligj.

Neni 6
Infrastruktura hekurudhore për shfrytëzim të përbashkët

Çdo ndërmarrje hekurudhore me seli në Kosovë apo jashtë saj e cila ka licencë hekurudhore të paraparë me këtë ligj dhe që plotëson të gjitha kushtet sipas këtij ligji, mund të bëhet aktive në fushën e transportit duke operuar në infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë.

Neni 7
Funksionimi i sektorit hekurudhor

1. Shërbimet e menaxhimit të transportit dhe infrastrukturës hekurudhore funksionojnë në baza komerciale sipas kushteve të tregut përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë ligj.
2. Ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës janë të obliguar t'i kryejnë operimet e tyre në mënyrë të sigurt dhe të ndërtojnë dhe mirëmbajnë instalimet dhe pajisjen e tyre në kondita të sigurta.

KREU III

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E HEKURUDHAVE PUBLIKE

NËNKREU I

Ministria për çështjet e hekurudhës

Neni 8

Kompetencat e ministrisë

1. Ministria:

- 1.1. përcakton politikat dhe harton legjislacionin për një sektor modern, të sigurt dhe efikas hekurudhor në Kosovë;
- 1.2. përgatitë dhe nxjerr të gjitha aktet nënligjore të domosdoshme për zbatimin e këtij ligji;
- 1.3. ofron orientimet strategjike dhe merr parasysh sfidat afatgjata me të cilat ballafaqohet sektori i hekurudhave siç janë ndryshimet në kërkesë, presioni mjedisor dhe pritjet e konsumatorit;
- 1.4. merr parasysh strategjitë e BE-së për hekurudhën siç janë: interoperabilitet në sistemin hekurudhor Evropian; siguria dhe standardet për sistemin hekurudhor Evropian; strategjitë e zhvilluara sipas partneritetit të SEETO-s dhe përgatitjen e akteve në raport me politikat e BE-së;
- 1.5. së bashku me autoritetet e tjera kompetente publike është përgjegjëse për specifikimin dhe për kontratat që lidhen me ndërmarrjet hekurudhore që kryejnë shërbime hekurudhore në interes të publikut;
- 1.6. zhvillon konsultime me autoritetet tjera siç janë menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, ndërmarrjet hekurudhore që operojnë me shërbime, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës në tekstin e mëtejme “ARH”, organet tjera lokale dhe ato publike regjionale për hartimin e strategjive dhe politikave për sektorin e hekurudhave;
- 1.7. ofron udhëzime sipas nevojës për ARH, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me strategjinë dhe politikat sektoriale për hekurudhën;
- 1.8. përfaqëson Kosovën në marrëveshjet ndërqeveritare në sektorin e hekurudhës. Ajo mund të kërkoj nga partnerët që të bëjnë punën përgatitore dhe të merr pjesë në diskutimet preliminare në nivele ndërqeveritare.

Neni 9
Administrimi i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të
përbashkët në pronësi shtetërore

1. Infrastrukturën aktuale në pronësi shtetërore në Kosovë e menaxhon Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS),
2. Vendimet strategjike lidhur me qëndrueshmërinë e infrastrukturës hekurudhore në pronësi të shtetit në Kosovë, me mbylljen e linjave, modernizimet dhe zhvillimet, duhet të diskutohen në nivel të qeverisë para se të merret çfarëdo vendimi

Neni 10
Lëshimi i urdhëresave për licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherët e
infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët

1. Aplikimi i procedurave, vendimeve për dhënien e licencës dhe lëshimi i licencave do të jetë detyrë e organit licencues.
2. ARH duhet të siguroj që procesi i vendimmarrjes për dhënien e licencave të jetë i drejt, transparent dhe jo diskriminues dhe që vendimet t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor.
3. ARH duhet të siguroj mbajtjen dhe freskimin e regjistrit të licencave.
4. Pas konsultimit me organin licencues dhe palët e interesuara, Ministria mund të pajtohet me ministrinë e vendeve tjera për njohjen reciproke të licencave të lëshuara për sektorin hekurudhor.

Neni 11
Lëshimi i urdhëresave të sigurisë

1. ARH duhet që me propozim të organit përgjegjës për sigurinë hekurudhore dhe të organi përgjegjës për Interoperabilitet të lëshojë urdhëresat për siguri dhe interoperabilitet të sistemit hekurudhor në përputhje me politikat e BE-së për siguri dhe interoperabilitet.
2. ARH siguron që organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore dhe organi përgjegjës për ndëroperabilitet të mbikëqyrë zbatimin e urdhëresave të sigurisë në sektorin hekurudhor.

Neni 12
Mbikëqyrja e organit përgjegjës për çështje të sigurisë

1. ARH mbikëqyrë punën e organit përgjegjës për sigurinë hekurudhore.
2. ARH kujdeset që organi i sigurisë hekurudhore të mbikëqyr zbatimin e urdhëresave të sigurisë në sektorin hekurudhor.

Neni 13

Menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore në rrethana të jashtëzakonshme

Ministria duhet të sigurojë që menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët të përgatisin planet në të cilat duhet të jenë institucionet dhe të gjitha autoritetet të cilat duhet të informohen në rast të aksidenteve të rënda dhe të ndërprerjes serioze të qarkullimit hekurudhor.

Neni 14

Planifikimi i zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore

Ministria së bashku me ministritë dhe palët e tjera të interesuara, përgatitë dhe freskon programin nacional të infrastrukturës së transportit i cili duhet t'i plotësojë nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë. Ky program nacional duhet të ketë parasysh të gjitha llojet e transportit në kuadër të qasjes multimodale dhe të përcaktojë prioritetet e modernizimit dhe zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 15

Fondet dhe financimi i zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore

1. Ministria së bashku me ministritë dhe palët e interesuara do të merr parasysh të gjitha alternativat për financim të projekteve prioritare të programit nacional të definuar në këtë ligj.
2. Ministria propozon opsionet financuese për modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë si mundësi edhe kontratat e koncesionimit.
3. Kontratat e koncesioneve nëse vendoset të jepen për modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore nuk do të jepen pa procedurë tenderuese publike të organizuar nga institucionet përkatëse.

Neni 16

Pjesëmarrja në dhënien e koncesioneve dhe partneritet publiko privat për modernizimin dhe zhvillimin e hekurudhës

1. Mundësia e dhënies së koncesioneve dhe e partneritetit publiko-privat për modernizimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore nëse vendoset të bëhet, duhet të arrihet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kontratat mbi koncesionet dhe partneritetin publiko privat nëse bëhen mund të qojnë në krijimin e menaxherëve të ri të infrastrukturës hekurudhore për shfrytëzim të përbashkët të saj.

Neni 17

Mbylljet e shërbimeve të udhëtarëve, binarëve dhe stacioneve me interes të përgjithshëm ekonomik

1. Ministria pas pranimit të propozimit nga ARH dhe të gjitha palëve tjera të interesuara, do të nxjerr vendimin përfundimtar lidhur me mbylljen e shërbimeve të udhëtarëve të interesit të përgjithshëm ekonomik, të binarëve dhe stacioneve. Përcaktimi i këtyre procedurave dhe konsultimeve të detyrueshme, bëhet me akt nënligjor.
2. Parimisht nuk duhet të nxirret vendimi për mbylljen e shërbimeve të udhëtarëve të interesit të përgjithshëm ekonomik pa shpallje të tenderit ndërkombëtar për ofruesin e shërbimeve dhe verifikimin se nuk ka operator të trenave i cili është i interesuar të ofrojë këto shërbime, duke iu përgjigjur nevojave për mobilitet në kushte më të mira ekonomike sesa ofruesi i shërbimeve ekzistuese në Kosovë .

NËNKREU II

Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore

Neni 18

Statusi dhe detyrat

1. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore krijohet nën mbikëqyrjen e ARH për të siguruar që siguria hekurudhore është mbajtur dhe përmirësuar pas rindërtimit të sistemit hekurudhor në Kosovë.
2. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet të jetë i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe vendim marrjen nga ndonjë ndërmarrje hekurudhore, menaxher i infrastrukturës, aplikues apo entitet i prokurimit.
3. Organit përgjegjës për sigurinë hekurudhore duhet t'i besohen të paktën detyrat në vazhdim:
 - 3.1. autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe të kontrollimi që ato kanë operuar dhe janë mirëmbajtur në përputhje me kërkesat esenciale;
 - 3.2. mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim;
 - 3.3. autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht;
 - 3.4. lëshimi, përtëritja, amendamenti dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe

kërkesat e paraqitura në to, dhe se menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore janë duke operuar sipas kërkesave të ligjit në Kosovë;

3.5. monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë;

3.6. mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në regjistrin nacional është i azhurnuar;

3.7. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore;

3.8. mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurnohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

Neni 19 **Parimet e vendimmarrjes**

1. Detyrat e mësipërme nuk duhet të transferohen tek ndonjë menaxher i infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore apo njësi prokurimi.

2. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të kryej detyrat e veta në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Në veçanti duhet të u lejoj palëve të thonë fjalën e tyre dhe t'u jepen arsyet për vendimet e tij.

3. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të u përgjigjet me përpikëri kërkesave dhe aplikimeve dhe të bënë komunikimin e informacionit sipas kërkesave të tyre pa ndonjë vonesë. Duhet të miratoj të gjitha vendimet e veta brenda katër (4) muajsh pasi të pranohen të gjitha kërkesat për informacion.

4. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore mund të kërkoj asistencë teknike të menaxherëve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore dhe entiteteve tjera të kualifikuara gjatë kryerjes së detyrave.

5. Në procesin e bërjes së propozimeve për zhvillimin e kornizës nacionale rregullative, Organin Nacional i Sigurisë duhet të konsultoj të gjithë personat e përfshirë dhe palët e interesuara duke përfshirë këtu menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes, shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e stafit.

6. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të jetë i lirë për të kryer inspektimet dhe hetimet që janë të nevojshme për kryerjen e punëve të veta. Atij duhet t'i jepet qasje në të gjitha dokumentet, lokalet, instalimet, pajisjet, menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore.

7. Vendimet e Organit Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore mund të kundërshtohen me mjete juridike duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor dhe gjyqësor.

8. Të gjithë personat e involvuar dhe palët e interesuara, duke përfshirë këtu menaxherët e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e mirëmbajtjes, shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e stafit, kanë të drejtë të iniciojnë dhe deponojnë ankesa dhe të iniciojnë procedura gjyqësore në pajtueshmeri me procedurat e parapara kundrejt Organit Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore

9. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të bashkëpunoj me autoritetet tjera nacionale të sigurisë, veçmas me ato në kuadër të marrëveshjes së SEETO-s në mënyrë që të lehtësoj dhe koordinoj certifikatën e sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore të cilave iu është dhënë traseja ndërkombëtare e trenit.

Neni 20 **Raporti vjetor**

1. Organi Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore duhet të përpiloj raportin vjetor në lidhje me sigurinë të cilin ia paraqet ARH. Ky raport i dorëzohet ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

2. Ky raport duhet t'i përshkruaj aktivitetet e vitit paraprak me informacionin së paku mbi:

2.1. zhvillimet e sigurisë hekurudhore duke përfshirë informacionin për Treguesit e Përbashkët të Sigurisë (TPS);

2.2. ndryshimet e rëndësishme në legjislacion dhe rregullativë në lidhje me sigurinë hekurudhore;

2.3. zhvillimin e certifikatës së sigurisë dhe autorizimit të sigurisë në Kosovë;

2.4. rezultatet dhe përvoja në lidhje me mbikëqyrjen e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore; dhe

2.5. uljet të cilat nëse vendoset të bëhen nga Organi Përgjegjës për Sigurinë hekurudhore lidhur me identifikimin dhe certifikimin e subjekteve përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjeteve transportuese hekurudhore të regjistruara në vendet tjera jashtë Kosovës dhe të cilat mirëmbahen sipas ligjeve të këtyre vendeve.

Neni 21

Zbatimi i mëtutjeshëm

Themelimi, kompetencat, struktura, organizimi dhe resurset e Organit Përgjegjës për Sigurinë Hekurudhore përcaktohen me akt nënligjor i cili do të jetë në pajtim me parimet e Direktivës e BE-së 2004/49. Ky organ funksionon nën mbikëqyrjen e ARH .

NËNKREU III

Organi i Licencimeve Hekurudhore

Neni 22

Statusi dhe detyrat

1. Organi Licencues ka për detyrë që të lëshon licencat për makinistet, ndërmarrjet hekurudhore të cilat janë të domosdoshme për operimet me shërbimet hekurudhore dhe menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore, të bënë amendamentimin, suspendimin dhe revokimin e këtyre licencave. Këto licenca duhet të specifikojnë shërbimet të cilat do të ofrohen. Organi Licencues duhet të ketë për detyrë që të rishikon validitetin e licencave në baza të rregullta së paku në çdo pesë (5) vite, duke u siguruar kështu se ndërmarrja hekurudhore i plotëson obligimet e përcaktuara me këtë ligj.
2. Organi Licencues është i pavarur nga çfarëdo pjesëmarrësi tjetër i tregut hekurudhor.
3. Organi Licencues duhet të ketë kapacitetet e mjaftueshme organizative në mënyrë që të mund ti kryej detyrat e veta sipas këtij ligji.

Neni 23

Procesi i vendimmarrjes

1. Organi Licencues në Kosovë nuk duhet të lëshoj licenca apo t'i vazhdoj ato nëse nuk janë përmbushur kërkesat e këtij ligji dhe rregullave përkatëse.
2. Procedurat për dhënien e licencave duhet të bëhen publike së bashku me të gjithë formularët dhe dokumentacionin e domosdoshëm që duhet të ofrohet.
3. Organi Licencues duhet të merr vendim në lidhje me aplikimin sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më gjatë se tre (3) muaj pasi të jetë dorëzuar i gjithë informacioni relevant. Vendimi duhet ti komunikohet ndërmarrjes hekurudhore aplikuese. Në refuzim duhet të paraqiten bazat mbi të cilat është bërë ai refuzim.
4. Organi Licencues duhet të informoj ministrinë atëherë kur jepet licenca. Organi i licencimeve duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore të licencuara. Ky regjistër duhet të bëhet publik dhe duhet të jetë në ueb faqen e ARH.

5. Vendimet e Organi Licencues mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor pranë gjykatës kompetente në Kosovë nëse ndaj tyre përdoren mjete juridike.

6. Organi i Licencimit Hekurudhorë përgatit Raportin vjetor dhe i dorëzon ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

Neni 24 Themelimi

Organi Licencues në Kosovë funksionin në bazë të aktit nënligjor sipas parimeve të Direktivave të BE-së 91/ 440 dhe 95/18. Ai duhet të jetë departament në kuadër të ARH i cili i raporton menaxhmentit të tij dhe mbikëqyrjet prej tij.

NËNKREU IV Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor

Neni 25 Statusi dhe detyrat

1. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor e ka për detyrë që të bëjë sigurimin e kushteve për hapjen e tregut hekurudhor në Kosovë.

2. Organi Rregullativ i Tregut hekurudhor duhet të propozoj financimin, organizimin e vet, strukturën ligjore, vendim marrjen, pjesën e buxhetit, emërimin e stafit udhëheqës pas miratimit të ARH-së dhe ushtron mbikëqyrjen profesionale nga cilido menaxher i infrastrukturës, organ i pagesave, organ i alokimit apo aplikant. Për më tepër, sa i përket funksionimit duhet të jetë i pavarur nga cilido autoritet kompetent i përfshirë në dhënien e kontratës për shërbimet publike.

3. Detyrat e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor janë si në vazhdim:

3.1. sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese.

3.2. sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese.

3.3. mbikëqyrja e negociemeve ndërmjet aplikuesve dhe menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor.

3.4. intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.

3.5. sigurimi se a përmban ekspozeu i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët.

3.6. analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.

4. ARH vepron si organ për ankesa për tregun hekurudhor. Secili aplikant duhet të ketë të drejt të ankohet nëse beson se ka qenë i trajtuar në mënyrë të padrejtë, i diskriminuar dhe në veçanti kundër vendimeve të miratuara nga menaxheri i infrastrukturës, operatori i pajisjeve për ofrimin e shërbimeve apo kur është e mundur edhe nga ndërmarrja hekurudhore në lidhje me:

4.1. ekspozueun e rrjetit dhe kriteret që përfshihen në te;

4.2. procesin e alokimit të traseve dhe rezultatin e tij;

4.3. skemën e pagesave për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore;

4.4. nivelin apo strukturën e pagesave të infrastrukturës që është apo që mund të kërkohej të paguhet;

4.5. aranzhimet për qasje në infrastrukturën hekurudhore;

4.6. aranzhimet për qasje dhe për pagesë për shërbimet;

4.7. vendimet e organeve kompetente për sigurinë dhe interoperabilitetin hekurudhor.

5. Shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor, adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatorëve e bënë Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor

6. Detyrat tjera të Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor duhet të jenë:

6.1. monitorimi i tërë tregut hekurudhor në Kosovë. Në këtë drejtim, Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të përgatis raportin vjetor të cilin ARH pas miratimit të tijë do ta paraqes në Kuvendin e Kosovës. Duhet të përgatitet akti nënligjor për të ofruar baza për raportin e tillë vjetor, mbi bazat e rekomandimeve të BE-së për atë raport vjetor (Skema e monitorimit të tregut hekurudhor).

6.2. dhënia e kontributit për politikatat të cilat ofrojnë zhvillim të qëndrueshëm, shërbime mjedisore të transportit dhe kontribut në zbatimin e tij.

6.3. dhënia e kontributit për të zhvilluar sistem të integruar të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

6.4. kontributi në lejimin e procesit për të lejuar mbylljen e shërbimeve publike të udhëtarëve të interesit të përgjithshëm ekonomik, mbylljen e binarëve dhe stacioneve.

Neni 26

Procesi i vendimmarrjes

1. Detyrat e dhëna më sipër nuk duhet të transferohen tek ndonjë menaxher i infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore apo njësi prokurimi.

2. Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor duhet të kryej detyrat e veta në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Në veçanti, ai duhet të lejoj të gjitha palët që të thonë fjalën e vet dhe arsyet për ato vendime.

3. Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor duhet të përgjigjet menjëherë për të gjitha kërkesat dhe aplikimet dhe t'i komunikoj kërkesat për informacion pa vonesë. Ai duhet të miratoj vendimet në lidhje me licencimin brenda tre (3) muajve pasi të jetë marrë i gjithë informacioni i kërkuar.

4. Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor gjatë kryerjes së misioneve dhe detyrave të veta mund të kërkoj asistencë teknike të menaxherëve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore apo nga ndonjë organ tjetër i kualifikuar.

5. Në procesin e bërjes së propozimeve për zhvillimin e kornizës kombëtare rregullative, Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor duhet të konsultoj të gjithë personat e përfshirë dhe palët e interesuara duke përfshirë menaxherët e infrastrukturës, ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e mirëmbajtjes, shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e stafit.

6. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të ketë kompetencë për të kërkuar informacion relevant nga menaxheri i infrastrukturës, aplikantët dhe ndonjë palë e tretë e përfshirë dhe ky informacion duhet të ofrohet pa vonesë. Bazuar në informacionin e pranuar, Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor duhet të ketë kompetencë për veprime sipas detyrës përkatëse. Organi Rregullativ për tregun hekurudhor duhet të ketë të drejtë të zbatoj kërkesat e tilla me sanksione të duhura duke përfshirë gjobat. Informacioni që duhet t'i ofrohet Organit Rregullativ për tregun hekurudhor përfshinë të gjitha të dhënat që Organi rregullativ i kërkon në kornizën e funksionin e vet të ankimit dhe në funksionin e vet të monitorimit të konkurrencës në tregjet e shërbimeve hekurudhore. Kjo përfshinë të dhënat që janë të domosdoshme për qëllime statistikore dhe për vëzhgimin e tregut.

7. Nga Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të kërkohet të vendos për ndonjë ankesë dhe të ndërmerr veprim për të përmirësuar situatën brenda kohës maksimale prej dy muajsh nga marrja e gjithë informacionit. Kur është e duhur Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të vendos në iniciativë të vet për masat për të përmirësuar zhvillimet e padëshirueshme

në tregjet e shërbimeve hekurudhore në veçanti me pikat e përmendura në këtë ligj që janë detyrat kryesore të tij si organ rregullativ dhe për ankesa.

8. Në rast të ankesës kundër refuzimit për të dhënë kapacitetin e infrastrukturës apo kushteve për të ofruar kapacitetin, atëherë Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të konfirmoj se nuk ka nevojë të bëhen modifikime të vendimit apo të kërkoj modifikime të atij vendimi në përputhje me udhëzimet e specifikuara nga Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor.

9. Vendimet e Organit Rregullativ të Tregut Hekurudhor mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor dhe gjyqësor pranë gjykatës kompetente nëse parashtrohet mjete juridik.

10. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor nën kordinimin e ARH duhet të bashkëpunojë me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-s në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor në vendet e ndryshme.

11. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor, përgatit Raportin vjetor dhe i dorëzon ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

Neni 27 **Zbatimi i mëtejme**

Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor funksionon me anë të aktit nënligjor të bazuar në parimet e Direktivës e BE-së 2001/14 dhe komunikatën e BE-së 2010-475 të shtatorit 2010 mbi rimodelimin e propozimit për një hapësirë unike hekurudhore Evropiane. Ky organ duhet të krijohet si departament profesional në kuadër të ARH. I njëjti duhet t'i raportojë menaxhmentit të ARH dhe mbikëqyret prej tij.

NËNKREU V **Organi i interoperabilitet**

Neni 28 **Statusi dhe detyrat**

1. Kosova ka për qëllim që të jetë pjesë e zonës Evropiane të interoperabilitetit hekurudhor, gjë që do të thotë se sistemi hekurudhor i Kosovës duhet t'i plotësoj kushtet për ndëroperim siç janë definuar në zonën Evropiane hekurudhore.

2. Një organ i pavarur duhet të jetë përgjegjës në Kosovë për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet dhe do të përputhet në të ardhmen me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, e në veçanti me rregulloren e Agjencionit Evropian Hekurudhor. Ky organ duhet të jetë i pavarur nga çdo menaxher i infrastrukturës, ndërmarrje

hekurudhore, prodhues i pajisjeve të hekurudhave, ofrues i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe nga çdo palë tjetër, interesat e së cilës do të ishin në konflikt me detyrat që i janë besuar organit për ndëroperim.

3. Organi i interoperabilitet duhet të jetë përgjegjës t'i definojë kushtet për ndëroperim të cilat duhet të plotësohen në Kosovë në bazë të kërkesave për ndëroperim, ashtu që Kosova në të ardhmen të jetë pjesë e zonës Evropiane e interoperabilitet hekurudhor dhe t'i fus ato në ligjet dhe rregulloret e saj.

4. Këto kushte për ndëroperim kanë të bëjnë me dizajnin, ndërtimin, vënien në shërbim, përmirësimin, renovimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit si dhe kualifikimin profesional dhe kushtet shëndetësore dhe të sigurisë të personelit i cili kontribuon në operimin dhe mirëmbajtjen e tij.

5. Organi përgjegjës për interoperabilitetn e hekurudhave duhet t'i njoh dhe t'i kontrolloj organet përgjegjëse nacionale të akredituara për themelimin e deklaratave të konformitetit apo përshtatshmërisë për përdorim dhe deklaratave për verifikimin e nënsistemeve strukturale hekurudhore dhe sistemeve si dhe të deklaratave për verifikimin e mjeteve transportuese hekurudhore, ashtu që nënsistemet hekurudhore strukturale dhe sistemet si dhe mjetet transportuese hekurudhore të mund të autorizohen që të futen në shërbim.

6. Organi përgjegjës për çështjet e ndëroperim e hekurudhave duhet të siguroj që kontrollimet kryhen sipas kërkesave të interoperabilitet në proces të mbikëqyrjes së autorizimeve të sigurisë të menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të përdorimit të përbashkët dhe të certifikatave të ndërmarrjeve hekurudhore.

7. Organi përgjegjës për çështjet e interoperabilitet te hekurudhuave duhet të jetë përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në ligj.

Neni 29

Procesi i vendim marrjes

1. Në procesin e bërjes së propozimeve për të zhvilluar kornizën nacionale të interoperabilitet hekurudhor, si dhe në procesin e monitorimit, kontrollimit dhe dorëzimit të dokumenteve, organi përgjegjës për çështje të interoperabilitet duhet t'i konsultojë të gjithë personat e përfshirë dhe palët e interesit, duke përfshirë organin nacional përgjegjës për siguri në hekurudha, menaxherët e infrastrukturave, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes, shfrytëzuesit dhe përfaqësuesit e personelit.

2. Organi përgjegjës për çështje të interoperabilitet duhet t'i kryej detyrat në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Në veçanti, duhet t'i lejojë të gjitha palët e interesuara që të shprehen dhe duhet t'i arsyetoj vendimet e tij.

3. Organi përgjegjës për çështje të interoperabilitetit duhet t'i përgjigjet shpejt kërkesave të aplikantëve dhe t'i komunikojë kërkesat për informim pa vonesë. Ai do t'i adoptojë vendimet brenda tre muajsh pasi që të jenë siguruar të gjitha informatat.

4. Organi përgjegjës për çështje të interoperabilitetit mund të kërkojë asistencë teknike nga organi nacional për siguri në hekurudha, menaxherët e infrastrukturave dhe ndërmarrjet hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes, organet nacionale të akredituara apo organet e kualifikuara gjatë kryerjes së misionit dhe detyrave të tyre.

5. Organi përgjegjës për çështje të interoperabilitetit duhet të ketë fuqi të kërkojë informata relevante nga të gjithë aplikantët, menaxherët e infrastrukturave, ndërmarrjeve hekurudhore, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe çdo palë e tretë e përfshirë. Informatat e kërkuara duhet të ofrohen pa vonesë.

6. Organi i Interoperabilitetit përgadit Raportin vjetor dhe i dorëzon ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

Neni 30

Zbatimi i mëtutjeshëm

Organi i ngarkuar me çështje të ndëroperimit funksionon në bazë të një akti nënligjor në pajtim me Parimet e Direktivës të BE-së 2004/49 dhe 2008/57. I njëjti duhet të propozojë të punësojë staf profesional dhe me eksperiencë të cilët kanë kapacitete të kryejnë detyrat e përcaktuara me këtë ligj. Ky duhet të jetë Departament në kuadër të ARH i cili do të punon ngushtë me organin përgjegjës për sigurinë hekurudhore. I njëjti duhet të raportojë te menaxhmenti i ARH-së dhe do të jetë nën mbikëqyrjen e tij.

NËNKREU VI

Organi për hetimin e aksidenteve

Neni 31

Obligimet për hetimin e aksidentit

Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore është i obliguar të kryej hetim në rast të aksidentit/ incidentit për qëllim të parandalimit duke përfshirë këtu mbledhjen dhe analizimin e informatave, përpilimin e konkluzioneve, përcaktimin e shkaktarëve dhe kur është e përshtatshme bërjen e rekomandimeve të sigurisë.

Neni 32

Obligimi për deklarimin e aksidentit

Ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës dhe kur është e përshtatshme organi përgjegjës për çështje të sigurisë, janë të obliguar që menjëherë të raportojnë aksidentet apo incidentet. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të jetë në gjendje të përgjigjet në raportet e tilla dhe të bëj aranzhimet e domosdoshme për të filluar hetimin dhe atë jo më vonë se një (1) javë pas pranimit të raportit në lidhje me aksidentin apo incidentin.

Neni 33

Statusi i organit për hetimin e aksidenteve

1. Organi i përhershëm i hetimit të aksidenteve funksionon me anë të aktit nënligjor në pajtim me parimet e Direktivës e BE-së 2004/ 49. Ky organ hetues i aksidenteve hekurudhore duhet të përbëhet të paktën nga një hetues i përhershëm i aftë për të kryer funksionet e hetuesit të ngarkuar në rast të aksidentit.

2. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të jetë i pavarur në organizimin e vet, strukturën ligjore dhe marrjen e vendimeve nga cilido menaxher i infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore, organ për pagesat, organ për alokim dhe organet e njoftimit, si dhe nga cilado palë interesi e cila mund të jetë në konflikt me detyrat e besuara për organin hetues. Për më tepër duhet të jetë funksionalisht i pavarur nga Autoriteti Nacional i Sigurisë dhe nga Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor.

Neni 34

Kushtet për hetimin e aksidenteve

1. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të kryej aktivitetet e veta në mënyrë të pavarur nga organizatat e referuara më sipër dhe duhet të jetë në gjendje të siguroj burime të mjaftueshme për të bërë këtë gjë. Hetuesve të tij duhet të u ofrohet statusi që u jep atyre garancion të domosdoshëm të pavarësisë.

2. Nëse është e domosdoshme, organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore mund të kërkoj asistencë nga organet hetuese të shteteve të tjera dhe atë veçmas nga ato që janë në marrëveshjen e SEETO-s, për të ofruar ekspertizë apo për të kryer inspektime teknike, analiza apo vlerësime.

3. Hetimi i aksidentit duhet të kryhet në mënyrë sa më të hapur ashtu që të bëhet dëgjimi i të gjitha palëve (menaxherit të infrastrukturës hekurudhore, ndërmarrjeve hekurudhore, autoritetit të sigurisë, viktimave dhe të afërmeve të tyre, pronarëve të pronave të dëmtuara, prodhuesve, shërbimeve emergjente të përfshira, përfaqësuesve të stafit dhe shfrytëzuesve). Të gjitha palët e interesuara duhet të informohen rregullisht për hetimin dhe progresin dhe sa më shumë që është e mundur duhet të u jepet mundësia atyre për të paraqitur opinionet dhe mendimet e tyre dhe të u lejohet të komentojnë draft raportet.

4. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të përfundoj ekzaminimin e vet në vendin ku ka ndodhë aksidenti në kohë sa më të shkurtër të mundshme për t'i mundësuar menaxherit të infrastrukturës për të rregulluar infrastrukturën dhe për ta hapur atë për shërbimet e transportit hekurudhor sa më shpejt që të jetë e mundur.

5. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të përgatis raport në formën e cila është e përshtatshme për llojin dhe seriozitetin e aksidentit apo incidentit dhe relevancën e të gjeturave të hetimit. Raporti duhet të paraqes objektivat e hetimit dhe kur është e përshtatshme të përmbaj edhe rekomandimet e sigurisë.

6. Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të bëj publik raportin përfundimtar sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së ndodhisë. Ky raport duhet të jetë sa më afër që të jetë e mundur me strukturën raportuese në pajtim me nivelin e BE-së, të paraparë në aktin nënligjor. Raporti duhet të iu komunikohet të gjitha palëve të interesuara.

Neni 35

Bashkëpunimi me organet tjera të hetimit të aksidentit hekurudhor

Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore i vendosur në Kosovë duhet të shkëmbej mendimet dhe përvojën për qëllim të zhvillimit të metodave të përbashkëta të hetimit, përpilimit të parimeve të përbashkëta dhe pasimin e rekomandimeve të sigurisë dhe përshtatjen për zhvillimet e progresit teknik dhe shkencor.

Neni 36

Raporti vjetor

Secilin vit dhe më së largu deri më 31 mars, Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore duhet të publikoj raportin vjetor ku paraqiten hetimet e kryera në vitin paraprak, rekomandimet e sigurisë që janë dhënë dhe veprimet e ndërmarra në rekomandimet e dhëna më parë.

Neni 37

Zbatimi i mëtejshëm

Organi për hetimin e aksidenteve hekurudhore funksionon si organ i pavarur nga ARH dhe organet tjera që punojnë në sigurinë hekurudhore dhe organi rregullativ i tregut hekurudhor me anë të një akti nënligjor në pajtim me parimet e Direktivës e BE-së 2004/ 49. Ky organ është i pavarur në mbikëqyrjen e Komisionit për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike, sipas legjislacionit në fuqi për aviacionin civil.

NËNKREU VII

Autotiteti Rregullativ i Hekurudhave

Neni 38

Funksionimi i Autotiteti Rregullativ të Hekurudhave

1. ARH është organ i pavarur që rregullon dhe mbikëqyrë sektorin e hekurudhave në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe me legjislacionin në fuqi të BE-së, të përshtatshëm për Kosovën në këtë sektor.
2. Bordi i ARH-së, miraton të gjitha aktet nënligjore të departamenteve të cilat janë në kuadër të sajë.
3. ARH, nëpërmes aktit nënligjor i përcakton modalitetet e menaxhimit, mbikëqyrjes dhe kontrollimit apo auditimit të departamenteve të cilat janë në kuadër të saj.
4. ARH, i raporton Kuvendit të Kosovës sipas kërkesës dhe së paku një (1) herë në vit për fushë veprimtarinë e departamenteve të cilat janë në kuadër të sajë.
5. ARH, në bazë të kompetencave të cilat i mbulon merr pjesë dhe përfaqëson sektorin e hekurudhave të Kosovës në organizatat dhe organet kompetente brenda dhe jashtë shtetit.
6. Veprimtaria e ARH-së, do të mbikëqyret nga një bord mbikëqyrës (Bordi) i cili është bord joekzekutiv.
 - 6.1. Kuvendi i emëron katër (4) anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet kryesuesi i Bordit, të cilët propozohen nga Qeveria me rekomandim të Ministrisë;
 - 6.2. Bordi ARH, përbehet prej pesë (5) anëtarëve, dhe njëri prej tyre zgjidhet kryesues, anëtar i pestë i Bordit është Drejtori i Përgjithshëm i ARH-së;
 - 6.3. anëtar i Bordit duhet të ketë:
 - 6.3.1. diplomë universitare, në fushën e drejtësisë, ekonomisë, inxhenerisë ose të specializuara në sektorin e transportit;
 - 6.3.2. së paku tri (3) vjet përvojë pune adekuate në sektorin e transportit;
 - 6.4. asnjë person nuk mund të emërohet anëtar i Bordit nëse është:
 - 6.4.1. aktivisht i përfshirë në parti politike ose
 - 6.4.2. nëpunës , kontraktues, aksionar, partner, pronar, menaxher, anëtar bordi, administrator në falimentim ose anëtar i ndonjë organi për likuidim të ndonjë personi që ka paraqitur kërkesë apo të cilit i është lëshuar licenca, certifikata e

sigurisë ose leja, apo është dënua për vepër penale me gjashtë (6) apo më tepër muaj burgim;

6.5. të gjithë anëtarët e Bordit duhet të jenë shtetas të Kosovës;

6.6. çdo anëtar i Bordit emërohet për një mandat pesë vjeçar (5), i cili mund të emërohen më se shumti edhe për një (1) mandat;

6.7. anëtari i Bordit mund të largohet prej Bordit nga autoriteti që e ka emëruar, nëse:

6.7.1. sipas mendimit të autoritetit që e ka emëruar atë, nuk ka ushtruar shkathtësitë dhe nuk ka treguar perkushtimin e pritur nga një person që emërohet në Bord;

6.7.2. nuk ka vijuar mbledhjet dhe nuk ka marrë pjesë aktive në aktivitetet e Bordit për më shumë se tre (3) muaj pa arsye;

6.7.3. është i paaftë të ushtrojë përgjegjësitë e veta për shkak të paaftësisë fizike apo mentale;

6.7.4. është dënua për vepër penale me gjashtë (6) apo më tepër muaj burgim;

6.7.5. ka treguar sjellje jo të mirë të cilat sipas mendimit të autoritetit që e ka emëruar atë, mund të kompromitojë aftësinë e tij në kryerjen e detyrave ose në mënyrë të dëmshme mund të ndikojë në reputacionin e Bordit.

6.8. Kuvendi mund të shkarkojë një apo më shumë anëtarë të Bordit nëse kanë dështuar për ti përmbushur çështjet e parashtruara të cilat i kanë obligim në bazë të këtij ligji;

6.9. anëtari i Bordit mund të jep dorëheqje nga Bordi duke e njoftuar me shkrim Kuvendin dhe Bordin jo më pak se një (1) muaj përpara, përveç në raste të jashtëzakonshme;

6.10. takimet e Bordit do të drejtohen në pajtim me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi dhe së paku një (1) herë në çdo muaj. Kryesuesi, sipas bindjes së vet dhe me kërkesë të së paku dy (2) anëtarëve të Bordit, në çdo kohë mund të konvokojë mbledhje shtesë të Bordit. Mbledhjet e Bordit nuk mund të zhvillohen nëse nuk janë të pranishëm tre (3) prej anëtarëve të tij, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm që duhet të jetë gjithmonë i pranishëm në mbledhjet e Bordit. Mbledhjet e Bordit mund të organizohen edhe si video/audio konferenca ku anëtarët mund të marrin pjesë edhe nëpërmjet mjeteve tv/audio. Është përgjegjësi e anëtarit të Bordit që e ndjek mbledhjen më këto mjete të sigurojë konfidencialitetin;

6.11. kryesuesi i njofton anëtarët e Bordit për datën, kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes së Bordit së paku shtatë (7) ditë para mbledhjes. Kryesuesi, për çështje urgjente, mund t'i njoftojë edhe më herët se shtatë (7) ditë, me kusht që numri minimal

i anëtarëve të Bordit që kërkohet të jenë të pranishëm të marrin pjesë dhe të konfirmojnë se mbledhja është konvokuar në mënyrën e duhur;

6.12. vendimet e Bordit merren me shumicën e votave. Çdo anëtar i Bordit ka një (1) votë për çdo zgjidhje dhe kur numri i votave në favor të zgjidhjes është i barabartë me numrin e votave kundër, vota e kryesuesit është vendimtare;

6.13. nëse është ndonjë çështje urgjente që duhet kaluar dhe kryesuesi nuk mund të konvokojë mbledhje të Bordit ku të pranishëm do të jenë aq anëtarë të Bordit sa edhe kërkohet, çështja mund të trajtohet përmes zgjidhjes me shkrim të nënshkruar nga kryesuesi dhe së paku dy (2) anëtarë të tjerë të Bordit, të cilët do të kishin të drejtë votimi mbi çështjen po të konvokohej mbledhja e Bordit;

6.14. kryesuesi do të sigurojë që të mbahet procesverbal i çdo takimi të Bordit i cili miratohet në takimin e radhës të Bordit. Kryesuesi do të sigurojë që të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të mirëmbahen dhe të ruhen në vend të mbrojtur dhe të sigurtë. Procesverbalet janë konfidenciale dhe përmbajnë datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, anëtarët e Bordit dhe personat tjerë të pranishëm, vërejtjet e anëtarëve të Bordit, për çdo çështjeje shqyrtuar, dokumentacionin e paraqitur Bordit dhe vendimet e marra nga ai;

6.15. çdo anëtar i Bordit merr një shumë fikse të kompensimit për përmbushjen e detyrave të tyre;

6.16. përcaktimi i shumës fikse të kompensimit propozohet nga bordi i ARH dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës;

6.17. në përmbushjen e detyrave për Bordin çdo anëtar i tij do të veprojë në mirëbesim, në interesin më të mirë të ARH dhe do të zbatojë shkathtësitë dhe tregojë përkushtimin e pritur në përmbushjen e detyrave të tyre;

6.18. anëtari i Bordit duhet të deklaroj ndonjë konflikt të interesit dhe të abstenoj në vendimmarrje kur ato janë evidentë si interesa të drejtpërdrejta apo të tërthorta.

Neni 39

Statusi dhe detyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

1. Struktura e ARH-së, miratohet nga Bordi dhe përfshinë: Menaxhmentin, Departamentet dhe personelin mbështetës. Çdo departament ka funksione të përcaktuara për t'iu përgjigjur nevojave të mobilitetit të shoqërisë, transportit dhe ekonomisë, siç rregullohen në këtë ligj dhe me aktet nenligjore të nevojshme që nxjerrin vete ato dhe menaxhmenti i ARH-së. Departamente në kuadër të ARH-së janë:

1.1. Departamenti i licencimeve,

- 1.2. Departamenti i sigurisë,
- 1.3. Departamenti për interoperabilitet dhe organet njoftuese,
- 1.4. Departamenti i tregut hekurudhor.

2. Përveç Departamenteve të përcaktuara në bazë të këtij neni, sipas nevojës dhe me miratimin Bordit të ARH, në pajtim me këtë ligj, mund të formohen edhe Departamente të tjera.

3. Departamentet raportojnë të menaxhmenti i ARH-së, e cila vepron nën mbikëqyrjen e Bordit të ARH-së.

4. ARH, ka Drejtorin e përgjithshëm i cili është Kryeshef ekzekutiv i Autoritetit. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet dhe shkarkohet nga Bordi në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Ai që nuk ka të drejtë të shërbejë në Bord nuk do të ketë të drejtë të emërohet as Drejtor i përgjithshëm.

5. Drejtori i përgjithshëm do t'i ushtrojë kompetencat që i delegohen atij nga Bordi dhe nga ky ligj dhe është përgjegjës për:

5.1. drejtimin e punëve të përditshme të ARH, në pajtim me politikat dhe udhëzimet e nxjerra nga Bordi;

5.2. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të personelit në pajtim me politikat dhe procedurat e brendshme dhe ligjin në fuqi;

5.3. sigurimin e informacioneve për Bordin lidhur me çështjet e diskutuara në mbledhjet e Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit;

6. ARH sipas nevojës mund të angazhojë ekspert përkatës në raste të caktuara sipas nevojës në bazë të kontraktiveve konform procedurave të parapara ligjore.

7. Në kryerjen e detyrave për Autoritetin, anëtarët e personelit nuk do të kërkojnë ose pranojnë udhëzime nga Qeveria apo nga ndonjë organ tjetër i jashtëm për Autoritetin.

8. Anëtarët e Bordit, anëtarët e personelit, agjentët dhe nënkontraktuesit e Autoritetit, në çdo kohë do të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të marra gjatë kryerjes së detyrave të tyre apo në emër të Autoritetit dhe jo në sferën publike, të cilat mund të rrezikojnë interesat komerciale apo të tjera të Autoritetit apo të personit që ka paraqitur kërkesë apo të cilit i është lëshuar licenca, certifikata e sigurisë ose leja.

9. Anëtari i personelit do t'iu shmanget konflikteve të interesit që në mënyrë të pafavorshme mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe Autoritetit i deklaron për konfliktet aktuale apo të mundshme të interesit në kohën e rekrutimit dhe më vonë nëse paraqiten konfliktet të tilla aktuale apo të mundshme apo bëhen të dukshme. Sipas këtij neni konfliktet e

interesit mund të paraqiten nga interesat personale ose financiare dhe nga zyrtarët që merren me personin e tillë apo diskutimet dhe vendimet lidhur me personin e afërt.

10. Anëtari i personelit do të deklarojë dhe do të apstenoj nga vendimarrja e ndonjë çështje në të cilën anëtari i personelit apo personi i afërt i tij ka interes personal apo financiar.

11. ARH, është organizatë buxhetore sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

12. Drejtori i përgjithshëm dhe zyrtari financiar i Autoritetit do t'ia dorëzojë Bordit dokumentet e përgatitura në pajtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë për t'i miratuar para nxjerrjes së tyre.

13. Kuvendi do të garantojnë që financimi t'i sigurohet ARH në pajtim me propozimet buxhetore, të miratuara në pajtim me procesin buxhetor.

14. ARH i nënshtrohet auditimit në pajtim me ligjet për auditim në fuqi.

15. Kuvendi në çdo kohë mund të kërkojë që të zbatohen auditime shtesë në ARH, qëllimi i të cilëve do të përcaktohet nga Kuvendi për çdo rast veç e veç.

16. ARH do të krijoj të hyra duke përfshirë mirëpo duke mos u kufizuar vetëm në të hyra nga taksat për aplikacione për licenca, leje speciale, licenca tjera të cilat do të specifikohen me një akt nënligjor nga ARH në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe Ministrinë e Financave.

17. ARH do të shfrytëzoj të hyra të dedikuara në bazë të paragrafit 16 të këtij neni në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

18. Ofruesit e shërbimeve një herë në vit duhet ti raportojnë ARH për punën e tyre.

KREU IV

RRJETI HEKURUDHOR DHE INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Neni 40

Rrjeti hekurudhor i Kosovës

Rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga linjat hekurudhore nacionale ekzistuese dhe ato të ardhshme të Kosovës, cilat ofrojnë qasje tek terminalët apo lokacionet e tjera specifike që iu shërbejnë një apo më shumë shfrytëzuesve të shërbimeve hekurudhore.

Neni 41

Infrastruktura hekurudhore e Kosovës në shfrytëzim të përbashkët

Rrjeti publik hekurudhor i Kosovës përbëhet nga linjat e tanishme dhe të ardhshme nacionale hekurudhore të Kosovës të cilat shërbejnë apo janë në gjendje t'iu shërbejnë terminaleve apo ndonjë lokacioni tjetër që ofron shërbime hekurudhore më shumë se sa një shfrytëzuesi. Ky rrjet quhet rrjeti hekurudhor publik i Kosovës i shfrytëzimit të përbashkët dhe duhet të ofrojë mundësi qasjeje për çdo ndërmarrje hekurudhore që i plotëson kushtet për këtë. Kjo përjashton shërbimet private të binarëve industrial në pronësi private, që shfrytëzohen për shërbimet e mallrave të veta.

Neni 42

Infrastruktura hekurudhore

1. Infrastruktura hekurudhore përbëhet nga pjesët në vazhdim me kusht që ato të formojnë pjesën e binarëve hekurudhor duke përfshirë binarët industrial, por duke përjashtuar linjat e vendosura brenda punëtorive për riparimet hekurudhore, depot apo hangarët e lokomotivave si dhe linjat degëzuese apo binarët industrial privat:

1.1. pjesa tokësore;

1.2. binari dhe shtrati i binarit në veçanti argjinatura, prerjet, kanalet e drenazhimit dhe binarët e ngushtë, kanalet e murosura, lëshesat, muret mbrojtëse përgjatë linjës, gjelbërimi për mbrojtjen e pjesëve anësore të pjerrëta etj; personat për udhëtarë dhe mallra, rruga katërkëmbëshe dhe rrugicat, muret rrethuese, mjetet mbrojtëse, rrethojat; shiritat për mbrojtje nga zjarri; aparaturat për nxemjen e ndërruesve, kryqëzimet, rrjetat për mbrojtje nga bora; etj.

1.3. strukturat inxhinierike: urat, lëshesat dhe mbikalimet tjera, tunelet, prerjet e mbuluara dhe nënkallimet e tjera; muret mbajtëse dhe strukturat për mbrojtje kundër ortekëve, gurëve rrokullisës etj;

1.4. vendkalimet në nivel, duke përfshirë pajisjet për sigurimin e trafikut rrugor;

1.5. superstruktura, në veçanti: shinat, shinat speciale dhe kontra shinat; traversat dhe traversat gjatësore, lidhëset e vogla për linjën hekurudhore, balasti duke përfshirë çaklën dhe rërën; ndërrueset, kryqëzimet etj; platformat rrotulluese dhe traversat (përveç atyre të rezervuara veçmas për lokomotivat);

1.6. rruga e qasjes për udhëtarët dhe mallrat, duke përfshirë edhe qasjen me anë të rrugës;

1.7. siguria, instalimet sinjalizuese dhe telekomunikuese në binarin e hapur, në stacione dhe në depot për formimin e trenave, duke përfshirë elektranat për gjenerimin, transformimin dhe shpërndarjen e rrymës elektrike për sinjalizim dhe telekomunikim; ndërtesat për instalimet e tilla apo elektranat; pajisjet frenuese të binarit;

- 1.8. instalimet e ndriçimit për qëllime të trafikut dhe të sigurisë;
- 1.9. elektrana për transformimin dhe bartjen e energjisë elektrike për tërheqjen e trenave, nënstacionet, kabllot e furnizimit ndërmjet nënstacioneve dhe përçuesit kontaktues, rrjeti kontaktues dhe mbështetjet; binari i tretë me mbështetjet;
- 1.10. Ndërtesat e shfrytëzuara nga menaxheri i infrastrukturës.

Neni 43 **Kryqëzimet hekurudhë – rrugë**

1. Kryqëzimet me binarë duhen të bëhen me mbikalime ose nënkalime, përveç nëse ndërtimi i kryqëzimeve të tilla nuk do të ishte ekonomik apo nëse e pengon sigurinë e trafikut hekurudhor.
2. Nëse kryqëzimi i një linje hekurudhore dhe rruge publike apo rruge të pa kategorizuar, bëhet për shkak të ndërtimit të një rruge të re, atëherë shpenzimet për ndërtimin e kryqëzimeve, mbikalimeve dhe nënkalimeve, shpenzimet për vendosjen e pajisjeve dhe elementeve tjera të nevojshme në rrugën e re dhe në binarë, si dhe shpenzimet tjera për sigurimin e trafikut në rrugën e re, duhet të barten nga investitori i rrugës së re.
3. Përgjegjësinë për sigurimin e vendkalimeve në nivel rrugë-hekurudhë si dhe për vendosjen e shenjzimeve rrugore e mbanë pronari i vendkalimit, respektivisht institucioni përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugës e cila kryqëzohet me hekurudhën.
4. Ndërtimi i nënkalimeve, mbikalimeve apo vendkalimeve në nivel pa pëlqimin paraprak të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore nuk mund të bëhet. Ndërtimi i nënkalimeve, mbikalimeve apo vendkalimeve në nivel pa pëlqimin paraprak të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore do të eliminohet menjëherë nga menaxheri i infrastrukturës hekurudhore dhe shpenzimet për eliminimin e nënkalimit, mbikalimit apo vendkalimit në nivel do të barten nga institucioni i cili i ka ndërtuar ato.

KREU V

OPERIMI DHE SHFRYTËZIMI I INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

NËNKREU I

Menaxheri i infrastrukturës së rrjetit të shfrytëzimit të përbashkët

Neni 44

Menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore

Menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore bëhet nga menaxheri i infrastrukturës hekurudhore i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së tij dhe për ofrimin e shërbimeve përkatëse për ndërmarrjet hekurudhore të cilat ofrojnë shërbime të transportit. Menaxhimi i infrastrukturës duhet të përfshijë funksionet esenciale të pagesave të rrjetit, duke përfshirë këtu përcaktimin dhe mbledhjen e pagesave, si dhe alokimin e traseve.

Neni 45

Themelimi i menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore në Kosovë

1. Infrastruktura hekurudhore ekzistuese e shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë është pronë shtetërore, menaxhimin e së cilës shteti ia delegon menaxherit të infrastrukturës hekurudhore, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS) është e krijuar si ndërmarrje me pronësi publike sipas Ligjit për ndërmarrjet publike.
2. Misioni i INFRAKOS-it është që të zhvilloj dhe mirëmbaj infrastrukturën hekurudhore ekzistuese të shfrytëzimit të përbashkët dhe të operoj me te me objektivin e promovimit të transportit hekurudhor në këtë vend si një lloj transporti të qëndrueshëm dhe efikas për shoqërinë dhe ekonominë.
3. INFRAKOS-i është gjithashtu përgjegjës për operimin e infrastrukturës duke ofruar qasje në infrastrukturë dhe duke vendosur pagesat për shfrytëzimin e infrastrukturës.
4. Asetet të cilat e përbëjnë infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, si dhe ndërtesat që nuk i janë dhënë operimeve hekurudhore dhe që i takojnë shtetit transferohen nën menaxhimin e INFRAKOS-it.
5. INFRAKOS-i do të funksionoj mbi baza komerciale përveç nëse nuk definohet ndryshe në këtë ligj.
6. INFRAKOS duhet të ketë licencë dhe autorizim të sigurisë ashtu siç është e rregulluar me këtë ligj.
7. Duke pasur parasysh projektet për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë, menaxheri i infrastrukturës hekurudhore

mund të konsultohet nëse është e nevojshme gjatë negocijimit dhe të nënshkruaj kontratë të partneriteti në përputhje me legjislacionin në fuqi nëse arrihet vendimmarrje për këtë proces.

8. Raporti ndërmjet shtetit dhe INFRAKOS-it që është në pronësi publike është i përshkruar në kontratë. Kjo kontratë duhet të siguroj menaxhim të pavarur të INFRAKOS-it, stafit dhe menaxherëve.

9. Bordi dhe kryetari i INFRAKOS-it emërohet në përputhje me Ligjin mbi ndërmarrjet publike në Kosovë.

10. Misioni dhe statuti i INFRAKOS-it do të përshkruhet me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14. Ky akt gjithashtu do të precizoj, duke u bazuar në Ligjin mbi ndërmarrjet publike numrin e anëtarëve të bordit të INFRAKOS-it dhe modalitetet për nominimin dhe zgjedhjen e tyre,

11. Duke qenë ndërmarrje me pronësi publike, INFRAKOS-i duhet t'i përmbush rregullat e përshkruara në ligjin e Kosovës për ndërmarrjet në pronësi publike lidhur me kontrollin ekonomik, financiar dhe teknik.

12. INFRAKOS-i merr përsipër të drejtat dhe obligimet që kanë të bëjnë me asetet e transferuara nga Hekurudhat e Kosovës ShA me përjashtim të dëmtimeve që janë shkaktuar para datës së transferimit dhe taksave që kanë të bëjnë para datës së transferimit.

13. Të gjitha transferimet e aseteve të përshkruara më sipër lirohen nga tatimet dhe pagesat për shtetin.

14. Asetet në pronësi publike të INFRAKOS-it mbrohen nga uzurpimi ashtu siç është përshkruar në Kreun X të këtij ligji. INFRAKOS-i dhe shteti kanë për obligim që me mbështetjen e policisë dhe të institucioneve të tjera të veprojnë kundër uzurpimeve. Modalitetet e veprimeve të cilat duhet të ndërmerren do të përcaktohen me akt nënligjor.

15. Të hyrat e INFRAKOS-it janë të hyrat e paguara nga ndërmarrjet hekurudhore që shfrytëzojnë infrastrukturën hekurudhore në pronësi publike të shfrytëzimit të përbashkët si dhe shërbimet përkatëse, të hyrat e tjera që kanë të bëjnë me asetet dhe aktivitetet e tjera të INFRAKOS-it, kontributet shtetërore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe ndonjë kontribut tjetër me origjinë publike apo private.

16. Parimet e llogaritjes së pagesave të shfrytëzimit të infrastrukturës paraqiten me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së Nr. 2001/14, si dhe në propozimet e direktivës së re mbi themelimin e hapësirës unike hekurudhore evropiane të shtatorit 2010. Ato duhet të lejojnë shfrytëzim optimal të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe të lejojnë qasje të drejt dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore.

17. INFRAKOS-i duhet të publikoj çdo vit ekspozenë e rrjetit të freskuar ashtu siç është definuar në këtë ligj. Ky dokument duhet të përshkruaj infrastrukturën hekurudhore të

shfrytëzimit të përbashkët duke përfshirë linjat që lidhen me терминаlet dhe portet tokësore, pajisjet dhe shërbimet e tjera të cilat mund të jenë në dispozicion si dhe kushtet për të pasur qasje në këtë infrastrukturë dhe në këto shërbime.

18. INFRAKOS-i duhet të krijoj regjistrin e infrastrukturës për infrastrukturën të cilën e menaxhon.

19. INFRAKOS-i përveç ekspozitit të rrjetit mund të lëshojë edhe dokumente tjera administrative të cilat do të përdoren për marrëdhëniet e tij me ndërmarrjet hekurudhore apo çfarëdo entiteti tjetër që merret me këtë çështje. Këto dokumente duhet të bëhen publike.

20. Shteti mund të negocioj dhe të nënshkruaj kontrata dhe të realizoj projekte për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

21. Shteti përveç INFRAKOS-it mundet t'ua delegoj edhe tjerëve menaxhimin e infrastrukturës së re hekurudhore të zhvilluar në përputhje me PPP apo koncesionimin. Kontrata ndërmjet shtetit dhe menaxherit të ri të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët do të precizoj kushtet që do të garantojnë sigurinë dhe interoperabilitetin e operimeve të infrastrukturës dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike, si dhe obligimin për lëshimin e Ekspozitit të Rrjetit dhe lejimin e qasjes fer, transparente, jodiskriminuese infrastrukturës së re hekurudhore.

22. Secili menaxher i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët përveç INFRAKOS-it, duhet të ketë autorizimin e sigurisë.

23. Përveç INFRAKOS-it, çdo menaxher tjetër i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet gjithashtu të bëjë publike rregullat dhe vendimet që kanë të njëjtin objekt sikurse aktet administrative të INFRAKOS-it. Ata duhet të lëshojnë çdo vit ekspozitë e rrjetit të freskuar, si dhe të përgatisin dhe freskojnë regjistrin e infrastrukturës të cilën ata e menaxhojnë.

24. INFRAKOS-i dhe secili menaxher tjetër i infrastrukturës hekurudhore duhet të bashkëpunojnë me menaxherët e tjerë të infrastrukturës hekurudhore në regjionin e Ballkanit dhe në Evropë për të ndërtuar trasetë ndërkombëtare dhe optimizuar shfrytëzimin e rrjetit hekurudhor Evropian.

Neni 46

Licenca dhe autorizimi i sigurisë për menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët

1. Secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të aplikoj në organin licencues dhe të marr licencën.

2. Kushtet për dhënie e licencës janë:

- 2.1. selitë e entiteteve ligjore duhet janë në territorin e Kosovës
- 2.2. kompania është e regjistruar për aktivitetin e menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore;
- 2.3. kompania nuk është në procedurë bankrotimi;
- 2.4. personi përgjegjës apo anëtari i organit menaxhues të entitetit ligjor në momentin e marrjes së licencës nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale apo ndaj tij nuk është iniciuar ndonjë procedurë për vepër penale;
- 2.5. kompania është e aftë financiarisht, pra mund të plotësoj obligimet e veta të tanishme apo të ardhshme nën kushte normale të operimit brenda dymbëdhjetë (12) muajsh;
- 2.6. kompania është e siguarur në një kompani sigurimesh dhe paraqet dëshmi me shkrim se është në gjendje të dëmshpërblej dëmtimet eventuale të shkaktuara gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta sipas rregulloreve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që janë obliguese për Kosovën.

3. Secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të aplikoj dhe të merr autorizimin e sigurisë nga autoriteti nacional që është kompetent për sigurinë hekurudhore. Ky autorizim i sigurisë duhet të rishqyrtohet në intervale kohore që nuk kalojnë pesë (5) vite.

4. Kushtet dhe procedurat, si dhe format e aplikimeve për marrjen e autorizimit të sigurisë do të përshkruhen me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49.

Neni 47

Menaxhimi i infrastrukturës hekurudhore në rrethana të jashtëzakonshme

1. Në rast të ndërprerjes së trafikut hekurudhor të shkaktuar nga defektet teknike, aksidentet serioze, aksidentet apo incidentet; menaxheri i infrastrukturës hekurudhore i shfrytëzimit të përbashkët duhet të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të rivendosur kushte normale të trafikut në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.
2. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të përgatisë planet rezervë ku përfshihen të gjitha autoritetet dhe institucionet që duhet të informohen në rast të aksidentit serioz, aksidentit apo incidentit apo të ndërprerjes serioze të trafikut të trenave.
3. Në rast emergjence kur infrastruktura hekurudhore nuk mund të shfrytëzohet, atëherë menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët mund të anuloj shfrytëzimin e linjave të trenave pa i njoftuar paraprakisht transportuesit për aq kohë sa është e domosdoshme për riparimin e infrastrukturës. Ai gjithashtu mund të kërkoj nga transportuesit që t'i vënë në dispozicion burimet për normalizimin e situatës sa më shpejt që të jetë e mundur.

4. Nëse konsideron se është e domosdoshme, menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të kërkojë nga transportuesit t'i vënë në dispozicion burimet e tilla të cilat menaxheri i konsideron të nevojshme në mënyrë që për një kohë sa më të shkurt të mundshme të normalizohet trafiku.

NËNKREU II

Ofruesit e pajisjeve speciale hekurudhore

Neni 48

Ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore

1. Pajisja speciale hekurudhore nënkupton lidhjen hekurudhore me rrjetin për qëllim të ofrimit të shërbimeve për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave, e cila nuk është as port e as terminal. Ofruesi i pajisjeve hekurudhore, nënkupton personin i cili ofron pajisjet speciale të shërbimeve hekurudhore.

2. Ministria vendos nëse ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore do të deklarohet si menaxher i infrastrukturës i cili njëkohësisht do të jetë organ i cili aplikon pagesën dhe bënë alokimin e traseve të trenit. Në këtë rast ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore është i obliguar që të aplikojë për licencë dhe certifikatë bazuar në këtë ligj. Ky po ashtu është i obliguar që të prezanton ekspozitën e thjeshtësuar të rrjetit dhe të bënë kontrata kornizë apo kontratat për qasje në binarë, ashtu sikurse kërkohet me këtë ligj. Deklarata e tillë e rrjetit duhet të përpilohet sipas aktit nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14 dhe propozimin për direktivën e re mbi Hapësirën Unike Evropiane të Transportit të shtatorit 2010.

3. Nëse Ministria vendosë që ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore nuk ka nevojë të deklarohet si menaxher i infrastrukturës dhe organ i cili aplikon pagesat për rrjet dhe bënë alokimin e trasesë, atëherë ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore nuk ka nevojë që të ketë licencë dhe autorizim të sigurisë.

4. Ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore ka të drejtë të kryejë transport në llogari të vetë për qëllimet e veta dhe për ato komerciale.

5. Në rast të transportit për nevojat e veta, atëherë ai nuk duhet të kërkojë licencë për ndërmarrjet hekurudhore apo të aplikojë për autorizim të thjeshtë të sigurisë, por duhet të jetë në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me sigurinë e transportit hekurudhor sikurse kërkohet me këtë ligj dhe me rregulloret pasuese. Deklarata e tillë e thjeshtësuar e rrjetit duhet të përpilohet sipas aktit nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14 dhe propozimin për direktivën e re mbi Hapësirën Unike Evropiane të Transportit të shtatorit 2010.

6. Ministria me një akt nënligjor duhet t'i përshkruajë të drejtat dhe obligimet për ofruesin e pajisjeve speciale hekurudhore të cilat kanë të bëjnë me operimet e sigurta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen si dhe menaxhimin.

NËNKREU III

Termet dhe kushtet e përgjithshme për qasje dhe shfrytëzim të rrjetit hekurudhor

Neni 49

Parimet e përgjithshme për qasje dhe transit

1. Ndërmarrjeve hekurudhore në rrjetin e Hekurudhave të Republikës së Kosovës, duhet të iu jepet qasje dhe transit në kushte të barabarta dhe jo diskriminuese, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj.
2. Është detyrë e menaxherit të infrastrukturës hekurudhore që të siguroj se janë respektuar të drejtat e akorduara për ndërmarrjet hekurudhore në përputhje me këtë ligj.
3. Për ndërmarrjet hekurudhore qasja në infrastrukturën hekurudhore duhet të autorizohet nga menaxheri i infrastrukturës.
4. Nëse ndërmarrjes hekurudhore i mohohet qasja në infrastrukturë, ka të drejt të ankohet në ARH.
5. Ndërmarrjeve hekurudhore duhet që të iu jepet e drejta e qasjes në rrjetin e shteteve tjera në kushte të barabarta dhe jo diskriminuese me qëllim të operimit me shërbime ndërkombëtare.

Neni 50

Qasja në terminale

1. Qasja në binarë dhe ofrimi i shërbimeve në terminale të lidhura me aktivitetet hekurudhore që i shërbejnë apo që potencialisht mund të i shërbejnë më shumë se sa një konsumatori final, duhet të iu jepet të gjitha ndërmarrjeve hekurudhore në mënyrë jodiskriminuese dhe transparente, kurse kërkesat e ndërmarrjeve hekurudhore mund t'i nënshtrohen kufizimeve vetëm nëse ekzistojnë alternativat e zbatueshme nga hekurudha sipas kushteve të tregut.
2. Është detyrë e ndërmarrjes e cila është e ngarkuar me infrastrukturën hekurudhore dhe furnizim të shërbimeve në terminale, që të siguroj që qasja dhe shërbimet e furnizimit të jepen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.
3. Nëse ndërmarrjes hekurudhore i mohohet qasja, ajo ka të drejtë të ankohet në ARH.

Neni 51

Qasja në pajisjet speciale hekurudhore

1. Cilido aplikant mund të kërkoj qasje në pajisjet speciale hekurudhore nëse ato pajisje janë:

1.1. binarë hekurudhorë, leje për shfrytëzimin e atij binari për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave, operimin dhe tërheqjen e trenave vetëm në atë binar në mënyrë që të arrihet deri te konsumatori fundor apo për të arritur qasje tek pajisjet speciale hekurudhore te konsumatori final pasi që kjo mund të arrihet vetëm nëpërmes të qasjes së ofruesit të pajisjeve speciale.

1.2. binar hekurudhor, leje për shfrytëzimin e binarit për qëllim të arritjes tek depoja e mirëmbajtjes apo vendi i furnizimit me energji elektrike, e që mund të arrihet vetëm nëpërmes të qasjes së ofruesit apo ofruesve të pajisjeve.

1.3. binar hekurudhor dhe shërbime të afërme, leje për binarin e tillë hekurudhor dhe shërbimet e afërme për qëllim të garazhimit apo mbajtjes së përkohshme të mjeteve lëvizëse lidhur me operimin dhe tërheqjen e trenave vetëm në atë binar apo në ndonjë binar tjetër i cili mund të arrihet vetëm nëpërmes të qasjes të ofruesin të pajisjeve.

1.4. pajisjet e ofruesve, leja për shfrytëzimin e pajisjeve të ofruesve që kanë të bëjnë me operimin e rrjetit dhe pajisjeve të tij shërbyese tek të cilat mund të arrihet vetëm nëpërmes të qasjes të ofruesit të pajisjeve.

2. Në rastin kur aplikuesi nuk ka sukses në arritjen e marrëveshjes për qasje me ofruesin e pajisjeve speciale hekurudhore, atëherë ai mund të kërkoj intervenimin e Organit Rregullativ të Tregut.

3. Në bazë të ankesës nga aplikuesi apo me vetiniciativë, Organi Rregullativ i Tregut mund të vendos që ofruesi i pajisjeve speciale hekurudhore të futet në kontratën e qasjes me aplikuesin, për qëllim apo në lidhje me shfrytëzimin e pajisjeve speciale hekurudhore të specifikuara. Kjo e gjitha mund të bëhet pasi që të jetë bërë ekzaminimi i plotë nëse dhe deri në cilën masë ekziston:

3.1. mungesa e alternativave të suksesshme nga hekurudha në kushtet e tregut;

3.2. mungesa e alternativave të zëvendësueshme nga hekurudha nën kushtet e tregut;

3.3. abuzimi i eksploatues për shkak të sjelljes monopoliste;

3.4. përjashtimi i aplikantëve të tjerë, konkurruesve apo sjelljes kundër konkurruese;

3.5 sjelljeve tjera diskriminuese.

4. Nëse ofruesi i pajisjeve shërbyese speciale hekurudhore nuk zbaton vendimin, Organi Rregullativ i Tregut ka të drejtë të shfrytëzojë mundësitë ligjore për detyrimin e tij.

Neni 52

Qasja në shërbime

1. Aplikantët duhet që në baza jo diskriminuese të kenë të drejtë në pakon minimale të qasjes dhe qasje në binarë në pajisjet shërbyese siç janë të përshkruara në këtë ligj. Ofrimi i shërbimeve (qasja në binarë për pajisjet shërbyese dhe shërbimet e furnizimit) duhet të bëhet në mënyrë jo diskriminuese, ndërsa kërkesat nga ndërmarrjet hekurudhore mund të refuzohen vetëm nëse ekzistojnë alternativa të zbatueshme në kushte të tregut. Nëse ofrimi i shërbimeve nuk bëhet nga një menaxher i infrastrukturës, ofruesi i infrastrukturës kryesore duhet të shfrytëzojë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për lehtësimin e këtyre shërbimeve dhe këtë ta publikoj në ekspozitë të rrjetit.

2. Kur menaxheri i infrastrukturës ofron ndonjërin nga shërbimet e parapara me këtë ligj si shërbime shtesë, ai duhet t'i ofrojë ato me kërkesë të ndërmarrjes hekurudhore.

3. Ndërmarrjet hekurudhore mund të kërkojnë shërbime të mëtejme ndihmëse të shënuara në këtë ligj nga menaxheri i infrastrukturës apo nga furnizuesit e tjerë. Menaxheri i infrastrukturës nuk është i obliguar që t'i ofroj ato shërbime.

4. Shërbimet me të cilat furnizohen ndërmarrjet hekurudhore janë:

4.1. pakoja minimale e qasjes duhet të përfshijë:

4.1.1. trajtimin e kërkesave për kapacitetin e infrastrukturës;

4.1.2. të drejtën e shfrytëzimit të kapacitetit që është dhënë;

4.1.3. shfrytëzimin e ndërrueseve të binarëve dhe njejtve hekurudhore;

4.1.4. kontrollin e trenit duke përfshirë sinjalizimin, rregullimin, nisjen, komunikimin dhe ofrimin e informacionit mbi lëvizjen e trenit;

4.1.5. tërë informacionin tjetër i cili kërkohet për zbatimin apo operimin e shërbimeve për të cilat është dhënë kapaciteti.

4.2. pajisjet shërbyese për qasje në binarë dhe ofrimi i shërbimeve duhet të përfshijë:

4.2.1. shfrytëzimin e pajisjes së furnizimit me rrymë elektrike për tërheqje të trenave kur është në dispozicion;

4.2.2. pajisjet për furnizimin me karburant;

4.2.3. stacionet e udhëtarëve, ndërtesat e tyre dhe pajisjet e tjera;

4.2.4. терминалет e mallrave;

- 4.2.5. stacionet përmbledhëse;
- 4.2.6. pajisjet për formimin e trenave;
- 4.2.7. binarët anësorë të magazinimit;
- 4.2.8. pajisjet e mirëmbajtjes dhe pajisjet e tjera teknike.

4.3. shërbimet shtesë përbëhen nga:

- 4.3.1. rryma e tërheqjes;
- 4.3.2. para nxehja e trenave të udhëtarëve;
- 4.3.3. furnizimi me derivate, manovrimi dhe të gjitha shërbimet e tjera shtesë të ofruara në pajisjet shërbyese për qasje në binar të përmendura më sipër;
- 4.3.4. kontratat e përshtatura për:
 - 4.3.4.1. kontrollin e transportit të mallrave të rrezikshme;
 - 4.3.4.2. asistencën në qarkullimin e trenave të parregullt.

4.4 shërbimet ndihmëse përfshijnë:

- 4.4.1. qasjen në rrjetin telekomunikues;
- 4.4.2. ofrimin e informacionit shtesë;
- 4.4.3. inspektimin teknik të mjeteve lëvizëse.

5. Nëse aplikuesit i mohohet qasja në shërbime të cilat ofruesi i shërbimeve është i obliguar t'ia ofroj, atëherë aplikuesi ka të drejt të ankohet në Organin Rregullativ të Tregut.

6. Kur operatori i ofrimit të pajisjeve shërbyese i përket organit apo kompanisë e cila është aktive dhe mbanë pozitë dominante së paku në njërin nga tregjet e shërbimeve të transportit hekurudhor për të cilat përdoren pajisjet, atëherë operatori duhet të organizohet në atë mënyrë që të jetë i pavarur nga ky organ apo kompani në aspektin legal, organizativ dhe të vendimmarrjes.

7. Refuzimi i kërkesave të ndërmarrjeve hekurudhore për qasje në pajisjet shërbyese mund të bëhet vetëm nëse ka alternativa të zbatueshme me të cilat iu lejohej atyre operimi me shërbimet e udhëtarëve apo të mallrave në të njëjtën linjë dhe në kushte ekonomike të pranueshme. Barra e argumentimit të ekzistimit të një alternative të përshtatshme, mbetet mbi operatorin e pajisjeve shërbyese.

8. Kur operatori i pajisjeve shërbyese has në konflikt ndërmjet kërkesave të ndryshme, ai duhet bërë krahasimin më të mirë të mundshëm të të gjitha kërkesave. Nëse nuk ekziston ndonjë alternativë e përshtatshme dhe mundësia e akomodimit të të gjitha kërkesave për kapacitetet e pajisjeve relevante mbi bazat e nevojave të demonstruara, atëherë Organi Rregullativ i Tregut me nismën e vet apo në bazë të ankesave duhet të ndërmerr veprimet e duhura që të sigurojë se pjesa e duhur e kapaciteteve i është dhënë ndërmarrjeve hekurudhore të cilat nuk janë pjesë e organit apo kompanisë tek të cilat bënë pjesë operatori i pajisjeve.

9. Kur pajisjet shërbyese nuk kanë qenë në përdorim dy (2) vite rresht, atëherë pronari i tyre duhet që të bëjë publikimin e operimit të pajisjeve për dhënie apo marrje me qira.

Neni 53

Qasja në pajisjet e trajnimit

1. Ndërmarrjet hekurudhore që aplikojnë për certifikatë të sigurisë duhet të kenë qasje të drejt dhe jo diskriminuese në pajisjet e trajnimit për trajnimin e makinistëve dhe stafin shoqërues të trenave kurdo që një trajnim i tillë është i domosdoshëm për plotësimin e kërkesave për të marrë certifikatën e sigurisë.

2. Shërbimet e ofruara duhet të përfshijë trajnimin mbi domosdoshmërinë e njohjes të linjave, rregullave të operimit dhe procedurat, sinjalizimin dhe sistemin e telekomandimit si dhe procedurat e emergjencës të cilat aplikohen në operimin e linjave.

3. Menaxherët e infrastrukturës dhe stafi i tyre të cilët kryejnë punët vitale të sigurisë duhet të kenë qasje të drejt dhe jo diskriminuese në pajisjet e trajnimit.

4. Nëse shërbimet e trajnimit nuk përshijnë provimet dhe dhënien e certifikatave, atëherë ministria duhet të siguroj qasjen e ndërmarrjes hekurudhore në atë certifikim nëse kjo ka të bëjë me kërkesën për certifikatën e sigurisë.

5. Autoriteti i sigurisë duhet të siguroj që ofrimi i shërbimeve të trajnimit, apo kur është e përshtatshme dhënia e certifikatës t'i plotëson kërkesat e sigurisë.

6. Nëse pajisjet e trajnimit janë në dispozicion vetëm përmes të shërbimeve të një ndërmarrje të vetme hekurudhore apo të një menaxheri të vetëm të infrastrukturës, atëherë ministria duhet të siguroj se ato do të jenë në dispozicion për ndërmarrjet e tjera hekurudhore me një çmim të arsyeshëm dhe jo diskriminues dhe me kosto që mund të përfshijë një profit të vogël.

7. Kur bëhet rekrutimi i makinistëve të rinj, atëherë stafi i ndërmarrjes hekurudhore që është në bordin e trenit dhe stafi që kryen detyrat vitale të sigurisë, duhet të jenë në gjendje të marrin parasysh ndonjë trajnim, kualifikim dhe përvojë të fituar më parë nga ndërmarrjet e tjera hekurudhore. Për këtë qëllim këta anëtarë të stafit duhet të kenë të drejt të kenë qasje, t'i marrin kopjet dhe t'i komunikojnë të gjitha dokumentet të cilat dëshmojnë trajnimin e tyre, kualifikimet dhe përvojën.

8. Nëse aplikuesit i mohohet qasja në pajisjet e trajnimit, atëherë ai ka të drejt të ankohet tek Organi Rregullativ i Tregut.

Neni 54

Kabotazhi dhe kufizimet për të drejtën e qasjes në infrastrukturë

1. Ndërmarrjet hekurudhore gjatë kryerjes së shërbimit ndërkombëtar të transportit duhet të kenë të drejtë që në cilindo stacion apo terminal të vendosur në linjat ndërkombëtare të marrin udhëtarë dhe mallra dhe t'i dërgojnë ata deri te destinacioni tjetër duke përfshirë këtu stacionet dhe терминаlet e vendosura në shtetin tjetër.

2. Ministria mund të kufizoj të drejtën e qasjes të definuar në paragrafin 1. për shërbimet ndërmjet vendit të nisjes dhe destinacionit, e të cilat janë të mbuluara nga një apo më shumë kontrata të shërbimit publik. Ky kufizim mund të mos ketë efekt në kufizimin e të drejtës për të marrë udhëtarë apo mallra në ndonjë stacion apo terminal të vendosur në linjat e shërbimit ndërkombëtar dhe t'i dërgojnë ata tek një destinacion tjetër duke përfshirë stacionet dhe терминаlet e vendosura në Kosovë, përveç nëse realizimi i kësaj të drejte do të prishte ekuilibrin ekonomik të kontratës së shërbimit publik.

3. Se a do të prishtet ekuilibri ekonomik kjo duhet të përcaktohet nga Organi Rregullativ i Tregut - organi relevant rregullativ mbi bazën e analizës objektive ekonomike dhe bazuar në kriteret e parapërcaktuara duke pasuar kërkesën nga:

3.1. Ministria apo autoritetet kompetente regjionale apo komunale të cilat e kanë dhënë kontratën e shërbimit publik,

3.2. ndonjë autoritetet tjetër kompetent i interesuar me të drejtën e kufizimit të qasjes sipas këtij neni,

3.3. menaxheri i infrastrukturës, apo

3.4. ndërmarrja hekurudhore e cila zbaton kontratën e shërbimit publik.

4. Autoritetet kompetente dhe ndërmarrjet hekurudhore të cilat ofrojnë shërbime publike duhet t'i ofrojnë Organit Rregullativ të Tregut informacionin e kërkuar me arsyetim në mënyrë që të vihet deri te ai vendim. Autoriteti Rregullativ Hekurudhor duhet të merr parasysh gjithë informacionin e ofruar, kur kjo është e përshtatshme t'i konsultoj palët relevante dhe njëkohësisht duhet t'i informoj palët relevante për vendimin e marrë. Kjo duhet të bëhet brenda një kohe të parapërcaktuar dhe të arsyeshme dhe në çfarëdo rasti brenda dy (2) muajsh nga dita e marrjes së të gjithë informacionit relevant.

5. Organi Rregullativ i Tregut duhet t'i ofrojë faktet për vendimin e vet dhe të specifikoj kohën dhe kushtet brenda të cilave entitetet në vijim mund të kërkojnë rishqyrtimin e vendimit:

5.1. autoriteti relevant kompetent apo autoritetet kompetente;

5.2. menaxheri i infrastrukturës;

5.3. ndërmarrja hekurudhore që zbaton kontratën e shërbimit publik; apo

5.4. ndërmarrja hekurudhore që kërkon qasje.

6. Ministria gjithashtu mundet të kufizoj të drejtën për marrjen dhe zbritjen e udhëtareve në linjat e shërbimit ndërkombëtar të udhëtarëve në rastet kur e drejta ekskluzive për bartjen e udhëtareve ndërmjet stacioneve është dhënë më parë sipas kontratës së koncesionit në bazë të një procedure tenderuese dhe të një konkurrence të drejt. Ky kufizim mund të vazhdoj gjatë kohëzgjatjes së kontratës fillestare apo për pesëmbëdhjetë (15) vite, merret cilido version që është më i shkurtër.

7. Organi Rregullativ i Tregut siguron zbatimin transparent dhe jo diskriminues të vendimeve të referuara në këtë nen.

8. Autoritetet kompetente të cilat lidhin kontratat e shërbimit publik, mund të vënë taksë për ndërmarrjet hekurudhore të cilat ofrojnë shërbime për udhëtarë për operim në linjat të cilat janë në kuadër të juridiksionit të këtij autoriteti dhe që operojnë në Kosovë.

9. Në këtë rast ndërmarrjet hekurudhore që ofrojnë shërbime të transportit hekurudhor vendor dhe ndërkombëtar të udhëtareve do t'i nënshtrohen të njëjtës taksë mbi operimin e linjave që janë në kuadër të juridiksionit të atij autoriteti.

10. Taksa synon që të kompenson autoritetin kompetent publik për obligimet e shërbimeve publike ashtu siç përshkruhet në kontratat e dhëna të shërbimit publik.

11. Të hyrat nga një taksë e tillë dhe e paguar si kompensim mund të mos e mbulojnë atë që është e domosdoshme për të mbuluar tërë apo një pjesë të kostos së shkaktuar nga obligimet e shërbimit publik relevant duke marrë parasysh pranuesit relevant dhe fitimin e arsyeshëm për kryerjen e atyre obligimeve.

12. Taksa e vënë duhet t'i respektoj në veçanti parimet e paanësisë, transparencës, jodiskriminimit dhe proporcionalitetit, e në veçanti raportin ndërmjet çmimit mesatar të shërbimit për udhëtarët dhe nivelit të asaj takse.

13. Totali i taksave të vëna sipas këtij paragrafi nuk duhet të rrezikoj zbatueshmërinë ekonomike të shërbimit hekurudhor të transportit të udhëtarëve për të cilat ato janë vënë.

14. Autoritetet relevante duhet të mbajnë informacionet e domosdoshme për të siguruar trajtimin e origjinës dhe shfrytëzimit të taksave.

15. Organi Rregullativ i Tregut duhet të informohet paraprakisht për çdo vendim të marrë nga autoriteti publik relevant që të mund të kërkoj tërë informacionin që ka ndikuar në planifikimin e taksës, ta kontrollojë përputhjen me parimet e paanësisë, transparencës, jo diskriminimit, proporcionalitetit dhe caktimit së çmimit të paraqitur në këtë ligj.

16. Autoriteti publik relevant duhet të merr parasysh observimet dhe shënimet e Organit Rregullativ të Tregut në procesin e vendimmarrjes para zbatimit të asaj takse.

17. Ndërmarrjet hekurudhore që i nënshtrohen taksës së paraqitur në këtë ligj, kanë të drejtë të paraqesin ankesë tek Organi Rregullativ i Tregut.

18. Padia kundër vendimit të referuar në këtë ligj mund të iniciohet, ndërsa procedura administrative duhet të iniciohet në gjykatën kompetente brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

NËNKREU IV EKSPOZEU I RRJETIT

Neni 55 Ekspozeu i Rrjetit

Çdo menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët pas konsultimeve me palët e interesuara dhe Organin Rregullativ të Tregut duhet të publikoj Ekspozeun e rrjetit sikurse është definuar në këtë ligj. Ky ekspoze duhet të përmbajë përshkrimin e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, rregullat e përgjithshme për aplikimin për trasetë e trenit, tarifat dhe qasjen në infrastrukturën hekurudhore, rregullat për alokimin e kapacitetit dhe informacionin tjetër esencial për raportet e punës ndërmjet menaxherit të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore.

Neni 56 Rrjeti

1. Përmbajtja e obligueshme e ekspozeut të rrjetit duhet të përshkruhet me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën 2001/14/EC dhe në propozimin e direktivës së re mbi Hapësirën Unike Evropiane të Transportit të shtatorit 2010. Ky ekspoze së paku duhet të përmbajë seksionet vijuese:

1.1. seksionin i cili paraqet natyrën e infrastrukturës që është në dispozicion për ndërmarrjet hekurudhore dhe kushtet për qasje në te;

1.2. seksionin për parimet e vendosjes së çmimeve dhe pagesave të shfrytëzimit. Kjo duhet të përmbajë detajet e skemës së vendosjes së çmimeve sipas këtij ligji e gjithashtu informacionet e mjaftueshme për pagesat që aplikohen për shërbimet e vendosura e që janë përcaktuar nga vetëm një furnizues. Duhet të jep detaje për metodologjinë, rregullat dhe kur është e aplikueshme shkallët e shfrytëzuara për aplikim. Duhet të përmbajë informacionin mbi ndryshimet e pagesave të cilat tanimë janë vendosur apo janë paraparë;

1.3. seksionin mbi parimet dhe kriteret për alokimin e kapaciteteve. Kjo duhet t'i paraqet karakteristikat e përgjithshme të kapacitetit të infrastrukturës që është në dispozicion të ndërmarrjeve hekurudhore dhe çfarëdo kufizimi në lidhje me shfrytëzimin duke përfshirë kërkesat e kapacitetit për mirëmbajtje. Duhet gjithashtu të specifikojë procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procesin e alokimit të kapacitetit. Ekspozeu duhet të përmbaj kriteret specifike që hyjnë në punë gjatë këtij procesi e në veçanti:

1.3.1. procedurat sipas të cilave aplikuesit mund të kërkojnë kapacitet nga menaxheri i infrastrukturës;

1.3.2. kërkesat që i drejtojnë aplikuesit;

1.3.3. orarin e aplikimit dhe proceset e alokimit;

1.3.4. parimet që e drejtojnë procesin e koordinimit;

1.3.5. procedurat që duhet të pasohen dhe kriteret e shfrytëzuara kur ka mbingarkim në infrastrukturë;

1.3.6. detajet për kufizimet në shfrytëzimin e infrastrukturës;

1.3.7. cilido kusht me të cilin merren parasysh nivelet e mëparshme të shfrytëzimit të kapacitetit në përcaktimin e prioriteteve për procesin e alokimit. Duhet të jepen masat e marra në formë të detajuar për të siguruar trajtim adekuat të shërbimeve të mallrave, shërbimeve ndërkombëtare dhe kërkesave që i nënshtrohen procedurës sipas rastit.

Neni 57 **Përmbajtja e rrjetit**

Ekspozeu i Rrjetit mund të blihet nga palët e interesuara me pagesë e cila nuk tejkalon kostot normale. Marrja e formatit elektronik të Ekspozeut të Rrjetit duhet të bëhet e mundur pa pagesë përmes ueb faqes së ARH.

Neni 58
Konsultimet dhe komentet për ekspozetun e rrjetit

Drafti i Ekspozetut të Rrjetit duhet të dorëzohet tek të gjitha palët e interesit për konsultim. Afati i paraqitjes së komenteve duhet të jetë një (1) muaj nga data e dorëzimit. Ekspozetun i Rrjetit duhet domosdoshmërisht të freskohet në mënyrë të rregullt. Ekspozetun i Rrjetit duhet të publikohet jo më vonë se katër (4) muaj para afatit të fundit për paraqitjen e kërkesave për trasetë e trenit.

Neni 59
Publikimi i ekspozetut së rrjetit

Ekspozetun i rrjetit duhet të publikohet në gjuhën shqipe, serbe dhe anglishte.

Neni 60
Detyrimet për ekspozetun e rrjetit

Në rast të informatave joadekuade mund të kërkohen gjopa dhe sanksione kundër menaxherit të infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët, ndërsa për detyrimin e tij mund të angazhohet Organi Rregullativ i Tregut. Organi Rregullativ i Tregut duhet të kontrollojë se a përmban Ekspozetun i Rrjetit klauzola diskriminuese apo ia lejon fuqinë e veprimit menaxherit të infrastrukturës që t'i diskriminon aplikuesit. Organi Rregullativ i Tregut duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme që t'i kryej këto detyra.

NËNKREU V
Pagesat e infrastrukturës

Neni 61
Dispozitat e përgjithshme

1. Pagesat për qasje në binarë për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të paguhet nga ndërmarrjet hekurudhore për menaxherët e infrastrukturës dhe të shfrytëzohen për të financuar biznesin e tyre.
2. Pagesa për qasje në binarë e caktuar nga menaxheri i infrastrukturës duhet të vendoset në përputhje me natyrën e shërbimeve, kohën e shërbimit dhe kualitetin e trasesë së trenit, situatën në treg dhe kostot.
3. Struktura e sistemit të vendosjes së çmimit për shfrytëzuesit e rrjetit dhe niveli i përgjithshëm i pagesave të shfrytëzimit propozohet nga menaxheri i infrastrukturës në pronësi të shtetit dhe e miraton Ministria në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse për ndërmarrjet publike. Menaxheri i infrastrukturës në shfrytëzim të përbashkët në pronësi shtetërore cakton

pagesat dhe kostot në përputhje me situatën e tregut, duke respektuar parimin e mos diskriminimit.

4. Pagesa e qasjes në infrastrukturë duhet të mbuloj minimumin e pakos së qasjes për pajisjet shërbyese nga neni 52 i këtij ligji.

Neni 62

Vendosja, përcaktimi dhe arkëtimi i pagesave të qasjes në infrastrukturë

1. Secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të përcaktojë pagesat për qasje në infrastrukturë sipas situatës në treg dhe kostos por duke respektuar kështu parimet e jodiskriminimit.

2. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14 dhe propozimit për Direktivën mbi Hapësirën Unike Evropiane të Transportit duhet të precizoj rregullat që duhet të shfrytëzohen për të vendosur dhe arkëtuar pagesën për pagesat e qasjes në infrastrukturë, por duke respektuar pavarësinë e menaxhimit të menaxherëve të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët.

3. Organi Rregullativ i Tregut duhet të siguroj që secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët e ka bërë skemën e pagesës për qasje në infrastrukturë e cila duhet të publikohet në Ekspozeun e Rrjetit.

4. Secili Menaxher i Infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të siguroj se aplikimi i skemave të pagesës rezulton nga pagesat ekuivalente dhe jo diskriminuese për ndërmarrjet hekurudhore që ofrojnë shërbime të natyrës ekuivalente në pjesën e ngjashme të tregut. Kjo duhet të kontrollohet nga Organi Rregullativ i Tregut

5. Pagesat e qasjes në infrastrukturë duhet të arkëtohen nga secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët.

6. Organi për vendosjen e pagesave duhet të jetë në gjendje që të arsyetoj tek Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor se pagesat e faturuara për ndërmarrjen hekurudhore për qasje në infrastrukturë përputhen me metodologjinë, rregullat dhe kur është e aplikueshme me normat e paraqitura në Ekspozeun e Rrjetit, si dhe kur Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor kërkon informacion në lidhje me pagesat e aplikuara apo të faturuara, atëherë menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shërbimit të përbashkët duhet të ofroj informacionin e kërkuar.

7. Menaxherët e infrastrukturës duhet të bashkëpunojnë për të arritur operim efikas të shërbimeve të trenit të cilat kalojnë në më shumë se sa një rrjet të infrastrukturës. Ata duhet që veçanërisht të bashkëpunojnë në definimin e pagesave për infrastrukturën në mënyrë që të garantojnë konkurrencën optimale të shërbimit të trenave ndërkombëtar. Ata mund të themelojnë organizata të tilla të përbashkëta për të mundësuar që kjo gjë të kryhet si duhet. Secili bashkëpunim apo organizim i përbashkët duhet të përkufizohet sipas rregullave të paraqitura në këtë ligj apo në ndonjë rregullore tjetër adekuate.

8. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët apo organi i vendosjes së pagesave duhet të respektoj konfidencialitetin komercial të informacionit të cilin atij i ofrojnë aplikantët.

Neni 63

Kostot dhe llogaritë e infrastrukturës

1. Ministria duhet të sigurojë që në kushtet normale të punës dhe në periudhë të arsyeshme, llogaritë e menaxherit të infrastrukturës të jenë të paktën të balancuara me pagesat e qasjes në infrastrukturë, të hyrat shtesë nga aktivitetet e tjera komerciale të mundshme dhe financimi i shtetit nga njëra anë dhe shpenzimet e infrastrukturës në anën tjetër.
2. Menaxherëve të infrastrukturës duhet t’iu ofrohen stimulime për të zvogëluar kostot dhe nivelet e pagesave të infrastrukturës duke pasur parasysh sigurinë, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve të infrastrukturës.
3. Ndërmjet Qeverisë dhe menaxherit në pronësi publike të infrastrukturës ekzistuese të shfrytëzimit të përbashkët INFRAKOS, vendoset marrëveshje kontraktuale. Ajo kontratë duhet të jetë afatgjate, së paku pesë (5) vjeçare dhe duhet të përmbajë strukturën e pagesave të miratuara për financim nga shteti për infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët për tërë periudhën kontraktuale. Qeveria duhet t’i konsultojë të gjitha palët e interesuara së paku një(1) muaj para nënshkrimit të kontratës dhe një (1) muaj pas nënshkrimit duhet ta publikojë nënshkrimin.
4. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të përgatis planin e biznesit dhe të siguroj që plani i biznesit të jetë në përputhje me marrëveshjen kontraktuale të përshkruar më sipër.
5. Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor duhet të vlerësoj përshtatjen e të hyrave të parashikuara afatmesme dhe afatgjata të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët për të arritur caqet e performancës dhe duhet të bëjë rekomandimet relevante të paktën një muaj para se të jetë nënshkruar marrëveshja kontraktuale ndërmjet autoritetit kompetent që e përfaqëson Qeverinë dhe menaxherit të infrastrukturës.
6. Autoriteti kompetent duhet t’i jep arsyetime organit rregullativ të tregut Hekurudhor nëse synon të devijoj nga këto rekomandime.
7. Menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të zhvillojnë dhe azhurnojnë inventarin e mjeteve që ata menaxhojnë i cili duhet të përmbajë vlerësimin e kohës dhe detajet e shpenzimeve për përtëritjen dhe modernizimin e infrastrukturës.
8. Menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duke përfshirë operatorët e pajisjeve shërbyese hekurudhore, duhet të përcaktojnë metodologjinë për kostot proporcionale për shërbimet e ndryshme të ofruara dhe për llojet e mjeteve të transportit duke u bazuar kështu në kuptimin më të mirë të shkaktarëve të kostos që janë në dispozicion në

mënyrë që të përcaktohen parimet për vendosjen e pagesave. Kjo metodologji duhet të azhurnohet kohë pas kohe për të u përputhur me praktikat ndërkombëtare.

Neni 64 **Parimet e vendosjes së pagesës**

1. Pagesat e infrastrukturës dhe metodat e llogaritjes së tyre duhet të publikohen në Ekspozeun e Rrjetit në mënyrë që të iu lejohet ndërmarrjeve hekurudhore që sa më shpejt të përcaktojnë vet pagesat që duhet t'i bëjnë për shfrytëzimin e trasesë së zgjedhur të trenit dhe elementet e tjera të infrastrukturës.
2. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të jetë në gjendje që t'i arsyetoj pagesat e infrastrukturës dhe se ato përputhen me metodologjinë dhe rregullat.
3. Pagesat e infrastrukturës duhet të caktohen sipas kostos e cila është shkaktuar drejtpërdrejtë si rezultat i operimit të shërbimeve të trenit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore.
4. Pagesa e infrastrukturës mund të përfshijë pjesën shtesë e cila reflekton mungesën e kapacitetit të segmentit të identifikueshëm gjatë periudhës së mbingarkesës në infrastrukturë.
5. Pagesa e infrastrukturës mund të modifikohet për të marrë parasysh koston e efekteve mjedisore të shkaktuara nga operimi i trenit. Modifikimi i tillë duhet të jetë i dallueshëm sipas magnitudes së efekteve të shkaktuara. Vënia e pagesës për koston mjedisore e cila ka rezultuar në rritjen e të hyrave të përgjithshme për menaxherin e infrastrukturës duhet të lejohet vetëm nëse pagesa e tillë aplikohet në nivelin e krahasueshëm të llojeve konkurruese të transportit. Në mungesë të ndonjë niveli të krahasueshëm për pagesën e kostove mjedisore në llojet e tjera konkurruese të transportit, ky modifikim nuk duhet të rezultojë me ndonjë ndryshim të përgjithshëm në të hyrat për menaxherin e infrastrukturës. Nëse niveli i krahasueshëm i pagesës për koston mjedisore është futur për hekurudhën dhe llojet konkurruese të transportit dhe që sjellë të hyra shtesë, i takon shtetit që të vendosë se si duhet të shfrytëzohen të hyrat.
6. Për të shmangur luhatjet joproportionale të padëshirueshme, pagesat e referuara në këtë ligj mund të merren si mesatare e shtrirjes së arsyeshme të shërbimeve të trenave dhe të kohëve. Megjithatë, magnitudat relative të pagesave të infrastrukturës duhet t'i përkasin kostove që u atribuohen shërbimeve.
7. Pagesat mund të vendosen si taksa për kapacitetin e shfrytëzuar për mirëmbajtjen e infrastrukturës. Pagesat nuk duhet të tejkalojnë humbjen neto të hyrave të menaxherit të infrastrukturës për shkak të mirëmbajtjes.
8. Përveç në raste specifike siç janë paraqitur në rregullat ligjore, menaxheri i infrastrukturës duhet të siguroj që sistemi i vënies së pagesës për shfrytëzim bazohet në të njëjtat parime përgjatë tërë rrjetit të tij.

9. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet me qenë të aftë që të demonstrojnë te aplikantët se vendosja e pagesave të rrjetit dhe e pagesave për pajisjet shërbyese hekurudhore janë në pajtim me metodologjinë dhe aty ku është e aplikueshme edhe me shkallën e përcaktuar në Ekspozeun e Rrjetit.

10. Organi Rregullativ i Tregut ka të drejtë të merr informatën e nevojshme mbi caktimin e pagesave dhe bazat e llogaritjes së tyre.

Neni 65

Kostoja direkte e mirëmbajtjes së infrastrukturës

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta që dalin nga mirëmbajtja e infrastrukturës duhet të vlerësohen dhe konsiderohen kur të vendosen principet e përcaktimit të pagesës dhe nivelet e pagesës së qasjes.

2. Akti nënligjor, në pajtim me Direktivën e BE-së 2001/14 dhe Propozim Direktivën për Hapësirën Unike Evropiane të Transportit, e shtatorit 2010, duhet të cekë elementet që konsiderohen kosto direkte e shkaktuar për nga shërbimi i trenit dhe mirëmbajtja e infrastrukturës.

Neni 66

Përfjashtimet nga parimet e vënies së pagesës

1. Në mënyrë që të arrihet mbulim më i madh i kostos së tij, menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të vë taksa për ngritje çmimi nëse tregu mund ta bartë atë dhe ajo të bëhet mbi bazat e parimeve të efikasitetit, transparencës dhe jodiskriminimit.

2. Për projektet specifike investive, menaxheri i infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët mund të vendos pagesa më të larta mbi bazat e kostos afatgjatë të projekteve të tilla dhe të ofroj ato projekte duke rritur efikasitetin dhe/ ose koston efektive.

Neni 67

Zbritja e çmimit

1. Zbritja e çmimeve për pagesat e shfrytëzimit duhet që pa diskriminim të lejohet vetëm mbi bazën e kriterëve të kohëzgjatjes së kontratës së qasjes por jo mbi bazën e vëllimit të transportit. Menaxherët e infrastrukturës mund t'i fusin në dispozicion skemat për të gjithë shfrytëzuesit e infrastrukturës për rrjedhjet specifike të trafikut duke dhënë zbritje të kufizuar të çmimit për të inkurajuar zhvillimin e shërbimeve të reja hekurudhore apo zbritje të çmimit për të inkurajuar shfrytëzimin e linjave të konsiderueshme të pashfrytëzuara. Përveç rasteve të përkrahura në fjalinë paraprake, zbritjet e çmimeve duhet të kufizohen tek kursimet e tanishme të kostos administrative për menaxherin e infrastrukturës.

2. Në rastin kur menaxheri i infrastrukturës hyn në negociata me ndërmarrjen hekurudhore për nivelin e pagesave të infrastrukturës, ato negociata autorizohen vetëm nëse bëhen nën mbikëqyrjen e Organit Rregullativ të Tregut.

3. Në mënyrë që të eliminohet çfarëdo sjellje jo korrekte e menaxherëve të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët ndaj operatorëve të caktuar të trenave të cilët shfrytëzojnë ndonjë seksion të infrastrukturës me zbritje të çmimit, menaxheri i infrastrukturës obligohet që së paku tridhjetë (30) ditë më herët ta njofton Organin Rregullativ të Tregut për zbritjen e çmimit.

Neni 68 **Regjimi i performancës**

1. Skemat e përcaktimit të pagesave të shfrytëzimit të rrjetit përmes skemave të performancës, duhet që të inkurajojnë operatorët e trenave dhe menaxherët e infrastrukturës që t'i minimizojnë ndërprerjet dhe ta ngritin performancën e rrjetit hekurudhor. Kjo mund të përfshijë dënimet për veprimet që kanë shkaktuar ndërprerjen e operimit në rrjet, kompensimin për ndërmarrjet që kanë pësuar nga ndërprerja dhe bonuset për shpërblim më të mirë se sa performanca e planifikuar.

2. Përmes treguesve specifik të përmirësimit të kualitetit të transportit të përcaktuar në sistemin për arkëtimin e pagesës për qasjen në infrastrukturën hekurudhore, transportuesit dhe menaxheri i infrastrukturës duhet të jenë në dijeni për të zvogëluar vonesat dhe për të përmirësuar kualitetin e transportit. Kjo mund të përfshijë dënimet për veprimet që kanë shkaktuar ndërprerjen e operimit në rrjet, kompensimin për ndërmarrjet që kanë pësuar nga ndërprerja dhe bonuset për shpërblim më të mirë se sa aktiviteti i planifikuar

3. Sistemi i theksuar në këtë nen duhet të përmbaj masat për parandalimin e ndërprerjeve të menaxhimit të trafikut, kompensimin e transportuesve nëse ata pësojnë humbje për shkak të ndërprerjes së menaxhimit të trafikut dhe permitë që duhet të iu jepen atyre entiteteve që kanë përmirësuar treguesit e tyre apo që kanë tejkaluar treguesit e synuar.

4. Parimet e përgjithshme të sistemit të theksuar në këtë nen duhet të referohen dhe të aplikohen në tërë rrjetin në mënyrë jo diskriminuese dhe transparente.

5. Skema e performancës duhet të publikohen në Ekspozeun e Rrjetit.

Neni 69 **Pagesat e rezervimit**

1. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të vendosin pagesë për rezervimet e duhura për shfrytëzimin e disa kapaciteteve të cilat janë dhënë por që nuk janë shfrytëzuar. Kjo pagesë duhet të ofroj stimulim për shfrytëzimin më me efikasitet të kapaciteteve.

2. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet t'i informojnë të gjitha entitetet e interesuara që kanë nevojë për shfrytëzim të këtyre kapacitete të infrastrukturës e të cilat tashmë janë dhënë për shfrytëzuesit apo transportuesit por që nuk janë shfrytëzuar.

3. Pagesa e rezervimit mund të aplikohet gjithashtu nëse ekziston më shumë se sa një aplikant për trasenë e trenit e cila duhet të alokohet sipas orarit vjetor të lëvizjes së trenave.

Neni 70

Monitorimi i vënies së pagesës të infrastrukturës

1. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet t'i regjistroj të hyrat e krijuara nga qasja në binarë në llogarinë e veçantë e cila duhet të bëhet publike.

2. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të mbaj dhe publikoj gjendjen e të hyrave dhe kontabilitetit të aktivitetit të tij për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore si dhe ta publikoj atë në ueb faqen e vet.

3. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të siguroj që procesi i vendim marrjes së tij dhe zbatimi i tij të jetë transparent, i drejt dhe jo diskriminues.

Neni 71

Bashkëpunimi lidhur me sistemet e vendosjes së pagesave në më shumë rrjete

Për trafikun që kalon në më shumë rrjete, menaxherët e infrastrukturës duhet të bashkëpunojnë me menaxheret e tjerë të infrastrukturës në përcaktimin e çmimeve dhe skemave të performancës për të u aplikuar në mënyrë efektive. Ministria duhet të siguroj bashkëpunim ndërmjet menaxherëve të infrastrukturës të shteteve të ndryshme. Ky bashkëpunim duhet të zhvillohet veçmas në drejtim të Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-s.

NËNKREU VI

Alokimi i kapacitetit të infrastrukturës

Neni 72

Të drejtat mbi kapacitetin

1. Secila ndërmarrje hekurudhore e cila është në posedim të licencës dhe të certifikatës së sigurisë që ia lejon shfrytëzimin e tërë apo të një pjese të infrastrukturës hekurudhore të Kosovës të shfrytëzimit të përbashkët dhe që plotëson kërkesat e paraqitura nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, mund të aplikoj për alokimin e trasesë së trenit dhe duhet të ketë qasje në pajisjet ekzistuese të trajnimit. Personat e tjerë dhe entitetet ligjore sikurse janë autoritetet kompetente publike të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve të transportit

hekurudhor publik, transportuesit, shpediterët e mallrave dhe operatorët e transportit të kombinuar me shërbimin publik apo që kanë interes komercial për blerjen e kapaciteteve të infrastrukturës, mund të aplikojnë për trasetë e trenit dhe pajisjet shërbyese përkatëse hekurudhore.

2. Aplikacionet duhet të paraqiten tek menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët që është i ngarkuar me alokimin e kapacitetit të infrastrukturës hekurudhore.

3. Alokimi i kapacitetit të infrastrukturës e në veçanti trasetë e trenit dhe qasja në pajisjet shërbyese duhet të jetë i drejt dhe pa diskriminim.

4. Aplikacionet duhet të paraqiten tek menaxheri i infrastrukturës. Alokimi i trasesë së trenit duhet të jepet nga menaxheri i infrastrukturës sipas kornizës së kontratës e cila duhet të arrihet ndërmjet menaxherit të infrastrukturës dhe aplikuesit. Kontrata e përmendur duhet të përmbaj kërkesat detaje në lidhje me qasjen në infrastrukturën hekurudhore dhe në veçanti kohën dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit, shumën dhe detajet e pagesës së shfrytëzuesit si dhe kushtet e tjera financiare, administrative dhe teknike duke përfshirë ato për rregullimin dhe sigurinë e trafikut.

5. Kontratat duhet të jenë fer, jo diskriminuese dhe transparente. Ato duhet me qenë në përputhje me kërkesat e këtij ligji e në veçanti me dispozitat lidhur me alokimin e pajisjeve të infrastrukturës dhe përcaktimin e pagesave për shfrytëzimin e atyre pajisjeve si dhe certifikatën e lëshuar të sigurisë.

6. E drejta e shfrytëzimit të kapacitetit specifik të infrastrukturës mund t'i jepet aplikuesve për një kohëzgjatje maksimale të një periode të orarit të trenave.

7. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe aplikuesi mund të hyjnë në marrëveshje kornizë shumë vjeçare ashtu siç është përshkruar me këtë ligj.

8. Aplikuesi nuk mund të transferoj kapacitetin e fituar të infrastrukturës tek një transportues tjetër apo ofruet i shërbimit. Tregtia me kapacitetet e infrastrukturës ndërmjet aplikuesve nuk është e lejuar.

9. Çfarëdo tregtie me kapacitetet e infrastrukturës nuk do të lejohet dhe do të rezultojë me përjashtimin e aplikuesit nga ndonjë dhënie tjetër e kapaciteteve.

10. Shfrytëzimi i kapaciteteve të infrastrukturës nga ndërmarrja hekurudhore e cila punon në emër të aplikuesit, nëse aplikuesi nuk është ndërmarrje hekurudhore, nuk duhet të konsiderohet si transferim apo tregtim me kapacitetet.

11. Menaxheri i Infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet që:

11.1. të siguroj se kapaciteti i infrastrukturës është alokuar mbi baza të drejta dhe jodiskriminuese;

11.2. të siguroj se kontratat janë jodiskriminuese, transparente dhe në përputhje me kërkesat e këtij ligji; dhe

11.3. të respektohet mirëbesimi i informacionit i cili i është ofruar atij si pjesë e procesit të alokimit të kapacitetit

Neni 73 **Alokimi i kapacitetit**

1. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të kryej procesin e alokimit të kapacitetit të vendosur dhe publikuar në ekspozeun e vet të rrjetit.
2. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të siguroj që kapaciteti i infrastrukturës është alokuar në baza të drejta dhe jo diskriminuese.
3. Në procedurën e dhënies së kapaciteteve të infrastrukturës, menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët plotëson kërkesat për shtrirje të mëtejme të mundshme të kapaciteteve duke përfshirë kërkesat për linjat e trenit që kalojnë në më shumë se një rrjet.
4. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të iu jep prioritet llojeve të veçanta të shërbimeve gjatë dhënies së kapaciteteve të infrastrukturës dhe gjatë procesit të koordinimit. Parimet e definimit të prioriteteve duhet të publikohen në Ekspozeun e Rrjetit pas diskutimit me të gjitha palët e interesuara.
5. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të bashkërendoj përpilimin e orarit të trenave me aplikuesit duke filluar nga dita kur janë paraqitur aplikimet dhe deri në ditën kur të jetë përgatitur orari i trenave.
6. Aplikuesit duhet të jenë të obliguar që të shprehin opinionin e tyre për përpilimin e orarit të trenave jo më vonë se një muaj nga koha kur e kanë marrë atë.
7. Nëse aplikuesit dështojnë të shprehin mendimin e tyre brenda afatit të paraqitur në këtë nen, atëherë menaxheri i infrastrukturës duhet të konsideroj që përpilimi i orarit të trenit është pranuar dhe duhet të konsiderohen se aplikuesit e kanë marrë kapacitetin e infrastrukturës së kërkuar.
8. Menaxheri i infrastrukturës duhet të ndërmerret të gjitha masat e domosdoshme për shqyrtimin dhe analizimin e vërejtjeve dhe propozimeve të dhëna nga ndërmarrjet hekurudhore, lidhur me orarin e trenit.
9. Nëse ndonjë aplikuesi i është refuzuar kapaciteti i infrastrukturës apo i është dhënë infrastrukturë jo e kënaqshme, sa i përket, ofertës, aplikuesi mund të ankohet te ARH.

Neni 74 **Aplikuesit**

1. Aplikimi për trasetë e trenit duhet të bëhet nga ndërmarrjet hekurudhore apo nga grupimet e tyre. Ato duhet të kenë licencë dhe certifikatë të sigurisë për të operuar me shërbimet në infrastrukturën në të cilën kanë aplikuar për trasetë e trenit. Personat e tjerë apo entitetet ligjore siç janë autoritetet publike kompetente të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve të transportit publik hekurudhor, shpediterët, transportuesit e mallrave dhe operatorët e transportit të kombinuar me shërbimin publik apo që kanë interes komercial për blerjen e kapacitetit të infrastrukturës, mund të aplikojnë për trasetë e trenit dhe pajisjet shërbyese përkatëse hekurudhore.
2. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të vendosë kërkesa specifike për t'u siguruar se janë mbrojtur pritjet e tij legjitime në lidhje me të hyrat dhe shfrytëzimin e infrastrukturës. Këto kërkesa duhet të jenë të duhura, transparente dhe jo diskriminuese; ato duhet të publikohen në Ekspozeun e Rrjetit.
3. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mundet gjithashtu të aplikojë dispozitën për garantimin financiar i cili nuk duhet të tejkaloj nivelin që duhet të jetë proporcional me nivelet e parashikuara të aktivitetit të aplikuesit dhe sigurimin e aftësive për të përgatitur formën e ankesës për kapacitetin e infrastrukturës.

Neni 75 **Aplikimi për kapacitetin e infrastrukturës**

1. Aplikuesit duhet të paraqesin aplikacionet e tyre te menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët në mënyrë që të nënshkruajnë kontratën për qasje në infrastrukturën hekurudhore sipas pagesave për qasje në rrjet.
2. Aplikacionet që kanë të bëjnë me referimin për dhënien e kapaciteteve të infrastrukturës duhet të përgatiten në përputhje me afatet e paraqitura në këtë ligj.
3. Aplikuesi i cili është palë kontraktuese në marrëveshjen kornizë të theksuar në këtë ligj, duhet të paraqes aplikimin në përputhje me atë marrëveshje.
4. Aplikuesi i cili paraqet aplikimin për kapacitetet e infrastrukturës të cilat i referohen më shumë se sa një rrjeti, mund të paraqes aplikimin e vet vetëm te një menaxher i infrastrukturës. Në këtë rast menaxheri i infrastrukturës mund të aplikojë për kapacitetin e infrastrukturës në emër të aplikuesit tek menaxherët e tjerë të infrastrukturës.

Neni 76 **Marrëveshja kornizë**

1. Marrëveshja kornizë mund të arrihet ndërmjet ndërmarrjes hekurudhore dhe menaxherit të

infrastrukturës në mënyrë fer, jodiskriminuese dhe transparente. Kjo marrëveshje kornizë duhet të specifikoj karakteristikat e kapacitetit të infrastrukturës të kërkuar dhe ofruar për një kohë e cila nuk e tejkalon një periudë të orarit të trenave. Marrëveshja kornizë nuk duhet të specifikoj në detaje trasenë e trenit por duhet të jetë e tillë që duhet të plotësoj nevojat legjitime komerciale të aplikuesit, përderisa nuk imponohet pengesë e pa arsyeshme për dëshirat e aplikuesve të tjerë për zhvillimin e biznesit të tyre.

2. Marrëveshja preliminare e kësaj marrëveshjeje kornizë duhet të jepet nga Organi Rregullativ i Tregut Hekurudhor i cili është i ngarkuar për rregullimin e tregut hekurudhor.

3. Kohëzgjatja e marrëveshjes kornizë në parim duhet të jetë prej pesë (5) vite.

4. Nëse është e domosdoshme të ndryshohet apo anulohet kontrata, atëherë marrëveshja kornizë duhet të përmbaj gjokat e caktuara.

5. Duke respektuar konfidencialitetin komercial, natyra e përgjithshme e secilës marrëveshje kornizë duhet t'i vihet në dispozicion palëve të interesuara.

Neni 77

Orari për procesin e alokimit

1. Secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të alokoj kapacitetet mbi bazat e orarit në vazhdim:

1.1. tabela e orarit të trenave duhet të vendoset njëherë brenda një viti kalendarik;

1.2. ndryshimi i orarit të trenave duhet të bëhet në mesnatë të së shtunës së fundit në muajin maj. Kur ndryshimi apo përshtatja bëhet pas verës, atëherë kjo do të vihet në funksion të shtunën e fundit të shtatorit të secilit vit dhe në intervale të tjera të tilla ndërmjet këtyre datave ashtu si kërkohet;

1.3. data e fundit e pranimit të kërkesave për kapacitet të cilat duhet të përfshihen në orarin e trenave nuk duhet të jetë më e hershme se dymbëdhjetë (12) muaj nga hyrja në fuqi e orarit të trenave;

1.4. jo më vonë se njëmbëdhjetë (11) muaj para se orari i trenave të hyj në fuqi, menaxheri i infrastrukturës duhet të siguroj që trasetë e përkohshme të trenave ndërkombëtar janë vendosur në bashkëpunim me organet e tjera relevante;

1.5. jo më vonë se katër (4) muaj pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave të aplikuesve, menaxheri i infrastrukturës duhet të përgatisë draftin e orarit të trenave.

2. Menaxherët e infrastrukturës duhet të pajtohen me menaxherët e tjerë relevant të infrastrukturës në lidhje me atë se cilat orare ndërkombëtare të trenave do të përfshihen në orarin e trenave para fillimit të konsultimeve për draftin e orarit të trenave.

3. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet që sipas kërkesës dhe brenda një kohe të arsyeshme për procesin e koordinimit, të përgatisë për aplikuesit në formën e shkruar dhe ta vë në dispozicion pa pagesë për shqyrtim informacionin vijues:

3.1. trasetë e trenave të kërkuar nga të gjithë aplikuesit për të njëjtat linja;

3.2. trasetë e trenave të alokuara për të gjithë aplikuesit dhe kërkesat për trasetë e jashtëzakonshme të trenave për gjithë aplikuesit tjerë për të njëjtat linja;

3.3. trasetë e trenave të alokuara të të gjithë aplikuesit e tjerë në të njëjtat linja sikurse në orarin e mëparshëm të trenave;

3.4. kapaciteti i mbetur në dispozicion për linjat relevante;

3.5. detajet e plota të kriterëve që janë shfrytëzuar në procesin e alokimit të kapacitetit.

Neni 78 **Orari**

1. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet që sa më shpejt që është e mundur të plotësojnë të gjitha kërkesat për kapacitetin e infrastrukturës duke përfshirë kërkesat për trasetë e trenave që kalojnë në më shumë se sa një rrjet dhe duhet që sa më shpejt të marrin parasysh të gjitha pengesat për aplikuesit duke përfshirë efektin ekonomik të biznesit të tyre.

2. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të iu japin prioritet shërbimeve specifike në kuadër të planifikimit dhe procesit të koordinimit duke ofruar atë se prioritetet dhe specifikit janë përshkruar në Ekspozeun e Rrjetit.

3. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet t'i konsultojnë palët e interesuara në lidhje me draftin e orarit të trenave dhe të iu japin atyre një muaj për mendimet e tyre. Në palët e interesuara duhet të përfshihen të gjithë ata që kanë kërkuar kapacitet e infrastrukturës e gjithashtu edhe palët e tjera që dëshirojnë të kenë mundësinë të komentojnë se si do të ndikonte orari i trenave në mundësinë e prokurimit të shërbimeve hekurudhore gjatë periudhës së orarit të trenave.

4. Menaxheret e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të ndërmarrin masat e duhura lidhur me secilën bregë.

Neni 79

Bashkëpunimi në alokimin e kapacitetit të infrastrukturës në më shumë se një rrjet

1. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë duhet të bashkëpunojnë me menaxherët e tjerë të infrastrukturës për të mundësuar krijim efektiv dhe

alokim të kapacitetit të infrastrukturës që kalon në më shumë se sa një rrjet. Ata duhet të organizojnë trasetë ndërkombëtare të trenave veçmas brenda kornizës së hapësirës të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) përgjatë Rrjetit të Transportit Trans Evropian (TENT).

2. Procedurat për krijimin e këtyre traseve ndërkombëtare të trenave duhet t'i shoqëroj përfaqësuesit e menaxherëve të infrastrukturës për të gjitha infrastrukturat hekurudhore, vendimet e alokimit të cilave kanë ndikim në më shumë se një menaxher i infrastrukturës.

3. Duke punuar në bashkëpunim për alokimin e kapaciteteve në më shumë se një rrjet, menaxherët e infrastrukturës mund të jenë në gjendje të para aranzhojnë trasetë e trenave ndërkombëtar që mund të u vihen në dispozicion aplikuesve përmes ndonjërit nga menaxherët pjesëmarrës të infrastrukturës .

Neni 80 **Procesi i koordinimit**

1. Gjatë procesit të caktimit të orarit të përshkruar në këtë ligj, kur menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët hasë në konflikt ndërmjet kërkesave të ndryshme, ai duhet të tentoj që nëpërmes të koordinimit të kërkesave të siguroj ballafaqimin më të mirë të kërkesave.

2. Kur të krijohet situata të tilla ku kërkohet koordinimi, atëherë menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të ketë të drejtë që brenda kufijve të arsyeshëm të propozoj kapacitetin e infrastrukturës e cila dallon nga ajo që është kërkuar.

3. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të tentoj që përmes konsultimeve me aplikuesit e duhur të arrij zgjidhje të konflikteve.

4. Parimet që e udhëheqin procesin e koordinimit duhet të definohen në Ekspozeun e Rrjetit. Ato duhet që në veçanti të reflektojnë vështirësinë e aranzhimit të traseve ndërkombëtare të trenave dhe efektet që mund të kenë modifikimet në menaxherët e tjerë të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët.

5. Kur kërkesat për kapacitet të infrastrukturës nuk mund të plotësohen, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të përpiqen për zgjidhjen e tyre përmes të koordinimit.

6. Pa paragjykuar procedurat ekzistuese të ankesave, në rast të mosmarrëveshjeve të alokimit të kapaciteteve, duhet të vihet në dispozicion sistemi i zgjidhjes në Ekspozeun e Rrjetit në mënyrë që mosmarrëveshjet të zgjidhen shpejt. Vendimi duhet të arrihet brenda një kufizimi kohor prej dhjetë (10) ditësh pune.

Neni 81

Infrastruktura e mbingarkuar

1. Kur pas koordinimit për trasetë e kërkuara dhe konsultimit me aplikuesit nuk është e mundur të plotësohen në mënyrë adekuate kërkesat për kapacitet e infrastrukturës, atëherë menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të deklaroj te të gjithë aplikuesit për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore dhe te Organi Rregullativ i Tregut se elementi i infrastrukturës në të cilin kjo ka ndodhë është i mbingarkuar. Kjo gjithashtu duhet të bëhet për infrastrukturën për të cilën mund të parashikohet se do të pësoj nga mungesa e kapacitetit në të ardhmen e afërt.
2. Kur infrastruktura është deklaruar se është e mbingarkuar, atëherë menaxheri i infrastrukturës duhet të bëj analizë të kapacitetit ashtu sikurse është përshkruar në këtë ligj përveç nëse është bërë zbatimi i rritjes së kapacitetit.
3. Kur nuk janë arkëtuar pagesat apo ato nuk kanë arritur rezultat të kënaqshëm, ndërsa infrastruktura është deklaruar si e mbingarkuar, atëherë menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mundet që si kritere shtesë të shfrytëzoj prioritetin për alokim të kapacitetit të infrastrukturës.
4. Kriteret prioritare duhet të marrin parasysh rëndësinë e shërbimit për shoqërinë me shumë se sa shërbimet e tjera të cilat duhet të përjashtohen.
5. Në mënyrë që në kuadër të kësaj kornize të garantohet zhvillimi i shërbimeve adekuate të transportit në veçanti përputhja me kërkesat e shërbimit publik apo promovimi i zhvillimit të mallrave hekurudhore, atëherë ministria mund të merr ndonjë masë të domosdoshme nën kushte jo diskriminuese për të siguruar se shërbimeve të tilla iu është dhënë prioritet kur bëhet alokimi i kapacitetit të infrastrukturës.
6. Rëndësia e shërbimit të mallrave dhe në veçanti të shërbimeve ndërkombëtare të mallrave duhet të ketë konsideratë adekuate në përcaktimin e kritereve prioritare.
7. Procedurat të cilat duhet të ndiqen dhe kriteret kur infrastruktura është e mbingarkuar duhet të përshkruhen në Ekspozeun e Rrjetit.

Neni 82

Kërkesat e rastit

1. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të iu përgjigjen kërkesave të rastit për trasetë individuale të trenave dhe kjo të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe në çfarëdo rasti brenda pesë ditëve të punës. Informacioni i ofruar në lidhje me kapacitetin në dispozicion duhet të vihet në dispozicion për aplikuesit që dëshirojnë të shfrytëzojnë atë kapacitet.

2. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet që domosdo të vlerësojnë nevojën për kapacitetet rezervë për t'i mbajtur në dispozicion në kuadër të orarit final të trenave të planifikuar për të mundësuar përgjigjen e shpejt për kërkesat e parashikuara të rastit. Kjo duhet gjithashtu të aplikohet në rastet e infrastrukturës së mbingarkuar.

Neni 83

Infrastruktura speciale

1. Infrastruktura e shfrytëzimit të përbashkët duhet të jetë në dispozicion në parimin e shfrytëzimit të të gjitha llojeve të shërbimeve që janë në përputhje me karakteristikat e domosdoshme për operim të traseve të trenave.
2. Kur ekzistojnë korridore të përshtatshme alternative, menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mundet që pas konsultimeve me palët e interesuara të caktoj infrastrukturën e veçantë për shfrytëzim të llojeve specifike të trafikut dhe t'i jepet prioritet këtij lloji kur bëhet alokimi i kapacitetit të infrastrukturës.
3. Një caktim i tillë nuk duhet të parandaloj shfrytëzimin e infrastrukturës të llojeve të tjera të trafikut kur kapaciteti është në dispozicion dhe kur mjetet lëvizëse hekurudhore janë në pajtim me karakteristikat e domosdoshme për operim në atë linjë.
4. Kur infrastruktura të jetë caktuar si e specializuar për shfrytëzim nga llojet specifike të trafikut, kjo duhet të përshkruhet në Ekspozeun e Rrjetit.

Neni 84

Analizat e kapacitetit

1. Objektivi i analizës së kapacitetit është që të përcaktoj kufizimet në kapacitetin e infrastrukturës që parandalon kërkesat për kapacitet nga të plotësuarit adekuat dhe për të propozuar metodat e mundësimit të kërkesave shtesë që ato të plotësohen. Kjo analizë duhet të identifikoj arsyet për mbingarkimin dhe cilat masa duhet të merren në afatin e shkurt dhe të mesëm kohor për të lehtësuar mbingarkimin.
2. Analiza e kapacitetit duhet të kryhet brenda gjashtë (6) muajsh pas identifikimit se infrastruktura është e mbingarkuar.
3. Metodologjia për analizimin e kapacitetin duhet të përgatitet nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe të jetë në pajtim me autoritetet publike përgjegjëse për transport.

Neni 85
Plani i rritjes së kapacitetit

1. Brenda gjashtë muajsh nga kryerja e analizës së kapacitetit, menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të krijoj planin për rritjen e kapacitetit.
2. Përmbajtja e planit për rritjen e kapacitetit do të përgatitet dhe veprimet e propozuara do të diskutohen me shfrytëzuesit e infrastrukturës së mbingarkuar me pjesëmarrjen e Organit Rregullativ Hekurudhor.

Neni 86
Shfrytëzimi i traseve të trenave

1. Menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët në veçanti duhet të kërkoj dorëzimin e trasesë së trenit për infrastrukturën e mbingarkuar e cila për një periudhë prej së paku një muaj ka qenë e shfrytëzuar më pak se kuota e pragut e paraqitur në Ekspozeun e Rrjetit. Kjo përjashtohet nëse është si pasojë e arsyeve jo ekonomike të cilat janë jashtë kontrollit të ndërmarrjes hekurudhore.
2. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të specifikojnë në Ekspozeun e Rrjetit kushtet të cilat duhet të marrin parasysh nivelet e mëparshme të shfrytëzuara në trasetë e trenave për të përcaktuar prioritetet në procesin e alokimit.

Neni 87
Kapaciteti i infrastrukturës për mirëmbajtjen e planifikuar

1. Kërkesat për kapacitetin e infrastrukturës për të mundësuar kryerjen e mirëmbajtjes duhet të paraqiten gjatë procesit të përpilimit të orarit të trenave.
2. Menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të kenë llogari adekuate për aplikuesit për efektin e kapacitetit të infrastrukturës rezervë për mirëmbajtjen e planifikuar të binareve.
3. Në mënyrë që të sigurohet transparencë në procesin e planifikimit të kërkesave për aplikuesit, menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të detajizoj në Ekspozeun e Rrjetit procesin e planifikimit të kërkesave për kapacitet e infrastrukturës për të mundësuar që të kryhet mirëmbajtja.
4. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët i ngarkuar për alokimin e traseve duhet të lëshoj njoftim paraprak për secilin pjesëtar të traseve të trenit lidhur me mundësinë e mbylljes së linjës apo kufizimet tjera ose për kryerjen e punëve brenda afatit kohor të njoftuar. Në rast të vonesave të punëve apo mbylljes së pa planifikuar të linjës duhet

të jepet njoftimi menjëherë dhe të ofrohen trase ekuivalente të trenave me pagesë të njëjtë apo më të vogël se ajo që është kërkuar apo pajtuar për atë trase.

Neni 88

Masat speciale të cilat duhet të ndërmerren në rast të çrregullimeve

1. Në rast të çrregullimit në lëvizjet e trenave të shkaktuar nga dështimi teknik apo aksidenti, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e domosdoshëm për të kthyer situatën në gjendje normale. Në këtë drejtim ata duhet të përpilojnë planet rezervë ku do të vendosen entitetet e ndryshme publike të cilat duhet të informohen për aksidentet serioze apo çrregullimet serioze në qarkullimin e trenave.
2. Në rastet emergjente dhe kur domosdoshmëria absolute ka të bëjë me çrregullimin që e bën infrastrukturën përkohësisht të pashfrytëzueshme, atëherë alokimi i traseve mund të tërhiqet me paralajmërimin se është i domosdoshëm riparimi i sistemit.
3. Nëse e konsiderojnë të domosdoshme, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët mund të kërkojnë nga ndërmarrjet hekurudhore që t'i vënë në dispozicion burimet që ata mendojnë se janë shumë të nevojshme për të kthyer në gjendje normale situatën sa më shpejt që të jetë e mundshme.
4. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët mund të kërkojë nga ndërmarrjet hekurudhore që të përfshihen në sigurimin e zbatimit dhe monitorimit të përmbushjes së tyre të rregullave dhe standardeve të sigurisë.

KREU VI

SHFRYTËZUESIT E INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

NËNKREU I

Ndërmarrjet hekurudhore

Neni 89

Operimet me trena dhe shërbimet e transportit hekurudhor

Operimet me trena dhe shërbimet e transportit hekurudhor bëhen nga ndërmarrjet hekurudhore të cilat e përdorin infrastrukturën hekurudhore dhe asetet tjera të nevojshme për prodhimin e këtyre shërbimeve.

Neni 90

Operimet hekurudhore në Kosovë

1. Operimet ekzistuese hekurudhore në Kosovë duhet të organizohen dhe menaxhohen nga Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës ShA (TRAINKOS) e cila është kompani në pronësi publike sipas Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë.
2. Misioni i TRAINKOS duhet të zhvillojë biznesin e transportit në Kosovë dhe vendet tjera përmes hekurudhave dhe mënyrave tjera (multimodale) për ofrim të shërbimeve më të mira për shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës.
3. Asetet të cilat janë asete të TRAINKOS dhe të cilat i takojnë shtetit, duhet të menaxhohen nga TRAINKOS-i.
4. TRAINKOS duhet të ketë licencën dhe certifikatën e sigurisë ashtu siç është e përshkruar me këtë ligj.
5. TRAINKOS duhet të veprojë në baza komerciale nën kushtet e tregut përveç nëse përshkruhet ndryshe me këtë ligj. TRAINKOS duhet të ketë mundësinë e caktimit të tarifave të veta, negocimit të kontratave me klientët dhe partnerët duke u bazuar në ligjin mbi ndërmarrjet publike të Kosovës.
6. TRAINKOS mundet me qenë ofrues i shërbimeve për shërbimet hekurudhore të udhëtarëve të cilat konsiderohen si obligime të shërbimeve publike për të cilat nëse është e domosdoshme mund të merren kompensime financiare nga shteti dhe duke vepruar pastaj si autoritet publik i cili i porositë këto shërbime ose ndonjë autoritet publik kompetent tjetër. Në këtë rast, TRAINKOS do të ketë kontratë me shtetin duke vepruar kështu si autoritet publik i cili i porositë shërbimet ose ndonjë autoritet publik kompetent tjetër. dhe duke i përcaktuar karakteristikat dhe kualitetin e shërbimeve të cilat duhet të ofrohen, si dhe duke përcaktuar pjesën dhe sasinë e kompensimit financiar të cilën duhet ta merr TRAINKOS si ofrues i këtyre shërbimeve.
7. Bordi i TRAINKOS-it duhet të emërohet duke u bazuar në ligjin mbi ndërmarrjet publike në Kosovë.
8. Misioni dhe statuti i TRAINKOS duhet të përshkruhet përmes të një akti nënligjor. Ky akt duhet ta përcakton po ashtu numrin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve sipas ligjit mbi ndërmarrjet publike në Kosovë, modalitetet e emërimit dhe zgjedhjes së tyre, si dhe modalitetin e zgjedhjes së kryesuesit të bordit.
9. TRAINKOS si ndërmarrje publike sa i përket kontrollimit ekonomik, financiar dhe teknik duhet t'i aplikoj rregullat të cilat janë përshkruar në ligjin mbi ndërmarrjet publike.
10. Të gjitha transferimet e aseteve të përshkruara më lartë duhet të jenë të liruara nga taksat dhe pagesat shtetërore.

11. Asetet në pronësi publike të TRAINKOS duhet të mbrohen nga uzurpimet ashtu siç është përshkruar në kreun X të këtij ligji. TRAINKOS duhet të jetë përgjegjëse me policinë dhe drejtësinë që të vepronë kundër uzurpimeve të tilla. Modaliteti i veprimeve të tilla duhet të përshkruhet me një akt nënligjor.

12. Të hyrat për TRAINKOS duhet të jenë të hyra të paguara nga klientët e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave, transportuesit apo shpediterët e mallrave, por edhe të hyrat nga asetet dhe aktivitetet tjera të TRAINKOS, të hyrat e paguara nga shteti apo ndonjë autoritet publik kompetent si kompensim financiar për ofrimin e shërbimeve të transportit të interesit të përgjithshëm (kompensimi financiar për obligimet e shërbimeve publike) dhe ndonjë e hyrë tjetër dhe kontribut publik apo privat.

13. Praktikrat komerciale të TRAINKOS duhet me qenë në pajtim me ligjet e Kosovës.

Neni 91

Kushtet e përgjithshme për operim me shërbimet hekurudhore

Është e ndaluar të operohet me shërbime hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në Kosovë pa licencë të domosdoshme, certifikata dhe autorizime.

Neni 92

Lëshimi i licencës

1. Ndërmarrja hekurudhore, që nënkupton ndërmarrjen private apo publike biznesi kryesor i së cilës është të ofroj shërbime të transportit hekurudhor për udhëtarët dhe mallrat me kërkesën që ndërmarrja aplikuese të siguroj tërheqjen e trenave, nuk mund t'i ofrojë këto shërbime pa qenë e licencuar.

2. Licenca duhet të specifikoj llojet e shërbimeve hekurudhore për të cilat pronarit i është dhënë licenca.

3. Licenca e lëshuar nga organi licencues i vlefshëm në BE dhe e cila është në përputhje me legjislacionin, duhet të jetë e vlefshme edhe në Kosovë.

4. Organi licencues bënë lëshimin, ndryshimin, suspendimin dhe revokimin e licencave sipas nevojës.

5. Organi licencues në Kosovë nuk duhet të bënë lëshimin e licencave dhe vazhdimin e tyre nëse nuk plotësohen kërkesat sipas këtij ligji dhe rregulloreve përkatëse.

6. Ndërmarrja aplikuese duhet të ketë të drejt të aplikoj për licencë në Kosovë kur ajo të jetë e vendosur në Kosovë.

7. Ndërmarrja aplikuese që aplikon për licencë duhet t'i ofroj autoritetit licencues dokumentet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze ku konfirmohet se i plotëson kërkesat e specifikuar në këtë ligj.

8. Ndërmarrja aplikuese e cila plotëson kërkesat sipas këtij ligji, duhet të autorizohet për marrjen e licencës.

9. Asnjë ndërmarrjeje aplikuese nuk duhet t'i lejohet të ofroj shërbime të transportit të përfshira me këtë ligj, përderisa nuk ka marrë licencën e duhur për shërbimet që duhet të ofrohen. Megjithatë licenca si e tillë nuk duhet t'i jep të drejtë pronarit të saj të ketë qasje në infrastrukturën hekurudhore.

10. Ndërmarrja aplikuese para se të filloj me aktivitetet e veta duhet të jetë në gjendje të demonstroj tek autoriteti licencues i Kosovës se ai në çdo kohë është në gjendje të plotësoj kërkesat që kanë të bëjnë me mallrat, përshtatshmërinë financiare, kompetencën profesionale dhe të ketë mbulesë për përgjegjësinë e tij civile sipas këtij neni.

11. Secila ndërmarrje aplikuese që aplikon për licencë duhet të ofroj të gjithë informacionin relevant.

12. Kushtet sipas të cilave është plotësuar kërkesa për reputacion të mirë për të siguruar se ndërmarrja aplikuese apo personat përgjegjës për menaxhimin e saj janë arritur, janë si në vijim:

12.1. nuk janë dënuar për veprë penale duke përfshirë kundërvajtjet e natyrës komerciale;

12.2. nuk janë të deklaruar të bankrotuar;

12.3. nuk janë dënuar për kundërvajtje ndaj legjislacionit specifik të aplikueshëm në transport;

12.4. nuk janë dënuar për dështim serioz apo të përsëritur për plotësimin e obligimeve të ligjit social apo atij të punës duke përfshirë obligimet për sigurinë profesionale dhe legjislacionin e shëndetit.

13. Kërkesat që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë financiare duhet të plotësohen kur ndërmarrja aplikuese mund të demonstroj se do të jetë në gjendje të plotësoj obligimet e tanishme dhe potenciale të vendosura mbi supozimin real për një kohë prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

14. Secila ndërmarrje aplikuese duhet të paraqes të paktën llogarinë e vet vjetore apo në rast kur ndërmarrja aplikuese nuk është në gjendje të paraqes llogarinë vjetore atëherë të paraqes bilancin e saj. Të veçantat e detajuara duhet të ofrohen në veçanti në aspektet vijuese:

14.1. fondet në dispozicion duke përfshirë bilancin bankar, tërheqjet e mëdha të parave dhe kreditë;

14.2. fondet dhe asetet në dispozicion për siguri;

14.3. kapitali i punës;

14.4. kostot relevante, duke përfshirë koston për blerjen e mjeteve të transportit, tokës, ndërtesave, instalimeve dhe mjeteve lëvizëse;

14.5. pagesat për asetet e ndërmarrjes.

15. Ndërmarrja aplikuese nuk është financiarisht e përshtatshme nëse borxhet e konsiderueshme në tatime apo sigurim social janë si rezultat i aktivitetit të ndërmarrjes.

16. Organi licensues mund të kërkoj paraqitjen e raportit të auditimit dhe dokumentet e përshtatshme nga banka, kontabilisti apo auditori. Këto dokumente duhet të përfshijnë informacionin në lidhje me gjendjen financiare të aplikuesit.

17. Kërkesat lidhur me kompetencën profesionale duhet të plotësohen kur:

17.1. ndërmarrja aplikuese ka apo do të ketë organizim menaxhues që posedon njohuri dhe/ ose përvojë të domosdoshme për të ushtruar operacione kontrolli dhe mbikëqyrjeje të sigurt dhe të besueshme të llojit të operimeve të specifikuar në licencë;

17.2. personeli i saj përgjegjës për sigurinë, në veçanti makinistët të jenë plotësisht të kualifikuar në fushat e tyre të aktivitetit; dhe

17.3. personeli i saj, mjetet lëvizëse hekurudhore dhe organizimi mund të sigurojnë nivel të lartë të sigurisë për shërbimet që do të ofrohen.

18. Secila ndërmarrje aplikuese duhet të ofroj të paktën gjërat e dhëna në vazhdim:

18.1. të dhënat për natyrën dhe mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse, në veçanti sa i përket standardeve të sigurisë.

18.2. të dhënat për kualifikimet e personelit përgjegjës për siguri dhe detajet për trajnimin e personelit.

19. Për organin licensues duhet të jepet dëshmia e duhur me shkrim e përputhjes me kërkesat e kualifikimit.

20. Ndërmarrja aplikuese duhet të jetë e siguruar në mënyrë adekuate, apo në përputhje me ligjet nacionale dhe ndërkombëtare të bëjë aranzhime ekuivalente për të mbuluar përgjegjësinë

e vet në rast të aksidenteve e në veçanti në lidhje me udhëtarët, bagazhin, mallrat, postën dhe palët e treta.

21. Procedurat për dhënien e licencës duhet të bëhen publike e gjithashtu edhe formularët dhe dokumentet e domosdoshme të cilat duhet të dorëzohen. Ato duhet të jenë në faqen e internetit të autoritetit licencues.

22. Organi licencues duhet të merr vendim për aplikimin sa më shpejt që është e mundshme por jo më shumë se tre muaj pasi të jenë paraqitur të gjitha informacionet relevante. Vendimi duhet t'i komunikohet ndërmarrjes hekurudhore aplikuese. Refuzimi duhet të reflektoj arsyet e refuzimit.

23. Organi licencues e informon ministrinë relevante për çështjet hekurudhore kur të jetë dhënë licenca. Autoriteti licencues duhet të vendos dhe të azhurnoj regjistrin e ndërmarrjeve hekurudhore të licencuara. Ky regjistër duhet të bëhet publik dhe duhet të jetë në faqen e internetit të autoritetit licencues.

24. Vendimet e organit licencues mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor.

Neni 93

Suspendimi dhe revokimi i licencës, amendamentet

1. Licenca është vlefshme aq kohë sa edhe ndërmarrja hekurudhore i plotëson obligimet e kërkuara ke këtë ligj.

2. Organi licencues mund të ofroj shqyrtim të rregullt të paktën çdo pesë (5) vite.

3. Dispozitat e veçanta që rregullojnë suspendimin apo revokimin e licencës mund të inkorporohen në licencë.

4. Nëse ekziston dyshimi serioz se ndërmarrja hekurudhore të cilin organi licencues e ka licencuar përputhet me kërkesat e këtij ligji, organi licencues mundet që në çdo kohë të kontrolloj nëse ndërmarrjet hekurudhore plotësojnë ato kërkesa.

5. Kur organi licencues nuk është i kënaqur me atë ndërmarrje hekurudhore e cila nuk i plotëson më tutje kërkesat e këtij ligji, duhet të suspendoj apo ta revokoj licencën.

6. Kur licenca suspendohet apo revokohet mbi bazat e mos përputhjes me kërkesat e përshtatshmërisë financiare, organi licencues mund të jep licencë të përkohshme duke pritur riorganizimin e ndërmarrjes hekurudhore me kusht që siguria të mos rrezikohet. Licenca e përkohshme megjithatë nuk duhet të jetë e vlefshme më shumë se gjashtë (6) muaj pas datës së lëshimit.

7. Kur ndërmarrja hekurudhore ka ndërprerë operimet për gjashtë (6) muaj apo nuk ka filluar operimet gjashtë (6) muaj pasi ka marrë licencën, atëherë organi licencues mund të vendos që

licenca të paraqitet për miratim apo për suspendim. Sa i përket fillimit të aktiviteteve, ndërmarrja hekurudhore mund të kërkojë që të vendoset për një kohë më të gjatë duke pasur parasysh natyrën specifike të shërbimeve që ofrohen.

8. Në rast të ndryshimit që ka efekt në situatën ligjore të ndërmarrjes dhe në veçanti në rast të bashkimit apo të kalimit të plotë, atëherë organi licencues mund të vendosë që licenca duhet të ridorëzohet për miratim. Ndërmarrja hekurudhore e tillë mund të vazhdojë operimet përveç nëse organi licencues vendos se siguria është rrezikuar; në këtë rast duhet të jepet bazat për një vendim të tillë.

9. Kur ndërmarrja hekurudhore synon të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme apo të zgjerojë aktivitetet, atëherë licenca e saj duhet të ridorëzohet tek organi licencues për shqyrtim.

10. Organi licencues nuk duhet të lejojë që të mbajë licencën ndërmarrja hekurudhore e cila është duke bankrotuar apo që veprimet e ngjashme kanë filluar, nëse organi licencues është i bindur se nuk ka perspektivë realiste për ripërtëritje financiare brenda një kohe të arsyeshme.

11. Kur organi licencues suspendon, revokon apo përmirëson licencën, atëherë organi licencues e informon Qeverinë e Kosovës e cila menjëherë i njofton vendet fqinje dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me Traktatin e Komunitetit të Transportit të SEETO-s.

12. Vendimet e organit licencues mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor.

Neni 94 **Certifikata e sigurisë**

1. Në mënyrë që t'i jepet qasje në infrastrukturën hekurudhore, ndërmarrja hekurudhore e cila është e licencuar duhet të ketë certifikatën e sigurisë siç kërkohet me këtë ligj. Certifikata e sigurisë mund të mbulojë tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës apo vetëm një pjesë të definuar të tij.

2. Qëllimi i certifikatës së sigurisë është të ofrojë dëshmi se ndërmarrja hekurudhore e ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësojë kërkesat e paraqitura në specifikimet teknike të interoperabilitetit (STI), legjislacionin tjetër të BE-së dhe rregullat nacionale të sigurisë për kontrollin e rrezikut dhe operimin e sigurt në rrjet.

3. Certifikata e sigurisë duhet të përmbajë:

3.1. përshkrimin i cili konfirmon pranimin e sistemit menaxhues të sigurisë së ndërmarrjes hekurudhore, në pajtim me këtë ligj. Ofrimi i pjesës së parë të certifikatës ka të bëjë me përshkrimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë që duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante, sidomos duhet të përshkruajë ndarjen e përgjegjësisë brenda organizatës së menaxherit të infrastrukturës apo ndërmarrjes hekurudhore. Aty duhet të tregohet se si sigurohet kontrolli nga menaxhmenti në nivele të ndryshme, si stafi dhe përfaqësuesit e tyre në nivele të ndryshme janë të përfshirë dhe

si sigurohen përparimet e vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të sigurisë. Elementet themelore të sistemit të menaxhimit të sigurisë janë:

3.1.1. politika e sigurisë e miratuar nga kryeshefi ekzekutiv i organizatës dhe që i komunikohet tërë stafit;

3.1.2. qëllimet kualitative dhe kuantitative të organizatës për mirëmbajtje dhe rritje të sigurisë si dhe planet dhe procedurat për të arritur ato qëllime;

3.1.3. procedurat për plotësimin e standardeve teknike dhe operacionale ekzistuese, të reja dhe të ndryshuara ashtu siç parashihet në STI apo rregullat nacionale të sigurisë, rregullat tjera relevante apo vendimet e autoritetit dhe procedurat për të siguruar përputhje me standardet dhe kushtet e tjera të përshkruara përmes ciklit jetësor të pajisjes dhe të operimeve;

3.1.4. procedurat dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të rrezikut dhe zbatimin e masave të kontrollit të rrezikut kurdo që ka ndryshim në kushtet e operimit apo materialet e reja që paraqesin rreziqe të reja në infrastrukturë apo në operime;

3.1.5. ofrimi i programeve për trajnim të stafit dhe sistemeve për të siguruar që kompetenca e stafit mbahet në nivel dhe detyrat kryhen në mënyrë përkatëse;

3.1.6. aranzhimet për ofrim të informatës së mjaftueshme brenda organizatës kur kjo është e duhur ndërmjet organizatave që operojnë në të njëjtën infrastrukturë;

3.1.7. procedurat dhe formatet se si informacioni i sigurisë duhet të dokumentohet dhe të caktohet procedura për konfigurimin e kontrollit të informacionit vital të sigurisë.

3.1.8. procedurat për të siguruar se aksidentet, incidentet, aksidentet e rënda dhe ngjarjet e tjera të rrezikshme të raportohen, hetohen dhe analizohen dhe merren masa të domosdoshme preventive;

3.1.9. ofrimi i planeve për veprim, alarmimet dhe informacioni në rast të emergjencës në pajtim me autoritetet e duhura publike;

3.1.10. dispozitat për auditimin e rregullt të brendshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë.

3.2. përshkrimi i cili konfirmon pranimin e dispozitave të miratuara nga ndërmarrja hekurudhore për plotësimin e kërkesave specifike të domosdoshme për operim të sigurt të rrjetit relevant. Kërkesat mund të përfshijnë aplikimet e STI-së dhe rregullat nacionale të sigurisë, pranimin e certifikatave të stafit dhe autorizimit për t'i futur në funksion mjetet e qarkullimit të ndërmarrjes hekurudhore. Ofrimi i certifikatës së

sigurisë të pjesës specifike të rrjetit, e quajtur pjesa (b), duhet të bazohet në dokumentacionin e paraqitur nga ndërmarrja hekurudhore:

3.2.1. dokumentacioni nga ndërmarrja hekurudhore për STI apo një pjesë të STI-së dhe kur është relevante rregullat nacionale të sigurisë dhe rregullat e tjera të aplikueshme në operimet e veta, stafin e vet dhe në mjetet e veta lëvizëse, si dhe se si sigurohet përputhja me sistemin e menaxhimit të sigurisë;

3.2.2. dokumentacioni nga ndërmarrja hekurudhore për kategoritë e ndryshme të stafit të punësuar apo kontraktuar për operim duke përfshirë dëshminë se ata plotësojnë kërkesat e STI-së apo rregullat nacionale dhe janë certifikuar si duhet;

3.2.3. dokumentacioni nga ndërmarrja hekurudhore për llojet e ndryshme të mjeteve lëvizëse të shfrytëzuara për operim duke përfshirë evidencën se ato i plotësojnë kërkesat e STI-së apo rregullat nacionale dhe që janë certifikuar si duhet. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/ 49 dhe Rregulloren e BE-së 653/ 2007 i cili përshkruan procedurat për marrjen e certifikatës së sigurisë në Kosovë.

4. Pjesa (a) e certifikatës së sigurisë e dhënë për ndërmarrjet hekurudhore të vendosura në BE nga organi i ngarkuar për siguri hekurudhore në një vend anëtar të BE-së, duhet të konsiderohet valide në Kosovë nëse është ende valide në BE dhe nëse është në përputhshmëri me legjislacionin e Kosovës.

5. Organi i sigurisë jep certifikata në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Organi i ngarkuar për sigurinë hekurudhore lëshon certifikata të sigurisë brenda 30 ditësh nga dita e aplikimit sipas rradhës. Certifikata e dhënë e sigurisë duhet të specifikoj llojin dhe shtrirjen e operimeve hekurudhore të përfshira.

6. Ndërmarrja hekurudhore e cila aplikon për certifikatë të sigurisë në Kosovë, duhet t'i ofroj organit licencues dokumentacionin në shqip, serbisht apo anglisht me të cilin konfirmohet se i plotëson kërkesat e specifikuar në këtë ligj.

7. Organi i sigurisë në shtetin tjetër në të cilin ndërmarrja hekurudhore planifikon të operoj me shërbime shtesë të transportit hekurudhor, duhet të lëshojë certifikatën e domosdoshme shtesë nacionale pas kontrollimit të aplikimit të ndërmarrjes hekurudhore.

8. Certifikata e sigurisë duhet të përtërihet pas aplikimit nga ndërmarrja hekurudhore në intervale që nuk i tejkalojnë pesë vite. Duhet të përtëritet plotësisht apo pjesërisht kurdo që lloji apo shtrirja e operimit është ndryshuar substancialisht.

9. Mbajtësi i certifikatës së sigurisë duhet që pa vonesë të informoj organin kompetent për të gjitha ndryshimet e mëdha në kushtet e pjesës relevante të certifikatës së sigurisë. Më tej duhet ta informoj organin kompetent të sigurisë kurdo që futen kategoritë e reja të stafit apo të mjeteve lëvizëse. Organi përgjegjës për çështje të sigurisë mund të kërkoj që pjesa relevante e

certifikatës së sigurisë të korrigojohet duke pasuar ndryshimet substanciale në kornizën e rregullatorit të sigurisë. Nëse organi i sigurisë vjen në përfundim se mbajtësi i certifikatës së sigurisë nuk i plotëson më tutje kushtet e certifikatës e cila i është lëshuar, atëherë ai duhet të revokoj pjesën e parë (a) dhe/ose të dytë (b) të certifikatës duke i dhënë arsyet për vendimin e vet. Organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore i cili e ka revokuar certifikatën nacionale shtesë, duhet që menjëherë të informoj organin i cili e ka dhënë certifikatën për vendimin e vet. Ngjashëm, organi i sigurisë duhet të revokoj certifikatën e sigurisë nëse është e dukshme se mbajtësi i certifikatës nuk e ka shfrytëzuar atë ashtu si ishte synuar në vitin kur ka filluar së shfrytëzuar.

10. Organi përgjegjës për çështje të sigurisë duhet ta informoj ministrinë brenda një muaji për certifikatën që është lëshuar, përtrirë, korrigjuar apo revokuar. Aty duhet të thuhet emri dhe adresa e ndërmarrjes hekurudhore, data, fushëpërfshirja dhe vlefshmëria e certifikatës së sigurisë dhe në rast të revokimit arsyet për atë vendim.

11. Vendimet e organit përgjegjës për çështje të sigurisë në lidhje me certifikatën e sigurisë mund t'i nënshtrohen shqyrtimit ligjor .

NËNKREU II **Makinistët dhe personeli tjetër**

Neni 95 **Licencat dhe certifikatat**

1. Të gjithë makinistët duhet të kenë përshtatshmërinë dhe kualifikimet e domosdoshme për të drejtuar trenat dhe duhet të kenë dokumentet vijuese:

1.1. licencën e cila demonstroi se makinisti i plotëson minimumin e kushteve sa i përket kërkesave mjekësore, edukimit bazik dhe aftësive të përgjithshme profesionale. Licenca duhet të identifikoj makinistin dhe autoritetin që ka lëshuar licencën si dhe të ceket afati i vlefshmërisë së saj. Licenca duhet të përputhet me kërkesat e paraqitura në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59/;

1.2. një apo më shumë certifikata që identifikojnë infrastrukturën në të cilën mbajtësi i licencës është i autorizuar të vozis dhe të identifikojnë mjetet lëvizëse të cilat mbajtësi i licencës është autorizuar t'i drejtoj. Secila certifikatë duhet të përputhet me kërkesat e paraqitura në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59/.

2. Megjithatë, kërkesa për certifikatë për pjesët specifike të infrastrukturës nuk paraqitet në rastet kur një tjetër makinist i trenit i cili posedon certifikatë valide për infrastrukturën në fjalë ulet afër makinistit i cili e vozitë trenin:

- 2.1. kur çrregullimet në shërbimin hekurudhor krijojnë domosdoshmëri për devijimin e trenit apo kur bëhet mirëmbajtja e binarëve e specifikuar nga menaxheri i infrastrukturës;
 - 2.2. për shërbimet e jashtëzakonshme që shfrytëzojnë trenat nga e kaluara;
 - 2.3. për shërbimet e jashtëzakonshme të mallrave me kusht që menaxheri i infrastrukturës të pajtohet;
 - 2.4. për ofrimin apo demonstrimin e trenit të ri apo lokomotivës;
 - 2.5. për qëllimin e trajnimit apo ekzaminimit të makinistëve. Shfrytëzimi i kësaj mundësie duhet të jetë vendim i ndërmarrjes hekurudhore dhe mund të mos imponohet nga menaxheri relevant i infrastrukturës apo nga autoriteti kompetent. Kurdo që shfrytëzohet makinisti shtesë ashtu siç thuhet më sipër, menaxheri i infrastrukturës duhet të informohet paraprakisht.
3. Certifikata duhet të autorizoj vozitjen në një apo më shumë kategori si në vazhdim:
 - 3.1. Kategoria A: lokomotivat manovruese, trenave të punës, mjeteve lëvizëse për mirëmbajtjen e hekurudhës dhe të gjitha lokomotivave tjera kur shfrytëzohen për manovrim;
 - 3.2. Kategoria B: transporti i udhëtarëve dhe/ ose mallrave;
 - 3.3. certifikata mund të përmbaj autorizimin për të gjitha kategoritë duke përfshirë të gjitha kodet të përshkruara në këtë ligj.
 4. Organi për licencimin e makinistëve dhe grupit tjetër në Kosovë, duhet të miratojë modelet e BE-së dhe rregullat për licencimin e makinistëve, certifikatave dhe kopjet e vërtetuara të certifikatave.
 5. Organi për licencimin e makinistëve duhet të ndërmerr të gjithë hapat e domosdoshëm për të shmangur rrezikun e falsifikimit të licencave dhe certifikatave dhe ngatërrimin me regjistrat e përmendur në këtë ligj.
 6. Nga organi për licencimin e makinistëve duhet të kërkohet që të:
 - 6.1. mbaj regjistër të të gjitha licencave të lëshuara, freskuara, përtërira, korrigjuara, të tejkaluara, suspenduara, tërhequra apo të raportuara si të humbura, vjedhura apo të shkatërruara. Ky regjistër duhet të përmbaj të dhënat për secilën licencë që duhet të jetë e qasshme duke shfrytëzuar numrin nacional të caktuar për secilin makinist. Ai duhet të freskohet rregullisht;
 - 6.2. pas një kërkesë të arsyeshme të ofroj informacionin për gjendjen e licencës për autoritetet kompetente të qeverive të vendeve të tjera dhe atë veçmas për ato të Traktatit

të Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-s, apo për ndonjë punëdhënës të makinistëve.

7. Nga secila ndërmarrje hekurudhore dhe menaxher i infrastrukturës duhet të kërkohet:

7.1. mbajtja e regjistrit për të gjitha certifikatat e lëshuara, freskuara, përtërira, korrigjuara, tejkaluara, suspenduara, tërhequra apo të raportuara si të humbura, të vjedhura apo të shkatërruara. Regjistri duhet të përmbaj të dhënat e përshkruara në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59/ për secilën certifikatë e gjithashtu të dhënat në lidhje me kontrollet periodike. Ai duhet të freskohet rregullisht me të dhëna të reja;

7.2. bashkëpunimi me autoritetin kompetent të shteteve tjera, në veçanti me ato të SEETO-s, ku makinistët mund të kenë vendbanimin e tyre, në mënyrë që të shkëmbehet informacioni me autoritetin kompetent dhe të jepet qasje në të dhënat e kërkuara;

7.3. ofrimi i informacionit për përmbajtjen e një certifikate të tillë për autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare e në veçanti me ato të Traktatit të Komunitetit të Transportit të SEETO-s me kërkesë të tyre kur kjo kërkohet si pasojë e aktiviteteve të tyre trans-nacionale.

8. Makinistët duhet të kenë qasje në të dhënat të cilat ju perkasin atyre të cilat ruhen në regjistrat e Organit për licencimin e makinistëve dhe të ndërmarrjeve hekurudhore dhe duhet të u ofrohet kopja e asaj të dhëne të kërkuar.

9. Organi për licencimin e makinistëve duhet t'i miratoj parametrat bazik të regjistrave për të vendosur ato të dhëna që do të regjistrohen, formatin e tyre dhe protokollin për shkëmbimin e të dhënave, të drejtat e qasjes, kohëzgjatjen e mbajtjes dhe procedurat që duhet të ndiqen në rast falimentimi.

10. Organi për licencimin e makinistëve, menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrja hekurudhore duhet të sigurohen se regjistrat e ofruar dhe llojet e operimeve të regjistrave të tillë të përputhen me ligjin mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Licenca e makinistëve duhet të jetë në pronësi të mbajtësit.

11. Organi për licencimin e makinistëve i cili lëshon licenca për makinistët në Kosovë, e mban regjistrin dhe ofron informacion te nevojshëm. Misioni, detyrat dhe procedurat e tij do të përcaktohen sipas aktit nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59.

12. Certifikatat e makinistëve duhet të lëshohen nga ndërmarrja hekurudhore apo nga menaxheri i infrastrukturës që e punëson apo e kontraktton makinistin. Certifikata duhet të jetë në pronësi të ndërmarrjes apo menaxherit që e lëshon atë. Megjithatë, makinistët duhet të kenë të drejtë të marrin kopjen e vërtetuar. Certifikatat duhet të lëshohen nga ndërmarrja hekurudhore apo nga menaxheri i infrastrukturës në gjuhën shqipe, serbe dhe anglishte.

13. Vlefshmëria gjeografike

13.1. licenca e makinistit duhet të jetë e vlefshme në tërë Kosovën dhe mund të jetë e vlefshme edhe në shtetet e tjera duke ofruar marrëveshje specifike ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera.

13.2. certifikata e makinistit duhet të jetë e vlefshme vetëm për infrastrukturën dhe mjetet lëvizëse që identifikohen në te.

14. Licenca e makinistëve e lëshuar në shtetin anëtar të BE-së që është ende valide duhet të konsiderohet valide në Kosovë nëse është në pajtim me legjislacionin në Kosovë.

Neni 96

Kushtet për marrjen e licencës dhe certifikatës së makinistit

1. Për të marrë licencën, aplikuesit duhet të plotësojnë minimumin e kërkesave të paraqitura në këtë ligj. Për të marrë certifikatë dhe që ajo të mbetet e vlefshme, aplikuesit duhet të mbajnë licencë dhe të plotësojnë kërkesat minimale të paraqitura më poshtë.

2. Moshë minimale e aplikuesit, për të marrë licencë duhet të jetë së paku njëzetedy (22) vjeçare.

3. Kërkesat bazike për marrjen e licencës:

3.1. aplikuesit duhet që të paktën të kenë të kryer shkollën e mesme dhe të kenë të kryer me sukses trajnimin bazik. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/ 59 duhet të përshkruaj nivelin e edukimit dhe trajnimin e kërkuar.

3.2. aplikuesit duhet të ofrojnë konfirmim të përshtatshmërisë së tyre fizike duke kaluar kontrollin mjekësor të kryer nën mbikëqyrjen e institucionit mjekësor (kjo vendoset nga shtetet anëtare) të akredituar apo të njohur në përputhje me këtë ligj. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/ 59 duhet të përshkruaj kriteret të cilat duhet të plotësohen me këtë kontrollim mjekësor.

3.3. aplikuesit duhet të demonstrojnë përshtatshmërinë e tyre psikologjike profesionale të kryer në institucionin mjekësor (kjo vendoset nga shtetet anëtare) të akredituar apo të njohur në përputhje me këtë ligj. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 duhet të përshkruaj kriteret që duhet të plotësojë kontrolli mjekësor.

3.4. aplikuesit duhet të demonstrojnë aftësinë e tyre të përgjithshme profesionale duke kaluar provimin i cili i mbulon të paktën lëndët e përgjithshme. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 duhet të përshkruaj lëndët e përgjithshme të këtij provimi.

4. Kërkesat për marrjen e certifikatës së makinistit:

4.1. aplikuesit për certifikatën e makinistit duhet ta njohin gjuhën shqipe dhe serbe.

4.2. aplikuesit duhet të kalojnë testin mbi njohuritë dhe kompetencën e tyre profesionale në lidhje me mjetet lëvizëse për të cilat kërkohet certifikata. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 duhet të përshkruaj lëndët e përgjithshme të këtij provimi.

4.3. aplikuesit duhet të kalojnë testin mbi njohuritë dhe kompetencën e tyre profesionale në lidhje me infrastrukturën hekurudhore për të cilat kërkohet certifikata. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 duhet të përshkruaj lëndët e përgjithshme të këtij provimi dhe aty ku është e përshtatshme edhe njohuritë gjuhësore.

4.4. aplikuesit duhet të trajnohen nga ndërmarrja hekurudhore apo nga menaxheri i infrastrukturës për sistemin e menaxhimit të sigurisë të përshkruar në këtë ligj.

5. Të gjitha kërkesat themelore për marrje të licencës së makinistit dhe kushtet për marrjen e certifikatës, duhet të përshkruhen në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59 i cili po ashtu duhet të përshkruaj formatet e licencave dhe certifikatave të makinistëve dhe përmbajtjen e regjistrave të licencave dhe certifikatave të makinistëve të cilat duhet të mbahen nga autoriteti kompetent dhe të jenë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara.

6. Organi për licencimin e makinistëve duhet të publikoj procedurën për marrjen e licencës që duhet të ndjeket:

6.1. të gjitha aplikimet për licencë duhet të paraqiten tek Organi për licencimin e makinistëve nga makinisti kandidat apo nga entiteti në emër të tij;

6.2. aplikimet e paraqitura tek Organi për licencimin e makinistëve mund të jenë për dhënien e licencës së re, përmirësimin e të dhënave në licencë, përtëritjen apo duplifikimin e saj;

6.3. organi për licencimin e makinistëve duhet të lëshoj licencë sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se një (1) muaj pasi pranimit të dokumentacionit të domosdoshëm;

6.4. licenca duhet të jetë e vlefshme për dhjetë (10) vite por që i nënshtrohet kontrollimeve periodike, inspektimeve dhe monitorimit;

6.5. licenca duhet të lëshohet në vetëm një origjinal. Çfarëdo duplikati i licencës tjetër nga ajo e Organit për licencimin e makinistëve ku kërkohet duplifikimi, duhet të ndalohet.

7. Secila ndërmarrje hekurudhore dhe menaxher i infrastrukturës duhet të vendos procedurat e veta për lëshimin dhe freskimin e certifikatave në përputhje me këtë ligj, si pjesë e sistemit të menaxhimit të sigurisë e gjithashtu procedurat e ankimit që u lejon makinistëve të kërkojnë shqyrtim të vendimit në lidhje me lëshimin, freskimin, suspendimin dhe tërheqjen e certifikatës. Në rast të mosmarrëveshjes, palët mund të ankohen tek Organi Rregullativ i Tregut apo te çfarëdo organi tjetër i pavarur.

8. Ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxheri i infrastrukturës duhet të freskojnë pa vonesë certifikatën kurdo që pronari i certifikatës të ketë marrë autorizimet shtesë në lidhje me mjetet lëvizëse apo infrastrukturën.

Neni 97 **Kontrollimet periodike dhe monitorimi**

1. Në mënyrë që licenca të mbetet e vlefshme, pronari i saj duhet t'i kaloj provimet periodike dhe/ ose testimin. Në lidhje me kërkesat mjekësore, minimumi i frekuentimit duhet të jetë në përputhje me dispozitat e aktit nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59. Këto kontrollime mjekësore duhet të kryhen nga dhe nën mbikëqyrjen e mjekëve apo institutit të akredituar të njohur. Sa i përket njohurisë profesionale të përgjithshme duhet të vendoset një trajnim i vazhdueshëm për të siguruar se kompetencat e stafit janë ruajtur në përputhje me kërkesat detaje të dhëna në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59. Kur bëhet përtëritja e licencës, autoriteti kompetent duhet të verifikoj në regjistrin e ofruar se makinisti i plotëson kërkesat.

2. Në mënyrë që certifikata të mbetet e vlefshme, pronari i saj duhet të kaloj nëpër kontrollime periodike dhe/ ose teste. Numri i këtyre kontrollimeve dhe/ ose testeve duhet të përcaktohet nga ndërmarrja hekurudhore apo menaxheri i infrastrukturës, duke e punësuar apo kontraktuar makinistin në përputhje me sistemin e vet të menaxhimit të sigurisë dhe duke e respektuar këtë numër minimal të kontrollimeve dhe/ ose testeve i vendosur në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2007/59. Për secilën nga këto kontrollime, Organi për licencimin e makinistëve duhet të konfirmoj me deklaratë dhe në regjistër se makinisti i ka plotësuar kërkesat.

3. Nga ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës duhet të kërkohet që të kontrollojnë dhe të sigurojnë se licencat dhe certifikatat e makinistëve të punësuar apo të kontraktuar janë të vlefshme. Ata duhet të vendosin sistemin e monitorimit të makinistëve të tyre. Nëse rezultatet e monitorimit të tillë kanë vërejtje për makinistin dhe kompetencën e tij në punë dhe vazhdimësinë e vlefshmërisë së licencës apo certifikatës së tij, atëherë ndërmarrja hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës duhet të ndërmarrin veprim të menjëhershëm.

4. Kur makinisti pushon së punuari për ndërmarrjen hekurudhore apo për menaxherin e infrastrukturës hekurudhore, ai duhet ta informoj Organi për licencimin e makinistëve pa vonesë. Licenca duhet të mbetet e vlefshme me kusht nëse plotësohen kontrollimet periodike.

5. Certifikata duhet të zhvleftësohet kur pronari nuk e ushtron më detyrën e makinistit. Megjithatë, pronari duhet të pranoj kopjen e certifikatës dhe të gjitha dokumentet që tregojnë dëshminë e trajnimit, kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës profesionale. Kur behet lëshimi i certifikatës për makinistin, ndërmarrja hekurudhore apo menaxheri i infrastrukturës duhet t'i merr parasysh të gjitha këto dokumente.

6. Organi për licencimin e makinistëve mundet që në çdo kohë të ndërmerr veprim të verifikimit të trenave të cilët funksionojnë dhe operojnë në hapësirën e tij të juridiksionit në aspektin se a i ka makinisti në pronësi dokumentet e lëshuara sipas këtij ligji.

7. Organi për licencimin e makinistëve mund të ushtroj pyetje në lidhje me përputhjen me këtë ligj për makinistët, ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës, ekzaminerët dhe qendrat e trajnimit që kryejnë aktivitetet e tyre në hapësirën e juridiksionit të tij. Nëse organi për licencimin e makinistëve gjen se makinisti më nuk i plotëson një apo më shumë nga kushtet e kërkuara, atëherë ai duhet të ndërmerr veprim siç është suspendimi i licencës. Ndalesa e operimit të trenave mund të vendoset pas qasjes së organit i cili e ka lëshuar certifikatën e makinistit.

8. Organi për licencimin e makinistëve bën kontrollimin dhe monitorimin e licencave të makinistëve pas lëshuarjes se tyre.

Neni 98

Qasja në pajisjet e trajnimit për makinistët

1. Ndërmarrjet hekurudhore që aplikojnë për certifikatë të sigurisë duhet të kenë qasje të drejtë dhe jodiskriminuese në pajisjet e trajnimit për makinistët dhe stafin përcjellës të trenave, sa herë që këto janë të nevojshme për përmbushjen e kërkesave për tu certifikuar. Shërbimi i ofruar duhet të përfshijë trajnimin e nevojshëm për njohuri të linjës, rregullat dhe procedurat e operimit, sistemin e komandës së sinjalizimit dhe kontrollit dhe procedurat emergjente të aplikuara në linjat e operimit. Menaxherët e infrastrukturës dhe stafi i tyre i cili kryen detyrat vitale të sigurisë duhet të kenë qasje të drejtë dhe jodiskriminuese në pajisjet e trajnimit. Nëse shërbimet e trajnimit nuk i përfshijnë ekzaminimet dhe dhënien e certifikatave, ndërmarrjet hekurudhore duhet të kenë qasje në ato certifikime, nëse kjo është kërkesë e certifikatës së sigurisë.

2. Nëse mundësitë e trajnimit janë në dispozicion vetëm përmes shërbimeve të një ndërmarrjeje të vetme hekurudhore apo të menaxherit të infrastrukturës, ato duhen të jenë në dispozicion për ndërmarrjet e tjera hekurudhore me çmim të arsyeshëm dhe jodiskriminues që është e lidhur me koston dhe ka margjinë fitimprurëse.

3. Kur të rekrutojnë makinistët e rinj të trenave, stafin në bordin e trenave dhe stafin që kryen detyra vitale të sigurisë, ndërmarrjet hekurudhore duhet të jenë në gjendje të marrin parasysh çfarëdo trajnimi, kualifikimi dhe përvojë që është fituar më parë nga ndërmarrjet e tjera hekurudhore. Për këtë arsye këta anëtarë të stafit duhet të kenë të drejtë të kenë qasje në marrjen e kopjeve dhe të bëjnë komunikimin e të gjitha dokumenteve me të cilat e dëshmojnë kualifikimin, trajnimin dhe përvojën.

4. Secila ndërmarrje hekurudhore dhe secili menaxher i infrastrukturës duhet të jenë përgjegjës për nivelin e trajnimit dhe kualifikimit të stafit të tyre të cilët kryejnë punë lidhur me sigurinë.

5. Organi për licencimin e makinistëve dhe organi rregullativ i tregut hekurudhor duhet të jetë përgjegjës për monitorimin e këtyre kushteve për dispozitat e trajnimit për makinistët dhe posaçërisht për kontrollimin nëse dispozitat e shërbimeve të trajnimit i përmbushin kërkesat e STI-së.

Neni 99

Kushtet e përgjithshme të punës për personelin tjetër hekurudhor përveç makinistëve

1. Personeli i sektorit hekurudhor në Kosovë është i punësuar me status të nëpunësve të sektorit publik sipas kontratave specifike të kompanisë.

2. Organizimi i orarit të punës të nëpunësve të sektorit hekurudhor duhet t'i nënshtrohet këtyre kërkesave minimale të sigurisë dhe atyre shëndetësore veçanërisht sa i përket punës së natës:

2.1. secili punëtor ka të drejtë për një periudhë pushimi ditor minimal prej njëmbëdhjetë (11) orë në periudhën njëzetekatër (24) orëshe;

2.2. kur dita e punës është me e gjatë se gjashtë orë, çdo punëtor ka të drejtë për një pushim, i cili përcaktohet me marrëveshje kolektive;

2.3. për çdo periudhë shtatëditore çdo punëtor ka të drejtë për një periudhë të pandërprerë pushimi prej njëzetekatër (24) orë plus pushimit ditor njëmbëdhjetë (11) orë, siç referohet me lartë;

2.4. duke pasur parasysh nevojën për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve:

2.4.1. periudha javore e kohës së punës kufizohet në bazë të ligjit, rregulloreve apo dispozitave administrative apo me marrëveshje kolektive apo marrëveshje në mes të dy anëve të industrisë;

2.4.2. orari mesatar i punës për secilën periudhë shtatë-ditore, duke përfshirë edhe punën jashtë orarit, nuk i tejkalon dyzetetë (48) orë.

2.5. secili punëtor ka të drejtë për pushim të paguar vjetor së paku katër javë, në përputhshmëri me kushtet për këtë të drejtë, dhe dhënien e këtij pushimi, siç është paraparë me legjislacion kombëtar dhe/apo në praktikë;

2.6. periudha minimale e pushimit vjetor të paguar nuk mund të zëvendësohet me asnjë kompensim, përveç nëse marrëdhënia e punës ndërpritet;

2.7. Kur merret parasysh puna e natës:

2.7.1. orët normale të punës së natës nuk duhet ta tejkalojnë mesataren e tetë orëve të punës në periudhën njëzetekatër (24) orëshe;

2.7.2. punëtorët e natës, puna e të cilëve përfshin rreziqe të veçanta apo tendosje të rëndë fizike apo mentale nuk duhet të punojnë më gjatë se tetë (8) orë gjatë një periudhe njëzetekatër (24) orë gjatë së cilës ata kryejnë punë nate.

2.8. puna që përfshin rreziqe të veçanta apo tendosje të rëndë fizike apo mentale duhet të definohet me marrëveshje të kompanisë duke pasur parasysh efektet e veçanta dhe rreziqet e punës së natës;

2.9. punëtorëve të natës duhet të u ofrohet kontrolli pa pagesë i shëndetit në përputhshmëri me konfidencialitetin mjekësor. Në rast se punëtorët e natës vuajnë nga problemet shëndetësore të njohura si të lidhura me faktin se ata punojnë natën, ata duhet të transferohen sa herë që të jetë e mundur në punë ditore të cilën janë në gjendje ta kryejnë;

2.10. punëtorët e natës dhe punëtorët me ndërrime duhet të kenë mbrojtje të sigurisë dhe të shëndetit të përshtatshme me natyrën e tyre të punës;

2.11. kushtet specifike të punës janë të definuara me rregullore për stafin që kalon kohën e punës në bordin e trenit dhe aktiviteti i të cilëve lidhet me orarin e transportit dhe duhet të sigurojnë vazhdimësinë dhe rregullsinë e trafikut.

KREU VII

SIGURIA E SISTEMIT HEKURUDHOR

Neni 100

Parimet e sigurisë

1. ARH duhet të siguroj që siguria hekurudhore përgjithësisht mirëmbahet, atëherë kur është e arsyeshme dhe praktike përmirësohet vazhdimisht duke marrë parasysh legjislacionin e BE-së, ndryshimet, përparimet teknike dhe shkencore dhe prioritetin që i jepet parandalimit të aksidenteve serioze. Ministria duhet të siguroj se rregullat e sigurisë janë në vend, aplikohen dhe zbatohen në mënyrë të hapur dhe jodiskriminuese nga organi i sigurisë.

2. ARH duhet të siguroj masat për zhvillimin dhe përmirësimin e sigurisë hekurudhore, të merr parasysh nevojën për një qasje të bazuar në sistem.

3. ARH duhet të siguroj që përgjegjësia për operim të sigurt të sistemit hekurudhor dhe kontrollit të rreziqeve të shoqëruara me të, janë të vendosura nga menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore, duke i obliguar ata të zbatojnë masat e domosdoshme të kontrollit të rrezikut, kur është e mundur në bashkëpunim me njëra tjetrën për të aplikuar rregullat nacionale të sigurisë dhe për të vendosur sisteme të menaxhimit të sigurisë në përputhje me këtë ligj. Pa paragjykuar përgjegjësinë civile, secili menaxher i infrastrukturës dhe ndërmarrje hekurudhore duhet të mbahen përgjegjës për pjesën e vet të sistemit dhe për

operimin e tij të sigurt duke përfshirë këtu furnizimin me material, kontraktimin e shërbimeve përball shfrytëzuesve, konsumatorëve, punëtorëve të përfshirë dhe palëve të treta.

4. Kjo nuk duhet të paragjykoj përgjegjësinë e secilit prodhues, ofrues të mirëmbajtjes, mbajtës të vagonëve, ofrues të shërbimeve dhe entitetin e prokurimit për të siguruar që mjetet lëvizëse, instalimet, pajisjet ndihmëse dhe pajisjet si dhe shërbimet e ofruara nga ata, përputhen me kërkesat dhe kushtet e specifikuara për shfrytëzim, ashtu që ato të mund të vendosen në operim të sigurt nga ana e ndërmarrjes hekurudhore dhe/ ose menaxheri i infrastrukturës.

Neni 101

Indikatorët e sigurisë, metodat dhe qëllimet

1. Treguesit e përbashkët të sigurisë. Në mënyrë që të lehtësohet vlerësimi i arritjes së qëllimeve të përbashkëta të sigurisë të zhvilluara në BE (QPS) dhe të ofrohet monitorim i zhvillimit të përgjithshëm të sigurisë hekurudhore, Organi përgjegjës për sigurinë duhet të mbledh informacion për treguesit e përbashkët të sigurisë (TPS) nëpërmes të raportit vjetor. TPS-të duhet të vendosen ashtu siç është definuar nga BE-ja dhe të bëhet propozimi i përdorimit të tyre nga ministria.

2. Metodatat e përbashkëta të sigurisë:

2.1. metodatat e përbashkëta të sigurisë (MPS) të zhvilluara nga BE-ja dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, duhet të konsiderohen si bazike për sigurinë hekurudhore në Kosovë dhe duhet të përdoren nga organi përgjegjës për sigurinë;

2.2. MPS të zhvilluara në BE përshkruajnë se si niveli i sigurisë dhe arritja e qëllimeve të sigurisë dhe përputhjes me kërkesat e tjera të sigurisë janë vlerësuar duke elaboruar dhe definua:

2.2.1. vlerësimin e rrezikut dhe metodatat e vlerësimit;

2.2.2. metodatat për vlerësimin e përputhjes me kërkesat në certifikatat e sigurisë dhe autorizimet e sigurisë të lëshuara në përputhje me këtë ligj;

2.2.3. përderisa ata akoma nuk janë të mbuluar me STI metodatat për të kontrolluar se nënsistemet strukturale të sistemeve hekurudhore trans Evropiane të shpejtësisë së lartë dhe ato konvencionale të sistemeve hekurudhore operohen dhe mirëmbahen në përputhje me kërkesat relevante esenciale.

2.3. MPS-të të zhvilluara nga BE-ja duhet të merren si bazë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në Kosovë. Ato duhet të përshkruhen me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49 dhe 2008/10, si dhe rregulloret tjera të BE-së të zhvilluara nga Agjencia Hekurudhore Evropiane;

2.4. Ministria duhet të bëj korrigjimet e domosdoshme të rregullave nacionale të sigurisë për sistemin hekurudhor të Kosovës në dritën e miratimit të MPS-ve të zhvilluara në BE dhe të përshkruara në aktin nënligjor të përmendur më sipër.

3. Caqet e përbashkëta të sigurisë:

3.1. caqet e përbashkëta të sigurisë (CPS) së bashku me vlerësimin e kostos së tyre dhe përfitimet, treguesi i ndikimeve të tyre për akterët e ekonomisë dhe për ndikimin e tyre në pranimin social të rrezikut duhet të konsiderohen si baza për sigurinë hekurudhore në Kosovë dhe duhet të propozohen si caqe në Kosovë nga organi i ngarkuar me sigurinë hekurudhore. Ato duhet të definojnë nivelet e sigurisë që duhet të paktën të arrihen nga pjesët e ndryshme të sistemit Evropian të hekurudhave dhe nga sistemi si tërësi;

3.2. Ministria duhet të bëjë përpjekjet maksimale për të futur amendamentet e domosdoshme në rregullat nacionale të sigurisë për të arritur Caqet e Përbashkëta të Sigurisë ashtu si janë definuar në nivel të BE-së. Këto CPS duhet të përshkruhen në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49 dhe 2008/10.

Neni 102

Rregullat nacionale të sigurisë

1. Ministria duhet të paraqes rregullat nacionale të obligueshme të sigurisë me propozimin e organit përgjegjës të sigurisë dhe nën mbikëqyrjen e tij duke siguruar kështu se këto rregulla janë publikuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe t'i vej ato në dispozicion të menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore, aplikuesve për certifikatën e sigurisë dhe autorizimin e sigurisë në një gjuhë të qartë për palët e përfshira. Këto rregulla duhet të jenë në dispozicion në faqen e internetit të organit përgjegjës për çështje të sigurisë.

2. Rregullat nacionale të sigurisë duhet të përfshijnë si vijon:

2.1. kërkesat e përgjithshme teknike që duhet të plotësohen gjatë dizajnit, ndërtimit, rindërtimit, tërheqjes dhe mirëmbajtjes të pjesëve integrale të infrastrukturës hekurudhore për mundësimin e trafikut të sigurt hekurudhor;

2.2. metodat dhe procedurat për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, metodën e mbajtjes së shënimeve për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit e gjithashtu kushtet që duhet të plotësohen nga entiteti që bënë mirëmbajtjen e mjeteve të transportit;

2.3. pajisjet e vendeve zyrtare të menaxherit të infrastrukturës;

2.4. rregullat e trafikut hekurudhor të sigurt sa i përket mjeteve të transportit, hekurudhës dhe eksplotimit si dhe rregullat e operimit të trafikut hekurudhor;

2.5. procedurat për marrjen e licencës për rregullat e operimit hekurudhor;

- 2.6. kryqëzimin e hekurudhës me rrugën nga aspekti i trafikut hekurudhor të sigurt;
 - 2.7. detyrat dhe përgjegjësitë e personelit të hekurudhës që merr pjesë drejtpërdrejt në trafikun hekurudhor;
 - 2.8. rregullin e brendshëm dhe mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve të transportit;
 - 2.9. identifikimin e strukturave të rëndësishme të veçantë për sigurinë e trafikut hekurudhor;
 - 2.10. kushtet që duhet të plotësohen nga punëtorët hekurudhor;
 - 2.11. transporti për nevoja vetanake;
 - 2.12. masat e veçanta të sigurisë.
3. Rregullat nacionale të sigurisë për sektorin hekurudhor në Kosovë duhet të përcaktohen me akt nënligjor;
4. Ministria duhet të konsultohet me të gjitha palët e interesuara me kohë nëse dëshirojnë të paraqes rregullat e reja nacionale të sigurisë që kërkojnë siguri më të lartë se sa Caqet e Përbashkëta të Sigurisë të zhvilluara në nivel BE-së apo të Traktatit të Komunitetit të Transportit në kuadër të SEETO-s.

Neni 103 **Sistemi i menaxhimit të sigurisë**

1. Menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore duhet të vendosin sistemet e tyre të menaxhimit të sigurisë për të siguruar se sistemi hekurudhor mund të arrijë të paktën Caqet e Përbashkëta të Sigurisë në përputhje me rregullat nacionale të sigurisë dhe me kërkesat e sigurisë të paraqitura në STI dhe se do të aplikohen pjesët relevante të MPS-ve.
2. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të plotësojë kërkesat e sigurisë dhe t'i përmbajë elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor të përshtatur për karakterin, shtrirjen dhe kushtet e tjera të aktivitetit të kërkuar. Duhet të sigurojë kontroll të të gjitha rreziqeve të cilat i shoqërojnë aktivitetet e menaxherit të infrastrukturës apo ndërmarrjes hekurudhore, duke përfshirë furnizimin me mirëmbajtje, material si dhe shfrytëzimin e kontraktorëve. Pa paragjykuar ekzistimin e rregullave nacionale dhe ndërkombëtare të përgjegjësisë, sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet gjithashtu të merr parasysh kur është e duhur dhe e arsyeshme rreziqet që rrjedhin nga rezultati i aktiviteteve nga palët e tjera.
3. Sistemi i menaxhimit të sigurisë i ndonjë menaxheri të infrastrukturës duhet të merr parasysh efektet e operimeve nga ndërmarrjet e ndryshme hekurudhore në rrjet dhe të ofrohet dispozita për të lejuar të gjitha ndërmarrjet hekurudhore të operojnë në përputhje me STI-të dhe rregullat

nacionale të sigurisë të paraqitura në certifikatën e tyre të sigurisë. Për më tepër duhet të zhvillohet me qëllim të koordinimit të procedurave emergjente të menaxherit të infrastrukturës me të gjitha ndërmarrjet hekurudhore që operojnë në infrastrukturën e tij.

4. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të dokumentohet në të gjitha pjesët relevante dhe duhet të përshkruaj përgjegjësitë në kuadër të kornizës së organizimit të menaxherit të infrastrukturës së transportuesit hekurudhor. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të përshkruaj metodën e kontrollit në nivele të ndryshme menaxhuese nga menaxhmenti, roli i stafit në të gjitha nivelet dhe se si ofrohet përmirësimi i përhershëm.

5. Elementet bazike për sistemin e menaxhimit të sigurisë duhet të jenë si në vazhdim:

5.1. dokumenti që përshkruan politikën e sigurisë i miratuar nga menaxherët e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore nga përfaqësuesit e lartë ekzekutiv. Kjo politikë duhet të jetë në dispozicion për të gjithë punëtorët;

5.2. përshkrimi i qëllimeve kualitative dhe kuantitative të organizimit për të mirëmbajtur dhe përmirësuar sigurinë, planet dhe procedurat për arritjen e qëllimeve të tilla;

5.3. përshkrimi i procedurës për plotësimin e standardeve ekzistuese, të reja dhe të përmirësuara teknike dhe operative apo të kushteve tjera të përshkruara në STI-të, Rregullat Nacionale të Sigurisë të theksuara në vendimet e tjera nga autoritetet kompetente dhe në metodat e shfrytëzimit të pajisjes si dhe kryerjes së operimeve;

5.4. përshkrimi i procedurave dhe metodave për vlerësimin e rrezikut dhe zbatimin e masave për kontrollin e rrezikut, gjithmonë kur ndryshimi i kushteve të operimit apo i materialeve të reja paraqesin rrezik të ri për infrastrukturën hekurudhore apo për operimet;

5.5. përshkrimin e programeve trajnuese për personelin për të demonstruar se kompetencat e personelit janë ruajtur dhe zhvilluar;

5.6. përshkrimin e informacionit brenda organizatës për të demonstruar se si është shpërndarë informacioni në lidhje me planet e sigurisë dhe procedurat e sigurisë dhe kur është e zbatueshme se si është shkëmbyer përshkrimi i informacionit në lidhje me planet e sigurisë dhe procedurat e sigurisë ndërmjet organizatave që operojnë në të njëjtën infrastrukturë hekurudhore;

5.7. përshkrimi i procedurave dhe formave për dokumentimin e informacionit në lidhje me sigurinë, përshkrimin e procedurave për informacion e kontrollit të sigurisë kur është e nevojshme si konfidencial;

5.8. përshkrimin e procedurave për të siguruar se aksidentet, incidentet rrëshqitjet dhe ngjarjet e rrezikshme të tjera janë raportuar si duhet, hetuar dhe analizuar dhe se janë marrë masat preventive;

5.9. planet e veprimit për situatat emergjente dhe menaxhimin e krizës të bazuara në bashkëpunim me autoritetet kompetente;

5.10. përshkrimin e vazhdimit të auditimeve të brendshme periodike të sistemit të menaxhimit të sigurisë.

6. Çdo vit, të gjithë menaxheret e infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore para 30 qershorit duhet të paraqesin raportin vjetor të sigurisë në lidhje me vitin kalendarik të mëparshëm te organi përgjegjës për sigurinë. Raporti i sigurisë së paku duhet të përmbaj:

6.1. informacionin se sa janë arritur caqet e përbashkëta të sigurisë së organizatës dhe rezultatet e planeve të sigurisë;

6.2. zhvillimin e treguesve nacional të sigurisë dhe Instrumentet e Përbashkëta të Sigurisë të paraqitura në këtë ligj për atë që është relevante për organizatën raportuese;

6.3. rezultatet e auditimit të brendshëm të sigurisë;

6.4. observimet e mungesave dhe keqfunksionimit të operimeve hekurudhore dhe menaxhimit të infrastrukturës që mund të jetë relevante për organin e sigurisë.

7. Përshkrimi më preciz i kërkesave, procedurave dhe testeve duhet të përshkruhet në aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49.

Neni 104

Certifikatat dhe autorizimet e sigurisë

1. Secila ndërmarrje hekurudhore që mban licencën duhet të merr certifikatën e sigurisë para se t'i jepet e drejta për qasje në një infrastrukturë hekurudhore. Qëllimi i certifikatës së sigurisë është të ofroj dëshmi se ndërmarrja hekurudhore ka të vendosur sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe mund të plotësoj kërkesat e paraqitura në STI-të dhe në legjislacionin relevant të BE-së si dhe në rregullat nacionale të sigurisë në ofrimin e shërbimeve të transportit të sigurt në rrjet.

2. Secili menaxher i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët duhet të merr autorizimin e sigurisë. Autorizimi i sigurisë duhet të përmbajë:

2.1. përshkrimin që konfirmon pranimin e sistemit të menaxhimit të infrastrukturës;

2.2. përshkrimin që konfirmon pranimin e dispozitave të menaxherit të infrastrukturës për të plotësuar kërkesat specifike të domosdoshme për dizajn, mirëmbajtje dhe operim të sigurt të infrastrukturës hekurudhore duke përfshirë kur është e përshtatshme mirëmbajtjen dhe operimin e kontrollit të trafikut dhe sistemin e sinjalizimit.

3. Secila ndërmarrje hekurudhore duhet të pajiset me certifikatë (pjesën a dhe pjesën b) para se t'i jepet qasja në infrastrukturën hekurudhore.

4. Të gjithë akterët e tregut të cilët janë pajisur me certifikata të sigurisë, autorizimet e sigurisë duhet të monitorojnë nëse ata i plotësojnë kërkesat e certifikatave të tyre dhe të marrin veprime korrektuese nëse është e domosdoshme.

5. Organi i ngarkuar me sigurinë hekurudhore duhet të jetë i lirë për të kryer inspektimet dhe hetime të cilat janë të nevojshme për t'i kryer detyrat e veta dhe duhet t'i jepet qasje në të gjitha dokumentet relevante dhe objektet, instalimet dhe pajisjet e menaxherëve të infrastrukturës dhe të ndërmarrjeve hekurudhore.

6. Organi i ngarkuar për dhënien e certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë është organi i Sigurisë

KREU VIII KËRKESAT E SIGURISË

Neni 105

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë për sistemet dhe nënsistemet hekurudhore

1. Të gjitha nënsistemet hekurudhore duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme të sigurisë sikurse janë definuar në këtë ligj:

1.1. dizajni, ndërtimi apo montimi, mirëmbajtja dhe monitorimi i komponentëve kritike të sigurisë, në veçanti komponentëve të përfshira në lëvizjen e trenit duhet të jenë të tilla që të garantojnë siguri në të gjitha nivelet korresponduese të qëllimeve të përbashkëta të sigurisë të paraqitura për sektorin hekurudhor duke përfshirë situatat e degraduara specifike;

1.2. parametrat e përfshirë në kontaktin rrotë/binar duhet të plotësojnë stabilitetin e nevojshëm për të garantuar lëvizjen e sigurt me një shpejtësi maksimale të autorizuar. Parametrat e pajisjes së frenimit duhet të garantojnë mundësinë e frenimit brenda distancës së dhënë të frenimit me një shpejtësi maksimale të autorizuar;

1.3. komponentët e shfrytëzuar duhet t'i qëndrojnë tendosjes normale dhe përjashtimore që janë specifikuar gjatë kohës së shërbimit. Pasojat e sigurisë të ndonjë dështimi aksidental duhet të kufizohen me mjete të duhura;

1.4. dizajni i instalimeve të vendosura dhe mjeteve lëvizëse si dhe zgjedhja e materialit të shfrytëzuar duhet të synoj kufizimin e gjenerimit, përhapjes dhe efekteve të zjarrit si dhe tymit në rast të zjarrit;

1.5. aparaturat të cilat synohen të përdoret nga shfrytëzuesit, duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të mos pengojnë operimin e sigurt të aparatit apo shëndetit dhe sigurisë nëse të njëjtat shfrytëzohen në mënyrën e parashikuar dhe përputhje me udhëzimet e dhëna.

Neni 106

Kërkesat specifike të sigurisë për secilin nënsistem hekurudhor

1. Specifikacionet teknike për interoperabilitetn janë përgatitur dhe lëshuar në nivel të BE-së në mënyrë që të përgatitet Hapësira Unike Hekurudhore dhe si të tilla duhet të paraqesin bazën kryesore të sigurisë hekurudhore në Kosovë.
2. Për secilin nënsistem të definuar në këtë ligj, specifikacionet teknike të interoperabilitetn në Kosovë duhet të lëshohen nga ARH dhe duhet të i plotësojnë kërkesat esenciale e në veçanti kërkesat e sigurisë.

Neni 107

Përputhshmëria e të gjitha nënsistemeve hekurudhore me kërkesat e sigurisë të STI

Të gjitha nënsistemet hekurudhore, mjetet transportuese, instalimet, aparatet ndihmëse, pajisjet dhe shërbimet, duhet të përputhen me kërkesat e sigurisë të STN-së dhe rregullat nacionale të sigurisë. Këto kërkesa të sigurisë duhet të plotësohen gjatë ekzekutimit të aktiviteteve të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore dhe/ ose ndërmarrjes hekurudhore pavarësisht nga përgjegjësia e prodhuesit, mirëmbajtësit, pronarit, ofruesit të shërbimit dhe tregtuesit të nënsistemeve dhe komponentëve.

Neni 108

Autorizimi për vendosjen e përbërësve të interoperabilitetit në treg

1. Përbërësit e interoperabilitetn duhet të vendosen në treg vetëm nëse ata e mundësojnë interoperabilitetn i cili duhet të arrihet brenda sistemit hekurudhor përderisa në të njëjtën kohë përmbushin kërkesat e nevojshme dhe nëse janë të përdorura në zonat e tyre dhe janë të instaluar dhe të mirëmbajtura si duhet.
2. Përbërësit e interoperabilitetn, nëse marrim parasysh deklaratën e Komisionit Evropian të konformitetit apo përshtatjes duhet të konsiderohen si të përputhshme me kërkesat e definuara në këtë ligj
3. Që të merret kjo deklaratë e Komisionit Evropian mbi konformitetin apo përshtatjen për përdorim për përbërësit e interoperabilitetn të prodhuar në Kosovë, do të jetë e mundur nëse prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar i vendosur në Unionin Evropian aplikon për deklaratën e tillë duke provuar se përbërësit përputhen me dispozitat e parapara në Standardet Teknike për ndëroperim. Kur Standardi Teknik për ndëroperim kërkon ashtu, vlerësimi i konformitetit apo përshtatshmërisë për përdorimin e një përbërësi të interoperabilitetn duhet të

bëhet nga organi njoftues, prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar në Unionin Evropian të cilët e kanë paraqitur aplikimin.

4. Përbërësit e interoperabilitet mund të marrin deklaratën e Kosovës të konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorim nëse prodhuesit aplikojnë për deklaratën e tillë dhe pas vlerësimit të mundshëm të domosdoshëm nga organi nacional i akredituar mbi përputhshmërinë e përbërësve me specifikacionet teknike të interoperabilitet (STN), ashtu siç është paraqitur në legjislacionin Kosovar. Deklarata e tillë e konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorim, në mungesë të marrëveshjes me shtetet tjera, duhet të vlejë vetëm në Kosovë.

Neni 109

Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale në Kosovë

1. Për futjen në shërbim të secilit nënsistem të hekurudhave, menaxheri i infrastrukturës apo ndërmarrja hekurudhore duhet të marrin një autorizim nga organi përgjegjës mbi sigurinë.

2. Për ta marrë këtë autorizim për futjen në shërbim të një nënsistemi, aplikuesi duhet të dëshmojë që nënsistemi është i dizajnuar, ndërtuar dhe instaluar në mënyrë ashtu që t'i plotësojë kërkesat themelore kur të integrohet në sistemin hekurudhor. Në veçanti aplikuesi duhet të dëshmojë:

2.1. kompatibilitetin teknik të nënsistemit me sistemin në të cilin është integruar;

2.2. integrimin e sigurt të nënsistemit në sistemin hekurudhor;

2.3. përputhshmërinë e nënsistemit me dispozitat e specifikimeve teknike për ndëroperim mbi operimin dhe mirëmbajtjen.

3. Një nënsistem struktural do të konsiderohet si interoperabil dhe që i plotëson kërkesat esenciale të sigurisë, nëse është i mbuluar nga një deklaratë e verifikimit.

4. Deklarata e KE mbi verifikimin e nënsistemeve hekurudhore mund të jetë e vlefshme në Kosovë nëse është në pajtim me ligjet kosovare.

5. Detyra e organit nacional të akredituar, përgjegjës për verifikimin e këtij nënsistemi duhet të fillojë në fazën e dizajnit dhe të mbulojë kohën gjatë gjithë periudhës së prodhimit përmes fazës së pranimit para se nënsistemi të futet në shërbim. Ai po ashtu duhet ta mbulojë verifikimin e ndërlidhjes së nënsistemit me sistemin që inkorporohet.

6. Organi nacional i akredituar është përgjegjës për përmbledhjen e dokumentacionit teknik i cili duhet ta përcjellë deklaratën për verifikim. Ky dokumentacion teknik duhet t'i përmbajë të gjitha dokumentet e nevojshme lidhur me karakteristikat e nënsistemit dhe ku është nevoja të gjitha dokumentet që dëshmojnë konformitetin e përbërësve të interoperabilitet. Ai po ashtu duhet t'i përfshijë të gjitha elementet lidhur me gjendjen dhe limitet që i përkasin kryerjes së shërbimit, monitorimin e vazhdueshëm apo rutinor, përshtatjen dhe mirëmbajtjen.

7. Në rast të ripërtëritjes apo të ngritjes së një nënsistemi, njësia kontraktuese apo prodhuesi duhet të ia dërgojë organit nacional të sigurisë dokumentacionin në të cilin përshkruhet projekti. Pas ekzaminimit, do të vendoset nëse sasia e punës nënkupton që është fjala për një autorizim të ri për futje në shërbim.

8. Regjistri i infrastrukturës duhet të mbahet, të azhurnohet dhe të publikohet. Ky regjistër duhet t'i paraqesë karakteristikat kryesore të secilit nënsistem apo pjese të nënsistemit të përfshirë, si dhe korrelacionin e tyre me veçoritë e paraqitura në specifikimet teknike të aplikueshme të interoperabilitet. Kështu, secili specifikim teknik i interoperabilitet duhet të tregojë se çfarë informate duhet të përfshihet në regjistrin e infrastrukturës.

9. Në Kosovë, regjistri i infrastrukturës duhet të mbahet dhe të azhurnohet nga secili menaxher i infrastrukturës i vendosur në Kosovë nën mbikëqyrjen e ARH me kontributin e organit përgjegjës për sigurinë hekurudhore.

10. Akti nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49 duhet t'i përshkruaj procedurat, dokumentet dhe testet të cilat duhet të prezantohen në mënyrë që të merret një autorizim i tillë për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale hekurudhore në Kosovë.

Neni 110

Autorizimi për vendosjen e mjeteve të transportit në shërbim

1. Para se të përdoret në rrjet, mjete i transportit duhet të autorizohet që të futet në shërbim.

2. Mjetit të transportit për futje në shërbim duhet t'i jepet autorizimi nga organi përgjegjës për sigurinë hekurudhore, kur të gjitha nënsistemet strukturale të mjetit të transportit kanë qenë të autorizuar për futje në shërbim pas procedurave të vlerësimit dhe verifikimit të paraqitura në specifikimet teknike të interoperabilitet. ARH është përgjegjëse për dhënien e autorizimit për futjen në funksion të mjetit hekurudhor me kontributin e organit përgjegjës për sigurinë i cili është përgjegjës për kontrollin e pajtueshmërisë teknike ndërmjet nënsistemeve të mjeteve të transportit dhe integritit të sigurt të tyre, pajtueshmërinë teknike ndërmjet mjeteve të transportit dhe rrjetit dhe pajtueshmërinë teknike me rregullat tjera nacionale.

3. Mjetit të konfirmuar të transportit i cili e ka autorizimin, duhet t'i jepet autorizimi për futje në shërbim duke u bazuar në deklaratën e konformitetit mbi tipin pa kontrollime të mëtutjeshme.

4. Autorizimet për futjen e mjeteve të transportit në shërbim të lëshuar në Bashkimin Evropian dhe në shtetet tjera me të cilat Kosova ka marrëveshje të veçanta, duhet të konsiderohen si valide nëse janë në pajtueshmëri me legjislacionin e Kosovës.

5. Vendet të cilat kanë marrëveshje me Kosovën duhet ta njohin autorizimin për futje në shërbim të mjeteve të transportit të lëshuar nga organi përgjegjës për çështjet e sigurisë hekurudhore në Kosovë.

6. Në rast se organi përgjegjës për çështjet e sigurisë në Kosovë refuzon apo revokon një marrëveshje për ta futur në shërbim një mjet të transportit, vendimi duhet të jetë i vërtetuar në mënyrë të detajuar.

7. Një akt nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së 2004/49 dhe 2008/110 do të përshkruaj procedurat për autorizimet e para për futjen në shërbim të mjeteve të transportit konform apo jo konform specifikimeve teknike të interoperabilitetit, si dhe autorizimet dhe modelet shtesë të nevojshme të deklarimit të konformitetit të tipit.

8. Numri Nacional i Mjetit të Transportit dhe Numri Nacional i Regjistri të Mjetit të Transportit

8.1. çdo mjet i transportit i futur në shërbim në Kosovë duhet të ketë Numrin Nacional të Mjetit të Transportit të dhënë kur është lëshuar autorizimi për futjen në shërbim;

8.2. nëse mjeti i transportit është i autorizuar në BE, aplikuesi për autorizimin e parë duhet të jetë përgjegjës për shënimin e mjetit të transportit me Numrin Evropian të Mjetit të Transportit i cili duhet të njihet për përdorimin e mjeteve të transportit në Kosovë;

8.3. regjistri i mjeteve të transportit të autorizuara në Kosovë duhet të mbahet dhe të azhurnohet. Ky regjistër duhet të jetë në dispozicion të organit përgjegjës për çështje të sigurisë në Kosovë dhe të organit për hetime të aksidenteve. Ai po ashtu duhet të jetë në dispozicion për çfarëdo kërkesë legjitime të organeve të rregullimit të tregut, ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës, si dhe personave dhe organizatave të tjera;

8.4. regjistri duhet të ketë së paku informatat në vijim për secilin mjet të transportit të autorizuar në Kosovë:

8.4.1. numrin Nacional të Mjetit të Transportit;

8.4.2. referencën për deklaratën e verifikimit të organit që e ka lëshuar;

8.4.3. identifikimin e pronarit dhe mbajtësit të mjetit të transportit;

8.4.4. restriksionet se si një mjet i transportit duhet të përdoret;

8.4.5. entitetin përgjegjës për mirëmbajtje;

8.5. ARH do të jetë përgjegjëse për numërimin e vagonëve dhe mbajtjen e regjistrit për mjetet e transportit të futura në shërbim në Kosovë, së bashku me Autoritetin Nacional të Sigurisë.

Neni 111

Përputhshmëria e interoperabilitetit, autorizimet e sigurisë të menaxherëve të infrastrukturës dhe certifikatat e sigurisë të ndërmarrjeve hekurudhore

1. Pas marrjes së autorizimit për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturore, menaxheri i infrastrukturës duhet të jetë në gjendje të aplikojë për autorizimin e tij të sigurisë.
2. Pas marrjes së autorizimit për futjen e mjeteve të transportit në shërbim, ndërmarrjet hekurudhore do të duheshin të jenë në gjendje të aplikojnë për certifikatën e sigurisë.

Neni 112

Mirëmbajtja e mjeteve të transportit

1. Secili mjet i transportit para se të hyj në shërbim ose të përdoret në rrjet duhet të ketë një entitet të ngarkuar për mirëmbajtje dhe ky entitet duhet të jetë i regjistruar në regjistër të mjeteve të transportit të autorizuara në Kosovë.
2. Entitete të ngarkuara me mirëmbajtje të mjeteve të transportit mund të jenë ndërmarrja hekurudhore, menaxheri i infrastrukturës apo mbajtësi i këtyre mjeteve të transportit.
3. Ky entitet duhet të sigurojë që mjetet e transportit për të cilat ai është i ngarkuar t'i mirëmbajë të jenë në gjendje të sigurt dhe të lëvizin me mjetet e sistemit të mirëmbajtjes. Pra, entiteti i ngarkuar me mirëmbajtjen duhet të sigurojë që mjetet e transportit të jenë të mirëmbajtura në përputhje me:
 - 3.1. dokumentacionin e mirëmbajtjes për secilin mjet të transportit;
 - 3.2. kërkesat në fuqi, duke përfshirë rregullat e mirëmbajtjes dhe dispozitat e specifikimeve teknike të interoperabilitetit.
4. Entiteti përgjegjës për mirëmbajtje duhet ta kryej vet mirëmbajtjen apo t'i përdorë ndërmarrjet e kontraktuara për mirëmbajtje.
5. Në rastin e vagonëve për transportin e mallrave në Kosovë, secili entitet përgjegjës për mirëmbajtje duhet të jetë i certifikuar nga ARH (e Kosovës në bashkëpunim me Organin Përgjegjës për Çështje të Sigurisë)
6. ARH duhet ta mbajë regjistrin e entiteteve të vendosura në Kosovë të cilat janë të ngarkuara për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave.
7. ARH duhet të mbajë regjistrin e mbajtësve të vagonëve për vagonët e regjistruar në Kosovë dhe duhet të ketë kontaktet e domosdoshme lidhur me mbajtësit e vagonëve dhe entitetit i cili është i ngarkuar për mirëmbajtjen e vagonëve të cilët janë në operim në Kosovë.

KREU IX INTEROPERABILITET

Neni 113 Dispozitat e përgjithshme të interoperabilitetit

1. Ky ligj përcakton kushtet të cilat duhet t'i plotëson sistemi hekurudhor në Kosovë për të arritur interoperabilitetn me sistemin hekurudhor të BE-së në drejtim të krijimit të hapësirës të interoperabilitetit Evropiane, pjesë e së cilës dëshiron të jetë edhe Kosova. Kushtet në lidhje me interoperabilitetn përmbajnë dizajnin, rindërtimin, futjen në shërbim, modernizimin, përtëritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të sistemit e gjithashtu edhe kualifikimeve profesionale dhe kushtet e shëndetit dhe sigurisë së stafit i cili kontribuon për operimet dhe mirëmbajtjen e tij.

2. Ky ligj dhe dispozitat e tij mbi interoperabilitetn në Kosovë nuk aplikohet për:

2.1. ndërmarrjet hekurudhore që operojnë vetëm për shërbimet e udhëtarëve në rrjetet që janë funksionalisht të ndara nga pjesa tjetër e sistemit hekurudhor;

2.2. ndërmarrjet hekurudhore që operojnë vetëm për shërbimet e mallrave në infrastrukturën hekurudhore në pronësi private vetëm për nevojat e pronarit dhe për operimet e tij;

2.3. metronë, tramvajin dhe sistemet e tjera të lehta hekurudhore.

3. Ky ligj ka të bëjë me dispozitat për secilin nënsistem në lidhje me përbërësit e interoperabilitetit, ndërlidhjet dhe procedurat e gjithashtu kushtet e kompatibilitetit të përgjithshëm të sistemit hekurudhor për të arritur interoperabilitetn e vet.

4. Sistemi hekurudhor i Kosovës, nënsistemet dhe përbërësit e interoperabilitetit duke përfshirë ndërlidhjet, duhet t'i plotësojnë kërkesat esenciale relevante (sigurinë, besueshmërinë, disponueshmërinë, shëndetin, mbrojtjen e mjedisit dhe kompatibilitetin teknik), ashtu siç janë përcaktuar me rregulloret evropiane dhe të futura në rregulloret e Kosovës.

5. Akti nënligjor në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së 2008/57 duhet të përcaktojë mbajtjen e listës të nënsistemeve dhe ndërlidhësit të cilat e formojnë sistemin hekurudhor, si dhe kërkesat esenciale të cilat përdoren në legjislacionin e BE-së e të cilat duhet të përdoren në Kosovë.

Neni 114 Specifikacionet teknike të interoperabilitetit

1. Specifikacionet teknike për ndëroperim të aprovuara në Kosovë duhet të përfshinë të gjitha nënsistemet hekurudhore siç janë:

1.1. nënsistemet strukturore:

1.1.1. infrastruktura;

1.1.2. energjia;

1.1.3. komanda e kontrollit dhe sinjalizimi;

1.1.4. mjetet lëvizëse.

1.2. nënsistemet funksionale:

1.2.1. operimet e trafikut dhe menaxhmenti;

1.2.2. mirëmbajtja;

1.2.3. aplikimet nga distanca për shërbimet e pasagjerëve dhe mallrave.

2. Secili nënsistem hekurudhor duhet të jetë në përputhshmëri me specifikacionet teknike të interoperabilitet, kohën e futjes së tyre në shërbim, freskimin apo renovimin e tyre. Kjo përputhshmëri duhet të jetë në funksion përderisa secili nënsistem të jetë në përdorim.

3. Akti nënligjor në pajtim me parimet e Direktivës të BE-së 2008/57 duhet t'i përmban të gjitha specifikimet teknike të interoperabilitet të aprovuara në Kosovë me të gjitha përafrimet specifike të mundshme.

4. Specifikacionet teknike për ndëroperim nuk duhet me qenë pengesë e vendimeve të përdorimit të infrastrukturës për mjetet e transportit të cilat nuk janë të mbuluara me specifikacionet teknike për interoperabilitet.

Neni 115

Përbërësit e interoperabilitet të prodhuar në Kosovë dhe deklarata e përputhjes dhe përshtatshmërisë për përdorimin e tyre

1. Përbërësit e interoperabilitet futen në treg vetëm nëse e mundësojnë interoperabilitetn për t'u arritur brenda të njëjtës kohë duke plotësuar kërkesat esenciale. Nëse përbërësi i interoperabilitet përputhet me kërkesat esenciale, atëherë ai duhet të autorizohet për shfrytëzim në Kosovë në veçanti kur është kryer procedura e deklarimit të KE-së për përputhjen dhe përshtatshmërinë për shfrytëzim dhe kur përbërësi është në pajtim me rregulloret në Kosovë.

2. Të gjithë përbërësit e interoperabilitet duhet t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të përputhjes dhe përshtatshmërisë për shfrytëzim të treguar në specifikacionet teknike relevante për ndëroperim dhe duhet të shoqërohen nga certifikata relevante.

3. Në rastin e prodhuesit në Kosovë, i autorizuari i tij i vendosur në BE duhet të aplikoj dispozitat e paraqitura në specifikacionet teknike relevante për ndëroperim. Kur specifikacionet teknike të interoperabilitet korresponduese e kërkojnë këtë, atëherë vlerësimi i përputhjes apo përshtatjes për shfrytëzim të përbërësit të interoperabilitet duhet të kryhet nga entiteti i njoftues të cilit i ka bërë kërkesë përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit të vendosur në BE.

4. Kosova nuk duhet t'i ndaloj, kufizoj apo prapësoj vendosjen në treg të përbërësve të interoperabilitet të cilët e kanë deklaratën e KE-së për përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë për përdorim që janë në pajtim me legjislacionin kosovar.

5. Në rastin kur përbërësi i interoperabilitet prodhohet në Kosovë, është e mundur që të aplikohet për deklaratën e përputhshmërisë dhe përshtatshmërisë për përdorim në Kosovë. Vlerësimi i deklaratës nacionale të përputhshmërisë ose përshtatshmërisë duhet të bëhet nga organi i akredituar nacional. Deklarata e përputhjes apo përshtatshmërisë për përdorim duhet të jepet nga ARH.

Neni 116

Nënsistemet hekurudhore në Kosovë dhe futja e tyre në shërbim

1. Të gjitha nënsistemet që e përbëjnë sistemin hekurudhor duhet të marrin autorizimin për futje në shërbim nëse ato janë të vendosura në Kosovë.

2. Nënsistemet mund të futen në shërbim vetëm nëse ato janë të dizajnuara, ndërtuara dhe instaluar në atë mënyrë që plotësojnë kërkesat esenciale në mënyrë të veçantë përputhshmërinë e tyre teknike me sistemin në të cilin ato do të integrohen dhe me integrimin e tyre të sigurt.

3. Nënsistemet mund të futen në shërbim vetëm nëse ato përputhen me dispozitat relevante të specifikacioneve teknike të interoperabilitet për operim dhe mirëmbajtje, ashtu siç është e miratuar në Kosovë.

4. Pas futjes së nënsistemeve në shërbim në Kosovë, atëherë duhet të kryhet kontrolli:

4.1. infrastrukturës në lidhje me dhënien dhe mbikëqyrjen e autorizimit të sigurisë;

4.2. për mjetet e transportit në lidhje me dhënien dhe mbikëqyrjen e certifikatës së sigurisë;

4.3. për këtë qëllim duhet të shfrytëzohen procedurat e vlerësimit dhe verifikimit të paraqitura në specifikacionet teknike të interoperabilitet për strukturën relevante dhe funksionale.

5. Nënsistemet strukturale të mbuluara me deklarin KE-së të verifikimit duhet të konsiderohen ndëroperative në Kosovë dhe të i plotësojnë kërkesat esenciale përkatëse sipas legjislacionit përkatës në Kosovë.

6. Duke u bazuar në këtë ligj, Kosova në territorin e saj nuk mundet të ndaloj, kufizoj, apo prapësoj ndërtimin, futjen në shërbim dhe operimin e nënsistemeve strukturale të cilat e përbëjnë sistemin hekurudhor i cili i plotëson kërkesat esenciale ashtu siç është përafuar me legjislacionin në Kosovë. Në veçanti nuk do të bëhen kontrollimet të cilat veçse janë bërë më parë qoftë si pjesë e procedurave të deklaratës së verifikimit të BE-së, qoftë nëse kjo është realizuar në vendet tjera në pikëpamje të verifikimit të pajtueshmërisë me kërkesat identike nën kushtet identike operacionale që ofrojnë marrëveshjet specifike bilaterale.

7. Entiteti legal i cili dëshiron t'i fus në shërbim dhe operim nënsistemet strukturale në Kosovë, e ka të drejtën e ankesës te ARH nëse ndihet se i është ndaluar, kufizuar apo prapësuar ndërtimi, futja në shërbim dhe operim e sistemeve nënstrukturale.

Neni 117

Organi hekurudhor i ngarkuar për çështje të interoperabilitet

ARH duhet të jetë përgjegjëse për të gjitha pyetjet, vlerësimet dhe analizat e interoperabilitet në Kosovë. Ajo duhet të ndërlidhet edhe me organet tjera të ngarkuara për ndëroperim të BE-së dhe të vendeve tjera në kuadër të marrëveshjes së traktatit të transportit të SEETO-s, duke përfshirë organet njoftuese të vendosura në BE dhe që punojnë për aplikuesit e vendosur në Kosovë dhe përfaqësuesit e tyre të vendosur në BE.

KREU X

MODERNIZIMI DHE NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE

NËNKREU I

Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe pajisjeve hekurudhore

Neni 118

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës hekurudhore

1. Infrastruktura hekurudhore përbëhet nga shtresa e poshtme dhe shtresa e epërme e hekurudhës me strukturat hekurudhore (urat, tunelet, lëshesat, muret mbajtëse etj.); pajisjet hekurudhore, sipërfaqja hekurudhore dhe hapësira ajrore mbi hekurudhë.

2. Infrastruktura hekurudhore sipas qëllimit dhe vëllimit të trafikut, rëndësisë ekonomike apo rëndësisë për trafikun vendor dhe atë ndërkombëtar duhet të ndahet në infrastrukturën kryesore hekurudhore dhe infrastrukturat e tjera hekurudhore.

3. Menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet ta themelojnë dhe ta mbajnë të freskuar regjistrin e infrastrukturës që të ofron të dhëna teknike për tërë objektet që e përbëjnë infrastrukturën.
4. Menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të përgatisin planet e biznesit dhe dokumentet e strategjisë afatmesme dhe afatgjatë të cilat duhet të diskutohen me ministrinë kompetente për çështjet hekurudhore si autoritet kompetent dhe të merren parasysh për kontratat të cilat duhet të negociohen ndërmjet menaxherëve të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët dhe autoriteteve kompetente.
5. Qeveria e Kosovës duhet të siguroj që menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët të kenë burime financiare të cilat përputhen me detyrat e tyre.
6. Qeveria e Kosovës duhet të siguroj që infrastruktura e saj hekurudhore e shfrytëzimit të përbashkët do të zhvillohet duke pasur parasysh nevojat e komunitetit të vendeve të zonës së Ballkanit Jug Lindor dhe nevojat e BE-së.
7. Organi Rregullativ për Tregun Hekurudhor duhet të ketë detyrë të vlerësoj përshtatjen e buxhetit afatmesëm dhe afatgjatë me qëllimet e performancës për periudhën e caktuar.

Neni 119

Ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore

1. Ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore në kuadër të kuptimit të këtij ligji duhet të nënkuptoj ndërtimin e hekurudhës së re në një linjë të re, pajisjet elektrike dhe të komunikimit, sinjalizimit dhe sigurisë, manovrimin elektrik në binarë, energjinë elektrike dhe pajisjet dhe aparaturat tjera, ndërtesat dhe strukturat në hekurudhën e re apo në hekurudhën ekzistuese.
2. Dispozitat e këtij ligji të cilat e rregullojnë ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore duhet gjithashtu të aplikohen për rindërtimin e infrastrukturës hekurudhore.
3. Infrastruktura hekurudhore duhet të dizajnohet, ndërtohet, rindërtohet, riparohet, pajiset dhe mirëmbahet për t'i shërbyer qëllimit të saj sipas nevojave për sigurinë e trafikut, mjedisit dhe mbrojtjes së natyrës në përputhje me këtë ligj dhe me rregulloret e tjera e gjithashtu edhe me kapacitetin e përcaktuar të hekurudhës, shpejtësitë e trenave, shtypjes boshtore dhe peshës së vagonëve të mallrave për metër gjatësi dhe me normat e standardet e përshtuara nga ministria kompetente për çështje të hekurudhës në përputhje me specifikacionet teknike të interoperabilitetit, standardet e UIC dhe normat dhe standardet e tjera ekzistuese.
4. Hekurudhat që shërbejnë për trafikun ndërkombëtar hekurudhor, duhet t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë obligative për Kosovën.

Neni 120

Punët për ndërtimin, modernizimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore brenda brezit të infrastrukturës hekurudhore

1. Ndërtimi, modernizimi dhe punët e riparimit në infrastrukturën hekurudhore duhet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik të ofruar që plotëson normat dhe standardet e kërkuara.
2. Në rastin e riparimit kapital, nënkuptohet zëvendësimi i shtresës së epërme të infrastrukturës hekurudhore (shinat, pajisjet e gjerësisë, ndërrueseve, pastrimi dhe mbushja me balast), restaurimi i shtresës së poshtme dhe elementeve të saj në infrastrukturën ekzistuese hekurudhore sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera.
3. Entiteti ligjor që mban licencën për korigjimin e dokumentacionit të dizajnit sipas Ligjit për Ndërtim në Kosovë duhet të miratoj dokumentacionin teknik për ndërtimin dhe modernizimin si dhe riparimin kapital të infrastrukturës hekurudhore.
4. Metoda dhe dinamika e riparimit kapital të infrastrukturës hekurudhore duhet të përcaktohet nga menaxheri i saj.

Neni 121

Siguria hekurudhore gjatë ndërtimit, modernizimit dhe punëve të riparimit kapital

1. Entitetet ligjore që ndërtojnë apo rindërtojnë infrastrukturën hekurudhore, ndërtesat dhe depot, janë të obliguara që në dizajnet e tyre për ndërtim dhe rindërtim të ofrojnë zgjidhje për trafikun.
2. Entitetet ligjore që kryejnë riparimin kapital të infrastrukturës hekurudhore janë të obliguara të kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrën e cila ofron trafik të sigurt hekurudhor.
3. Pas kryerjes së punëve, entitetet ligjore të theksuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni janë të obliguara që të largojnë materialin e mbetur, mjetet, shenjat lajmëruese dhe objektet e tjera në mënyrë që të ofrohet trafik i sigurt nga infrastruktura hekurudhore dhe brezi i infrastrukturës hekurudhore.
4. Gjatë mirëmbajtjes dhe rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore kujdes të veçantë duhet t'i jepet eliminimit të defekteve në infrastrukturën hekurudhore si rezultat i të cilave mund të ndodhin në disa vende aksidente, aksidente serioze apo incidente.
5. Menaxheri i infrastrukturës duhet të përshkruaj metodën dhe elementet teknike për trafik të sigurt hekurudhor gjatë rindërtimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore.
6. Menaxheri i infrastrukturës duhet ta informojë organin përgjegjës për sigurinë e hekurudhave ose NSO për të gjitha modifikimet që mund të kenë ndikime në sigurinë hekurudhore në lidhje me rindërtimin dhe punëve të tjera në infrastrukturën hekurudhore që ai menagjon.

Neni 122
Pasojat e punës në infrastrukturën hekurudhore

1. Nëse një pjesë e infrastrukturës hekurudhore duhet të dislokohe për shkak të ndërtimit të një strukture të re (rrugë publike, aeroport, rezervar, strukturave energjetike, miniera etj) pjesa e infrastrukturës hekurudhore e cila duhet të dislokohe duhet të jetë e ndërtuar nga elementet që janë të përshtatshëm për atë kategori të infrastrukturës hekurudhore pavarësisht nga kushtet aktuale para dislokimit.
2. Shpenzimet për dislokim të infrastrukturës hekurudhore nga paragrafi 1. i këtij neni duhet t'i mbajë investitori i strukturës për shkak të së cilës zhvendoset infrastruktura hekurudhore.

NËNKREU II
Financimi i infrastrukturës hekurudhore

Neni 123
Përgjegjësia e shtetit

1. Infrastruktura hekurudhore në pronësi të shtetit duhet të menaxhohet në mënyrë autonome sipas parimeve komerciale. Interesi që ka shteti për infrastrukturën hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët si mjet për optimizimin e ekonomisë apo në lidhje me përmirësimin e kushteve mjedisore dhe të mirëqenies së popullatës së Kosovës, duhet të merret parasysh me procedurat dhe instrumentet e ndryshme të dhëna në këtë ligj.
2. E tërë kostoja e infrastrukturës hekurudhore në parim do të mbulohet nga të hyrat nga pagesa e shfrytëzimit të infrastrukturës dhe nga të hyrat tjera të menaxherit të infrastrukturës përveç nëse përcaktohet ndryshe.
3. Kostot e infrastrukturës që dalin nga investimet, mirëmbajtja dhe operimi dhe që nuk janë në interes komercial të menaxherit të infrastrukturës, duhet të mbulohen nga buxheti nacional. Nëse investimet, mirëmbajtja dhe operimet janë pjesërisht në interes komercial të menaxherit të infrastrukturës, ai duhet të merr pjesë në mbulimin e kostos përkatëse.
4. Në rast të investimit të rëndësishëm në infrastrukturë apo mirëmbajtjes së pakryer në kohën kur ky ligj hyn në fuqi, apo në mënyrë që të merren parasysh përparësitë mjedisore të transportit hekurudhor, atëherë kontributet përkatëse financiare mund të ndahen nga buxheti nacional.
5. Kostot të cilat dalin nga investimet, mirëmbajtja dhe operimet në lidhje me infrastrukturën e rëndësishme plotësisht të pajustificueshme do të mbulohen nga buxheti nacional.

6. Shpenzimet e menaxherit të infrastrukturës hekurudhore për mirëmbajtje dhe operim të vendkalimeve hekurudhore në nivel do të mbulohen nga entitetet përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës e cila kryqëzohet me linjën hekurudhore.

7. Autoritetet lokale dhe/ ose regjionale e gjithashtu edhe burimet e tjera mund të kontribuojnë në mbulimin e kostove të infrastrukturës hekurudhore.

Neni 124

Kushtet dhe procedurat e financimit

1. Fondet për financimin e ndërtimit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët duhet të jepen nga burime të ndryshme:

1.1. buxheti i Kosovës;

1.2. kreditë dhe huat; dhe

1.3. burimet e tjera, siç janë grantet, partneriteti publiko privat apo investimet private.

2. Shumat e ndara për financimin e obligimeve të referuara në këtë ligj për infrastrukturën hekurudhore, duhet të specifikohen me kontratën e nënshkruar ndërmjet secilit menaxher të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe autoriteteve kompetente të cilat kontrata duhet të jenë për periudhën pesëvjeçare kur edhe do të bëhet rishikimi i tyre.

3. Shumat e përmendura duhet të bazohen në programin investiv pesëvjeçar multimodal të qeverisë të miratuar nga qeveria dhe i specifikuar në kontratën pesë (5) vjeçare të nënshkruar ndërmjet ministrit të ministrisë, ministrit për çështje financiare dhe menaxherit të infrastrukturës. Kjo kontratë duhet në veçanti të përmbaj:

3.1. planin investiv të menaxherit të infrastrukturës;

3.2. listën e detyrave investuese;

3.3. listën e fondeve të cilat duhet të ndahen për detyrat e veçanta;

3.4. garancionet shtetërore në lidhje me sigurimin e fondeve investive;

3.5. parametrat e synuar të performancës të cilët duhet të arrihen nga menaxheri i infrastrukturës;

3.6. stimulimet e zvogëlimit të kostos;

3.7. mënyrat e zgjidhjes së konflikteve nga një entitet neutral i arbitrazhës.

4. Në kuadër të politikës së përgjithshme të përcaktuar nga shteti, menaxheri i infrastrukturës përpilon planin e biznesit i cili përfshinë investimet dhe masat tjera financiare. Plani duhet të dizajnohet për të siguruar shfrytëzim optimal dhe efikas, zhvillim të infrastrukturës dhe balancim financiar, si dhe të ofroj mjetet me të cilat do të arrihen këto objektiva. Plani i biznesit duhet t'i dërgohet për miratim Ministrisë përkatëse e cila bënë ushtrimin e të drejtave pronësore dhe Ministrisë të Financave.

NËNKREU III

Koncesioni për ndërtimin, modernizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin

Neni 125 Koncesioni

1. Koncesioni mund të jepet për qëllimet në vazhdim:

1.1. ndërtimin e infrastrukturës së re hekurudhore;

1.2. menaxhimin e një pjese apo të tërë të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët sipas këtij ligji.

2. Procedura e dhënies së koncesionit e paraqitur në këtë nen duhet të zbatohet në përputhje me ligjin në fuqi si dhe format tjera të partneritetit publiko- privat.

Neni 126

Koncesioni për ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore

1. Koncesioni për ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore duhet të jepet për periudhën kohore që nuk është më e gjatë se njëzet (20) vite nga dita kur është dhënë koncesioni.

2. Koncesionari nëse e fiton të drejtën, duhet të obligohet që të dizajnoj, ndërtoj dhe të vendos në operim linjën hekurudhore apo ndonjë strukturë tjetër të hekurudhës, ta shfrytëzoj atë në përputhje me rregulloret, normat dhe standardet e këtij lloji të strukturave në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe normat mbi specifikacionet teknike të interoperabilitetit.

Neni 127

Koncesioni për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore

1. Koncesioni për menaxhimin e një pjese të infrastrukturës hekurudhore nëse arrihet vendimmarrje për këtë, jepet nga autoritetet përgjegjëse në përputhje me procedurat e parapara me ligjin në fuqi, si dhe format tjera të partneritetit publiko- privat.

2. Koncesioni mund t'i jepet një entiteti të brendshëm apo të jashtëm (koncesionari) i cili ka kapital dhe staf si dhe pajisje për një performancë të suksesshme të punëve të cilat i nënshtrohen koncesionit.

3. Në mënyrë që të jetë në gjendje për të marrë koncesionin e paraqitur në këtë ligj, aplikuesi për koncesion duhet të posedoj licencë për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore dhe të aplikoj për autorizim të sigurisë.

4. Koncesioni për menaxhimin e një pjese të infrastrukturës duhet të jepet për një periudhë kohore e cila nuk është më e gjatë se njëzet (20) vite nga dita e dhënies së koncesionit.

NËNKREU IV **Mbrojtja dhe shpronësimi**

Neni 128 **Mbrojtja e infrastrukturës hekurudhore**

1. Punët e mbrojtjes në infrastrukturën hekurudhore, pajisjeve, aparateve, ndërtesave, stabilimenteve dhe punët e tjera mbrojtëse duhet të bëhen nga menaxheri i infrastrukturës.

2. Punët mbrojtëse në kuadër të kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni duhet të përfshijnë masat për parandalimin e aktiviteteve të ndaluara në infrastrukturën hekurudhore. Kjo duhet gjithashtu të përfshijë inicimin e procedurës në gjykatën kompetente për të rimarrë tokën e okupuar në mënyrë jo ligjore nga hapësira e infrastrukturës hekurudhore.

3. Administrata e autoritetit kompetent që merret me çështjet e brendshme duhet të informohet për aktivitetet ilegale në infrastrukturën hekurudhore dhe brezin e saj mbrojtës.

4. Kundërvajtësi i aktiviteteve ilegale me urdhër të Administratorit duhet të obligohet që t'i largoj menjëherë pasojat e veprimeve të veta jo ligjore.

5. Nëse kundërvajtësi dështon t'i largoj pasojat e veprimeve ilegale, atëherë menaxheri i infrastrukturës do t'i largoj ato, kurse shpenzimet e largimit do të mbulohen nga kundërvajtësi.

6. Përshkrimi më i mirë i metodave për mbrojtje të infrastrukturës hekurudhore duhet të përshkruhet nga Ministria kompetente për çështjet hekurudhore.

7. Kabllot telefonike, telegrafike, gypat e kabllove, kabllot e tensionit elektrik, gypat e ujërave të zeza, gypat e furnizimit me ujë etj, mund të instalohen në brezin e infrastrukturës hekurudhore me kërkesë të dorëzuar nga entiteti ligjor apo individ i nën kushtet dhe mënyrën e përshkruar nga menaxheri i infrastrukturës.

8. Aplikuesi duhet t'i mbuloj shpenzimet e përcaktuara në paragrafin 7. të këtij neni.
9. Menaxheri i infrastrukturës mund të kërkoj nga pronari i instalimeve dhe pajisjeve të theksuara në paragrafin 7. të këtij neni që t'i rirregulloj apo zhvendos ato nëse është e domosdoshme për renovimin, rindërtimin apo riparimin kapital të infrastrukturës hekurudhore në mënyrë që t'i zbatoj masat për mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore dhe të trafikut hekurudhor.
10. Në këtë rast shpenzimet për rirregullim apo dislokim të instalimeve duhet të mbulohen nga menaxheri i infrastrukturës.
11. Menaxheri i infrastrukturës mund të refuzoj miratimin e aplikimit ashtu siç është theksuar në paragrafin 7. të këtij neni nëse instalimi i tyre do të dëmtonte infrastrukturën hekurudhore apo do të rrezikonte sigurinë e trafikut hekurudhor, nëse instalimet kanë ndikim në mirëmbajtjen hekurudhore apo do të mund të parandalojnë rindërtimin e saj.
12. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore në vendet ku rrëshqet terreni, ku ka përrenj, vendet që i ekspozohen erozionit të lumit dhe vendet ku ka erëra të fuqishme, ku do të mund të rrezikohet trafiku hekurudhor, pavarësisht apo së bashku me entitetin tjetër ligjor do të ndërmerr me kohë veprim, masa të domosdoshme për mbrojtje teknike dhe fizike të hekurudhës dhe strukturave në hekurudhë kundër fatkeqësive elementare në mënyrë që të ofrojë trafik të sigurt hekurudhor.
13. Menaxheri i infrastrukturës hekurudhore në rastet e paraqitura në paragrafin 1. të këtij neni ka të drejt që pa ndonjë miratim t'i vendos dhe mirëmbaj pajisjet mbrojtëse të përkohshme për të ruajtur materialet dhe mjetet e tjera brenda hapësirës mbrojtëse nëse ai e konsideron të domosdoshme se me ndërmarrjen e këtyre masave siguron trafik të sigurt hekurudhor apo do të vendosë trafikun hekurudhor.
14. Kur rrethanat e paraqitura në paragrafin 12. të këtij neni pushojnë së ekzistuari, atëherë menaxheri i infrastrukturës hekurudhore duhet të largoj nga hapësira mbrojtëse aparatet e përkohshme të mbrojtjes, materialin dhe mjetet e tjera që janë lënë aty gjatë ndërmarrjes së masave për trafik të sigurt hekurudhor, vendosjen e trafikut hekurudhor apo ta kthej terrenin në gjendjen që ka qenë dhe të paguaj tarifën për shfrytëzimin e tokës.

Neni 129

Ndërtimi afër infrastrukturës hekurudhore

1. Ndërtesat dhe strukturat e tjera, uzinat dhe stabilimentet mund të vendosen në brezin mbrojtës të hekurudhës bazuar në miratimin sipas kushteve të dhëna në vazhdim:
 - 1.1. në vendbanime, male, terrene me baltë dhe vende të tjera ku kërkojnë kushtet fushore, mund të miratohet dhe lejohet hapja e minierave, gurorëve, ndërtimi i tullave dhe gëlqeres, ndërtimi i ndërtesave industriale apo strukturave të ngjashme në brezin mbrojtës afër hekurudhës nëse toka ku do të vendosen ato është terren i përcaktuar nga

autoritetet komunale për ndërtimin e strukturave dhe uzinave por kjo nuk mund të jetë më afër se pesëdhjetë (50) metra nga aksi i binarit të fundit anësor;

1.2. ndërtimi i shtëpive, bizneseve, ndërtesave ndihmese dhe të ngjashme, gërmimi i puseve, rezervarëve, gropave septike, ndërtimi i linjave të gjata elektrike, etj. mund të miratohet në vendbanime dhe tokën ashtu si thuhet në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi por jo më afër se njëzetepesë (25) metra nga aksi i binarit të fundit anësor;

1.3. shenjat dhe billboardet mund të vendosen në brezin mbrojtës të paktën shtatë metra nga pika e fundme e hapësirës hekurudhore;

1.4. nëse për shkak të ndërtimit të një strukture apo për shkak të mirëmbajtjes së saj (rrugë publike, aeroport, rezervar, strukturë e rrymës, minierë, etj.), një pjesë e aseteve hekurudhore është dëmtuar, atëherë kjo pjesë e aseteve të hekurudhës që është dëmtuar duhet të riparohet në bazë të normave dhe standardeve ekzistuese për llojin e aseteve hekurudhore pa marr parasysh gjendjen aktuale para dëmtimit. Në këtë rast shpenzimet për riparim të aseteve të dëmtuara hekurudhore duhet t'i bartë investitori i strukturës së re apo të mirëmbajtjes së saj.

KREU XI

SHËRBIMET ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK

Neni 130

Kontratat e shërbimit publik

1. Shërbimi hekurudhor në interes publik mund të blihet në çdo kohë nga autoritetet publike kompetente prej ndërmarrjeve hekurudhore në kornizat e kontratave të arritura ndërmjet autoriteteve të autorizuar dhe ndërmarrjeve hekurudhore.

2. Autoriteti kompetent publik për dhënien e kontratave të shërbimeve publike, mund të jetë shteti, autoriteti publik lokal ose rajonal.

3. Kontratat e shërbimit publik ndërmjet autoritetit kompetent dhe ofruesit të shërbimeve duhet të përmbajnë të paktën pikat në vazhdim:

3.1. natyrën e shërbimit i cili duhet të ofrohet, veçmas standardet e vazhdimësisë, rregullsinë, kapacitetin dhe kualitetin;

3.2. çmimin e shërbimeve të mbuluara me kontratë dhe gjithashtu detajet për raportin financiar ndërmjet dy palëve në mënyrë të veçantë afatin e fundit të pagesës;

3.3. rregullat në lidhje me korrigjimet dhe modifikimet e kontratës veçmas duhet të merren parasysh ndryshimet e pa parashikuara të situatës së biznesit;

- 3.4. kohëzgjatja e vlefshmërisë së kontratës;
 - 3.5. gjobat në rast të dështimit të zbatimit të kontratës;
 - 3.6. procedurat e zgjidhjes së çështjeve gjyqësore.
4. Kohëzgjatja e kontratës së shërbimit publik duhet të jetë nga tri (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite varësisht nga koha e amortizimit të mjeteve lëvizëse të siguruara nga ndërmarrja hekurudhore.
 5. Shuma e pagesës për shërbimet e ofruara duhet t'i mbuloj kostot e llogaritura përfshirë këtu margjinën e arsyeshme të fitimit të definuar me aktin nënligjor në pajtim me Direktivën e BE-së nr. 1370-2007.
 6. Pagesa duhet të bëhet nga buxheti i autoritetit që ka kontraktuar performimin e shërbimeve të transportit me ndërmarrjen hekurudhore.
 7. Pagesa duhet të bëhet me vendim dhe paraprakisht.

Neni 131

Llogaria e ndarë për shërbimet publike të financuara nga publiku

Ndërmarrja hekurudhore e cila kryen shërbime në interes të publikut duhet të ketë llogari të veçantë për ato shërbime dhe nuk i lejohet alokimi i fondeve publike të pranuar si pagesë për aktivitetet tjera nga ato shërbime përveç një profiti marginal të fituar.

Neni 132

Procedura e tenderimit dhe obligimi i pagesës

1. Qeveria duhet me vendim të rregulloj procedurën e tenderimit për zgjedhjen e ndërmarrjeve që kryejnë shërbimet në interes publik.
2. Përcaktimi i shumës së pagesës në buxhet të autoritetit komisionues nuk duhet të ketë ndikim në obligimin e pagesës të autoritetit si palë e kontratës.

Neni 133

Zbritja e tarifave

1. Zbritja e tarifave si formë nga tarifat maksimale për të gjithë udhëtarët apo për disa kategori të udhëtarëve mund të pajtohen ndërmjet ndërmarrjeve hekurudhore dhe autoriteteve komisionuese.

2. Pagesa duhet të bëhet nga buxheti i autoritetit që ka kontraktuar zbritjen e tarifave tek ndërmarrja hekurudhore.

3. Marrëveshja e përmendur në këtë ligj duhet të theksoj kategorinë e konsumatorëve që gëzojnë zbritjen e tarifave, kategoritë përkatëse të shërbimeve dhe përqindjen e zbritjes. Ajo duhet të përmbaj dispozitat e korigjimeve në kontratë dhe pasojat e mosplotësimit të obligimeve të kontratës duke përfshirë gjokat në rast të dështimit të realizimit të kontratës. Kontrata duhet të përfshijë afatin dhe kushtet e pagesës.

Neni 134

Transferimi i përgjegjësive të komisionimit

Kuvendi apo Qeveria e Kosovës e autorizuar nga Kuvendi mund t'i delegojnë përgjegjësitë në fushën e komisionimit të shërbimeve publike tek autoritetet lokale apo regjionale vetëm nëse ato sigurojnë transferim të fondeve të domosdoshme nga buxheti i shtetit.

KREU XII

SEKTORI HEKURUDHOR DHE NDIHMA E SHITETIT

Neni 135

Subvencionet

Sektori hekurudhor në Kosovë mund të merr paratë publike, atëherë kur ato kontribuojnë në interes të përbashkët të shoqërisë dhe se marrja e këtyre parave publike nuk do ta çrregulloj konkurrencën në sektorin hekurudhor.

Neni 136

Ndërprerja e subvencioneve

Financimi publik i infrastrukturës hekurudhore nuk do të jetë i nevojshëm kur infrastruktura hekurudhore të hapet për të gjithë shfrytëzuesit potencial në mënyrë fer dhe jodiskriminuese, ndërsa qasja në këtë infrastrukturë të paguhet sipas çmimit të përcaktuar në përputhshmëri me këtë ligj.

Neni 137

Blerja dhe renovimi i mjeteve lëvizëse

Blerja dhe renovimi i mjeteve lëvizëse mund të financohet nga paraja publike duke i përdorur këto si mjete lëvizëse për shërbimet periferike dhe rajonale të transportit të udhëtarëve, të përdorura në linjat specifike, që plotësojnë standardet e fundit të interoperabilitetit, sigurisë, dhe

ambientit, të përshkruara në këtë ligji dhe të cilat kontribuojnë në zhvillimin koherent të strategjisë rajonale.

Neni 138
Ndihma për koordinimet e transportit

Paratë për koordinimin e transportit është e mundur që ta drejtojnë zhvillimin e transportit hekurudhor në interes të përbashkët. Mund ta ndihmojnë çështjen e shfrytëzimit të infrastrukturës duke zvogëluar kostot e jashtme dhe interoperabilitetn. Me ofrimin e këtyre ndihmave, ndihma për hulumtim dhe zhvillim nuk duhet të çrregulloj konkurrencën.

Neni 139
Ndihma shtetërore

Garancionet e shtetit për ndërmarrjet hekurudhore duhet të konsiderohen si ndihma shtetërore dhe si të tilla nuk duhet të jepen.

KREU XIII
TË DREJTAT E UDHËTARËVE

Neni 140
Të drejtat e udhëtarëve

Të drejtat e udhëtarëve definoen në lidhje me komponentët në vazhdim të shërbimeve të transportit, të ofruara nga ndërmarrja hekurudhore e cila mban licencë për transportet e tilla.

1. Kontrata e transportit, informacioni dhe biletat:

1.1. konkluzionet dhe performanca e një kontrate të transportit, dispozitat e informacioneve dhe biletave duhet të udhëhiqen sipas aktit nënligjor në pajtim me rregulloren 1371/2007/EC;

1.2. ndërmarrjet hekurudhore duhet të u mundësojnë udhëtareve të sjellin biçikletat në tren me një pagesë të përshtatshme nëse ato mund të përdoren lehtë dhe nëse ato nuk kanë efekt negativ për shërbimin e specifikuar hekurudhor dhe nëse këtë e lejojnë mjetet lëvizëse hekurudhore;

1.3. ndërmarrjet hekurudhore apo kur është e përshtatshme autoritetet kompetente përgjegjëse për kontratat e shërbimeve publike hekurudhore, me mjetet e përshtatshme duhet të bëjnë publike dhe para zbatimit të tyre, vendimet për mos vazhdimin e shërbimeve.

1.4. informacioni:

1.4.1. ndërmarrjet hekurudhore dhe shitësit e biletave që ofrojnë kontrata të transportit në emër të një apo më shumë ndërmarrjeve hekurudhore duhet të u ofrojnë udhëtarëve me kërkesë të tyre së paku informatën sipas aktit nënligjor në pajtim me rregulloren 1371/2007/ të BE-së e cila ka të bëjë me udhëtimet për të cilat është ofruar kontrata e transportit në llogari të ndërmarrjes hekurudhore. Shitësit e biletave të cilët ofrojnë kontratat e transportit dhe operatorët e udhëtimeve duhet të ofrojnë këtë informacion në llogari të tyre kurdo që e kanë në dispozicion;

1.4.2. ndërmarrjet hekurudhore duhet të u ofrojnë udhëtarëve gjatë udhëtimit të paktën informacionin e dhënë në aktin nënligjor në pajtim me Rregulloren 1371/2007/EC;

1.4.3. informacioni duhet të ofrohet në formatin më të përshtatshëm;

1.4.4. vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojave të njerëzve që kanë probleme me dëgjim dhe me pamje.

1.5. sigurimi i biletave përmes biletave dhe rezervimeve:

1.5.1. ndërmarrjet hekurudhore dhe shitësit e biletave duhet të ofrojnë biletat kur janë në dispozicion përmes biletave dhe rezervimeve;

1.5.2. ndërmarrjet hekurudhore duhet t'i shpërndajnë biletat për udhëtarët përmes të paktën një pike shitëse si në vazhdim:

1.5.2.1. zyra të biletave apo makinave shitëse;

1.5.2.2. telefonit, internetit apo informacionit tjetër të gjerë në dispozicion të teknologjisë informative;

1.5.2.3. në bord të trenit.

1.5.3. ndërmarrjet hekurudhore duhet që të ofrojnë mundësinë e distribuimit të biletave për shërbimet e ofruara sipas kontratave të shërbimeve publike së paku në njërin nga pikat vijuese të shitjes:

1.5.3.1. zyra të biletave apo makinave shitëse;

1.5.3.2. në bord të trenit.

1.5.4. ndërmarrjet hekurudhore duhet të ofrojnë mundësinë e marrjes së biletave për shërbimin përkatës në bordin e trenit përveç nëse kjo është e

kufizuar apo e mohuar mbi bazat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe politikën kundër mashtrimeve apo rezervimet e detyrueshme të trenit, apo mbi baza të arsyeshme komerciale;

1.5.5. kur nuk ekziston zyre për bileta apo makinë e shitjes së biletave në stacionin e nisjes, udhëtari duhet të informohet në stacion:

1.5.5.1. për mundësinë e blerjes së biletave përmes telefonit apo internetit apo në bordin e trenit, si dhe për procedurën e blerjes së tillë;

1.5.5.2. për stacionin më të afërt hekurudhor apo vendin ku ka në dispozicion zyra të biletave apo/ ose makina për shitje të biletave.

1.6. ndërmarrjet hekurudhore dhe shitësit e biletave duhet ta bëjë të mundur shfrytëzimin e sistemit të kompjuterizuar të informacionit dhe të rezervimit për transport hekurudhor (CIRSRT).

2. Përgjegjësia e ndërmarrjeve hekurudhore ndaj udhëtarëve dhe bagazhit të tyre.

2.1. përgjegjësia e ndërmarrjeve hekurudhore në lidhje me udhëtarët dhe bagazhin e tyre duhet rregullohet me aktin nënligjor në pajtim me Rregulloren 1371/2007/EC dhe COTIF-in;

2.2. ndërmarrjet hekurudhore duhet të jenë të siguruara apo të kenë aranzhime ekuivalente për të mbuluar përgjegjësitë për udhëtarët;

2.3. nëse udhëtari vdes apo lëndohet, atëherë ndërmarrja hekurudhore duhet që pa vonesë dhe në çdo rast jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pasi të jetë vendosur identiteti i personit fizik që ka të drejt në kompensim të bëjë pagesën e avansit ashtu sikurse kërkohet për të plotësuar nevojat e menjëhershme ekonomike mbi bazën proporcionale të dëmit të shkaktuar;

2.4. pagesa e avansit nuk duhet të nënkuptoj njohjen e përgjegjësisë dhe mund të jetë vetëm nisje ndaj shumave tjera pasuese për t'u paguar në bazë të ligjit por që nuk është e kthyeshme përveç në rastet kur dëmi i shkaktuar ka qenë për shkak të neglizhencës apo gabimit të udhëtarit i cili ka marrë avansin e pagesës, pa të drejten për kompensim;

2.5. edhe nëse ndërmarrja hekurudhore e konteston përgjegjësinë e saj për lëndimin fizik të personit, ajo duhet të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për ta ndihmuar udhëtarin që kërkon kompensim nga pala e tretë për dëmin.

3. Vonesat, lidhjet e humbura dhe anulimet:

3.1. përgjegjësia e ndërmarrjes hekurudhor në lidhje me vonesat, lidhjet e humbura dhe anulimet, si dhe mundësinë e kthimit të parave, kompensimin dhe kushtet e pagesave, duhet të rregullohet me aktin nënligjor në pajtim me Rregulloren 1371/2007/EC;

3.2. ndërmarrjet hekurudhore mund ta fusin pragun minimal nën të cilin pagesat për kompensim nuk do të bëhen. Ky prag nuk duhet t'i tejkaloj katër (4) euro.

4. Shërbimet për personat e paaftë dhe personat me aftësi të kufizuar të lëvizjes:

4.1. ndërmarrjes hekurudhore dhe menaxherët e stacionit duhet që me përfshirje aktive të përfaqësuesve të organizatave për personat me paaftësi dhe personat me aftësi të kufizuara të lëvizjes të vendosin apo të kenë në funksion rregullat e qasjes jo diskriminuese;

4.2. rezervimet dhe biletat duhet të ofrohen për personat me paaftësi dhe personat me aftësi të kufizuar të lëvizjes pa një kosto shtesë. Ndërmarrja hekurudhore, shitësi i biletave apo operatori i udhëtimit nuk mund të refuzojnë të pranojnë rezervim apo dhënie të biletës për personat me paaftësi apo me lëvizje të kufizuar apo që të kërkojnë që ata persona të kenë shoqërim nga personat e tjerë përveç nëse është strikt e domosdoshme të përputhen me rregullat e qasjes;

4.3. ndërmarrja hekurudhore, shitësi i biletave dhe operatori i udhëtimit duhet të u ofrojnë personave me paaftësi apo me aftësi të kufizuar të lëvizjes informacion për qasjen në shërbimet hekurudhore dhe për kushtet e qasjes në mjetet lëvizëse në përputhje me rregullat e qasjes dhe duhet t'i informojnë personat me paaftësi dhe me aftësi të kufizuar të lëvizjes në lidhje me kushte në bord;

4.4. ndërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e stacionit duhet që në përputhje me STI-të për personat me aftësi të kufizuar të lëvizjes të sigurojnë se stacioni, platformat, mjetet lëvizëse dhe pajisjet e tjera të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuar apo me paaftësi;

4.5. në nisje, transit, përmes apo arritje, stacioni hekurudhor që pret persona me aftësi të kufizuara, menaxheri i stacionit duhet të ofroj asistencë pa pagesë në atë mënyrë që personi të jetë në gjendje të hyj në bord të shërbimit të nisjes apo të zbritjes nga shërbimi i arritjes për të cilin ai apo ajo ka blerë biletën;

4.6. ndërmarrjet hekurudhore duhet të u ofrojnë personave me paaftësi dhe personave me aftësi të kufizuar të lëvizjes asistencë pa pagesë në bord të trenit gjatë hyrjes në bord apo gjatë largimit nga bordi.

5. Siguria dhe kualiteti i shërbimeve:

5.1. në marrëveshje me autoritetet publike, ndërmarrja hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës dhe menaxherët e stacioneve duhet të marrin masa adekuate në fushën e tyre të përgjegjësisë për të siguruar sigurinë personale të udhëtarit në stacionet e trenave dhe në trena dhe ta menaxhojnë rrezikun. Ata duhet të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informata lidhur me parandalimin e veprimeve që mund të prishin nivelin e sigurisë;

5.2. ndërmarrjet hekurudhore duhet të definojnë standardet e kualitetit dhe të zbatojnë sistemin e menaxhimit të kualitetit për të mirëmbajtur kualitetin e shërbimit. Këto kualitete të shërbimit duhet që të definohen me një akt nënligjor në pajtim me Rregulloren 1371/2007/EC;

5.3. ndërmarrjet hekurudhore duhet të monitorojnë aktivitetin e tyre ashtu sikur është paraqitur në standardet e kualitetit të shërbimit.

Neni 141 Ankesat

1. Ndërmarrja hekurudhore duhet të vendos mekanizmin për trajtimin e ankesës për të drejtat dhe obligimet e përfshira me këtë ligj. Ndërmarrja hekurudhore duhet të bëjë detajet e kontaktit dhe gjuhën e punës që të jenë të njohura për udhëtarët.

2. Udhëtarët mund të dorëzojnë ankesën tek secila ndërmarrje hekurudhore e përfshirë. Brenda një muaji adresuesi i ankesës duhet të merr një përgjigje të arsyeshme apo në raste të justifikueshme udhëtari duhet të informohet për datën e cila duhet të jetë më e shkurt se tre muaj se kur ai mundet ta pres përgjigjen.

3. Udhëtarët që nuk janë të kënaqur me trajtimin e ankesave nga ndërmarrja hekurudhore mund të ankohen te Organin i cili është i ngarkuar me rregullimin e tregut hekurudhor.

4. Bazuar në këtë ligj, ndërmarrja hekurudhore duhet të publikoj në raportin vjetor numrin dhe kategoritë e ankesave të pranuar, ankesat e trajtuara dhe veprimet e ndërmarrja për përmirësimet e mundshme.

Neni 142 Raportimi

Ndërmarrjet hekurudhore duhet që secilin vit të publikojnë raportin e performancës të kualiteti të shërbimit së bashku me raportin e tyre vjetor. Raportet mbi performancën e kualitetit të shërbimit duhet të publikohen në faqen e internetit të ndërmarrjeve hekurudhore. Përmbajtja e raportit të tillë duhet të përshkruhet me aktin nënligjor në pajtim me Rregulloren e BE-së 1371/2007.

KREU XIV DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 143 Gjobat

1. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) gjobitet prej tremijë (3.000) deri tetëmijë (8.000) Euro nëse:

1.1. menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët, ndërmarrjet hekurudhore apo cilado palë tjetër nuk i ofron Organit Rregullativ të Tregut informacionin e kërkuar (sipas paragrafit 6. të nenit 26 të këtij ligji);

1.2. menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk e publikojnë Ekspozeun e rjetit sipas kriterëve të përcaktuara (neni 55 i këtij ligji);

1.3. menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk e njoftojnë Organin Rregullativ të Tregut për zbritjen e çmimit (neni 67 paragrafi 3. i këtij ligji);

1.4. menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët bëjnë rezervime të traseve të infrastrukturës pa përfill procedurat e përcaktuara (në nenin 69 të këtij ligji);

1.5. të hyrat e krijuara nga qasja në binarë nuk regjistrohen dhe bëhen publike (neni 70 i këtij ligji);

1.6. orari i alokimit të kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji;

1.7. infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar dhe nuk analizohen kapacitetet në afatin e caktuar (neni 84 paragrafi 2. i këtij ligji);

1.8. nuk është propozuar plani për rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës nga menaxheri i infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët, atëherë kur infrastruktura është deklaruar e mbingarkuar dhe është kompletuar analiza e kapacitetit (neni 85 paragrafi 1. i këtij ligji);

1.9. procesi i planifikimit të mirëmbajtjes të infrastrukturës i propozuar nga menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët është në kundërshtim me nenin 87 të këtij ligji;

1.10. nuk mbahet regjistri i licencave dhe certifikatave të sigurisë të makinistëve (neni 95 paragrafi 6. dhe 7. të këtij ligji);

1.11. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet bazike (neni 103 paragrafi 5. i këtij ligji);

- 1.12. nuk është paraqitur raporti vjetor nga Autoriteti Nacional i Sigurisë deri më 30 qershor (neni 20 paragrafi 1. i këtij ligji);
- 1.13. nuk është paraqitur raporti vjetor nga Organi Rregullativ i tregut deri më 30 qershor (neni 26 paragrafi 12 i këtij ligji);
- 1.14. Sistemet dhe nënsistemet hekurudhore nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme të sigurisë (neni 105 i këtij ligji);
- 1.15. nënsistemet hekurudhore nuk plotësojnë kërkesat specifike të sigurisë (neni 106 i këtij ligji);
- 1.16. nënsistemet hekurudhore, mjetet transportuese, instalimet, aparatet ndihmëse, pajisjet dhe shërbimet, nuk përputhen me kërkesat e sigurisë të STI-së dhe rregullat nacionale të sigurisë (neni 107 i këtij ligji);
- 1.17. nuk ka deklaratën e verifikimit e cila dëshmon se nënsistemi struktural do të konsiderohet si interoperabil dhe që i plotëson kërkesat esenciale të sigurisë (neni 109 paragrafi 3. i këtij ligji);
- 1.18. mjetet e transportit hekurudhor operojnë pa numrin nacional (neni 110 paragrafi 8. i këtij ligji);
- 1.19. regjistri nacional i mjeteve të transportit nuk mbahet në mënyrë korrekte (neni 110 paragrafi 8. i këtij ligji);
- 1.20. pas marrjes të autorizimit për vënien në shërbim të nënsistemeve strukturore menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët nuk aplikojnë për marrjen e autorizimit të rifreskuar të sigurisë (neni 111 paragrafi 1. i këtij ligji);
- 1.21. pas marrjes së autorizimit për futjen e mjeteve të transportit në shërbim, ndërmarrja hekurudhore nuk aplikon për marrjen e certifikatën së rifreskuar të sigurisë (neni 111 paragrafi 2. i këtij ligji);
- 1.22. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk mbajnë regjistrin me të dhënat teknike për objektet e infrastrukturës (neni 118 paragrafi 3. i këtij ligji);
- 1.23. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk përgatisin planet e kërkuara të biznesit dhe dokumentet strategjike (neni 118 paragrafi 4. i këtij ligji);
- 1.24. entitetet legale të cilat ndërtojnë apo rindërtojnë infrastrukturën e shfrytëzimit të përbashkët nuk i ndërmarrin masat e duhura për zhvillimin e sigurt të trafikut, apo nuk largojnë nga infrastruktura hekurudhore apo brezi mbrojtës pas kryerjes së punëve materialin e mbetur, mjetet, shenjat lajmëruese dhe objektet tjera për të siguruar transport të sigurt (neni 121 paragrafi 3. i këtij ligji);

1.25. me kërkesën e menaxherit të infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët pronari i stabilimenteve të përcaktuara në paragrafin 7. të nenit 128 refuzon ti rregullon apo zhvendos ato (neni 128 paragrafi 9. i këtij ligji);

1.26. organit rregullativ të tregut nuk i jepet qasje në informatën e kërkuar nga menaxherët e infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët dhe nga ndërmarrjet hekurudhore (neni 26, paragrafi 6. i këtij ligji);

1.27. organi rregullativ i tregut nuk vendos për ankesat apo nuk ndërmerr veprim për trajtimin e tyre brenda periudhës tre mujore të përshkruar me këtë ligj (neni 26, paragrafi 7. i këtij ligji).

2. Personi përgjegjës i personit juridik apo personi fizik për kundërvajtje (shkelje administrative), sipas paragrafit 1. të këtij neni dënohet me gjobë prej një mijë (1.000) deri në pesë mijë (5 000) Euro.

3. Personi juridik për kundërvajtje (shkelje administrative) dënohet me gjobë prej pesë mijë (5.000) deri në dhjetë mijë (10.000) euro nëse:

3.1. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk ndërmarrin masat adekuate në rast të çrregullimit në lëvizjet e trenave (neni 88 i këtij ligji);

3.2. ndërmarrjet hekurudhore nuk posedojnë certifikatën e sigurisë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 94 të këtij ligji;

3.3. ndërmarrjet hekurudhore nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji lidhur me licencat dhe certifikatat e makinistëve (neni 95 deri 99 i këtij ligji);

3.4. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe ndërmarrjet hekurudhore nuk aplikojnë për certifikatat dhe autorizimet e tyre të sigurisë (neni 103 paragrafi 1. i këtij ligji);

3.5. ndërmarrjet hekurudhore ofrojnë shërbime pa u pajisur me certifikatën e sigurisë (neni 104 paragrafi 1. i këtij ligji);

3.6. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk posedojnë autorizimin e sigurisë sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 104 paragrafi 2. i këtij ligji;

3.7. sistemet e vendosura për menaxhimin e sigurisë nuk përmbajnë elementet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e sistemit hekurudhor neni 103 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji);

3.8. autoritetit Nacional të Sigurisë nuk i lejohet qasje në dokumentacion dhe objekte, instalime dhe pajisje për inspektim (neni 104 paragrafi 5. i këtij ligji);

3.9. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët dhe ndërmarrjet hekurudhore fusin në shërbim ndonjë nënsistem të hekurudhave pa marrë autorizim nga organi përgjegjës mbi sigurinë (neni 109 paragrafi 1. i këtij ligji);

3.10. ndërmarrjet hekurudhore e fusin në shërbim mjetin e transportit hekurudhor pa autorizim dhe certifikatë adekuate (neni 110 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji);

3.11. mirëmbajtja e mjeteve të transportit hekurudhor bëhet në kundërshtim me dispozitat e nenit 112 të këtij ligji;

3.12. gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore nuk ofrohen informacionet dhe zgjidhjet e kërkuara për publikun (neni 121 paragrafi 1. i këtij ligji);

3.13. pas ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk aplikojnë për autorizim të sigurisë (neni 121 paragrafi 2. i këtij ligji);

3.14. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk e ndërtojnë infrastrukturën hekurudhore me elementet e përshtatshme (neni 122 i këtij ligji);

3.15. pa miratimin e menaxherit të infrastrukturës të shfrytëzimit të përbashkët, entiteteve apo personave tjerë legal, vendosen kablllo telefonike, elemente të rrjetit elektrik, gypa të ujërave etj. në brezin e infrastrukturës hekurudhore (neni 128 paragrafi 7. i këtij ligji);

3.16. menaxherët e infrastrukturës së shfrytëzimit të përbashkët nuk ndërmarrin masat e domosdoshme për mbrojtje teknike dhe fizike nga fatkeqësitë elementare (neni 128 paragrafi 12. i këtij ligji);

3.17. entitetet legale apo personat tjerë ndërtojnë afër brezit mbrojtës të hekurudhës në kundërshtim me nenin 129 të këtij ligji;

3.18. entitetet legale apo personat tjerë ndërtojnë nënkalime, mbikalime apo vendkalime në nivel pa pëlqimin paraprak të menaxherit të infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët.

4. Personi përgjegjës i personit juridik apo personi fizik për kundërvajtje (shkelje administrative), sipas paragrafit 3. të këtij neni dënohet me gjobë prej dymijë (2 000) deri në shtatëmijë (7.000) Euro.

KREU XV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 144

Dispozitat kalimtare

1. Kompania hekurudhore në detyrë, Hekurudhat e Kosovës ShA dhe pasardhëset e saj të cilat do të krijohen, mund të operojnë pa licenca për një periudhë të caktuar kohore deri në gjashtë (6) muaj, pas krijimit të tyre ato do të aplikojnë dhe marrin licencën për operim me shërbimet e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimet e transportit hekurudhor.
2. Kompania hekurudhore në detyrë, Hekurudhat e Kosovës ShA dhe pasardhëset e saj të cilat do të krijohen, mund të operojnë pa autorizimin e sigurisë dhe certifikatat e sigurisë deri në dy (2) vjet, pas krijimit të tyre ato do të përgatiten dhe aplikojnë për marrjen e autorizimit të sigurisë për menaxherin e infrastrukturës dhe certifikatën e sigurisë për kompaninë e operimit me trena.
3. Bordi i ARH-se aktual do të vazhdojë të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e veta deri në përfundimin e mandatit të përcaktuar i cili iu është dhënë nga Kuvendi i Kosovës.
4. ARH, Brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të ristrukturohet në përputhje me rregullat e parapara të këtij ligji.
5. Dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe atij për partneritetin publiko privat dhe koncesionet do të mbisundojnë gjatë interpretimit nëse dispozitat e këtij ligji bien në kundërshtim me to.
6. Rregulloret dhe direktivat e legjisllacionit të Bashkimit Evropian nëse i zëvendësojnë rregulloret dhe direktivat në të cilat bazohet ky ligj do të kenë fuqinë ligjore për sektorin e hekurudhave të Kosovës.
7. Të hyrat e krijuara nga gjobat derdhen në buxhetin e Republikës të Kosovës.

Neni 145

Dispozitat përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr 03/L-076 Për Hekurudhat në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës të Kosovës /Prishtinë Nr. 32 /15 Qershor 2008) si dhe të gjitha dispozitat tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 146
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-063
14 nëntor 2011

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI